



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 446 Akti

Nr. 358 Vendimi

Tiranë, më 19.3.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Alma Faskaj	Kryesuese
Genta Tafa (Bungo)	Relatore
Lulzim Hamitaj	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, në datën 16.3.2021, ora 10:00, si dhe në datën 17.3.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Rita Gjati**, me detyrë prokurore/drejtuese në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

- 1.** Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- 2.** Subjekti i rivlerësimit, znj. Rita Gjati, aktualisht me detyrë prokurore/drejtuese në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, është subjekt i rivlerësimit, që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
- 3.** Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 16.12.2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Rita Gjati, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Lulzim Hamitaj dhe Alma Faskaj. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionerja Genta Tafa (Bungo).
- 4.** Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 19.12.2019 u caktua me mirëkuptim kryesuesi i trupit gjykues, znj. Alma Faskaj, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin Rita Gjati.
- 5.** Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, znj. Rita Gjati, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
- 6.** Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
- 7.** Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.
- 8.** Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të

subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); dhe Prokuroria e Përgjithshme. Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

10. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Rita Gjati. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ky institucion për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

11. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, një raport me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017.

Në datën 26.1.2021 DSIK-ja ka dërguar me shkresën nr. *** prot., raportin² e përditësuar për subjektin e rivlerësimit.

12. Prokuroria e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: atë të vlerësimit të pasurisë; të kontrollit të figurës; dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 26.1.2021, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit, znj. Rita Gjati; (ii) njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

15. Subjekti i rivlerësimit, në datën 28.1.2021, u njoftua mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni.

¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 5.2.2018

² Deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 26.1.2021, të KDZH-së.

³ Me shkresën nr. *** prot., datë 2.7.2018

15.1. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 2.2.2021.

15.2. Në datën 9.2.2021, ora 8:49, me anë të *e-mail*-it, subjekti i është drejtuar Komisionit me kërkesë për hetime shtesë. Trupi gjykues, me vendimin nr. 3, datë 10.2.2021, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit, ka vendosur ta refuzojë, duke e njoftuar me arsyetimin e këtij refuzimi, bazuar në nenin 49/6 të ligjit nr. 84/2016.

15.3. Subjekti ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 15.2.2021. Po në këtë datë, subjekti ka kërkuar shtyrjen e afatit për arsye shëndetësore, me qëllim sigurimin e provave shtesë. Kjo kërkesë u pranua nga Komisioni, duke i caktuar një afat të ri, datën 26.2.2021.

16. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin në seancë dëgjimore⁴.

17. Në datën 1.3.2021 subjekti, nëpërmjet *e-mail*-it, paraqiti kërkesë për shtyrjen e seancës dëgjimore për arsye shëndetësore. Komisioni, në datën 2.3.2021, nuk e pranoi këtë kërkesë, pasi subjekti nuk kishte vënë në dispozicion dokumentacion provues.

18. Në datën 2.3.2021 subjektit paraqiti sërish kërkesë për shtyrjen e seancës, duke paraqitur edhe dokumentacion në lidhje me gjendjen e saj shëndetësore. Komisioni vendosi shtyrjen e seancës dëgjimore për në datën 16.3.2021.

II. SEANCA DËGJIMORE

19. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail*, në datën 1.3.2021.

19.1. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit filloi në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 16.3.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova. Pas ndërprerjes së seancës, për shkak të kërkesës për përjashtim të trupit gjykues, seanca rifilloi në datën 17.3.2021, ora 10:00, në të njëjtën sallë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

20. Znj. Rita Gjati nuk ka qenë plotësisht bashkëpunuese gjatë procesit të rivlerësimit të kryer ndaj saj, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ajo iu është përgjigjur në kohë pyetjeve të Komisionit, por përgjigjet e saj nuk kanë qenë shteruese.

IV. KËRKESAT E SUBJEKTIT DHE VLERËSIMI I TYRE

Gjatë procesit të zhvillimit të hetimit administrativ, gjatë seancës dëgjimore, si dhe pas përfundimit, subjekti ka paraqitur disa kërkesa.

21. Kërkesat përpara zhvillimit të seancës dëgjimore

21.1. Pas kalimit të barrës së provës dhe njohjen me rezultatet e hetimit, më 28.1.2021, subjekti ka dërguar me anë të postës elektronike kërkesën e datës 9.2.2021, nëpërmjet së cilës ka kërkuar: (1) hetimin në QKB të shoqërisë “K” sh.p.k., për identifikimin e ortakëve, administratorëve dhe veprimtarisë para dhe pas vitit 2013 kur subjekti dhe familja e saj kanë filluar bisedimet për apartamentin e banimit; (2) hetimin dhe verifikimin në ASHK-në Tiranë

⁴ Vendimi i ndërmjetëm nr. 4, datë 1.3.2021

të regjistrimit të apartamentit të banimit në emër të djalit M. Gj. Kërkohe ky verifikim për të vërtetuar para Komisionit deklarimet e saj permanente se: “*Marrëdhëniet, unë dhe familja ime i kemi pasur me ‘K’ sh.p.k., që kishte dhe ka 2 administratorë, të cilët kanë pjesët takuese në biznes. Apartamenti ku unë jetoj, jo për fajin tim është regjistruar në emër të Sh.K fillimisht, kurse sot është i regjistruar në emër të ortakut tjetër të shoqërisë, M. K*”. Në këtë situatë kërkohe nga Komisioni verifikimi i këtij fakti dhe administrim në hetim; (3) hetimin në Gjykatën e Lartë lidhur me rekursin e paraqitur nga Prokuroria e Apelit Shkodër për të pandehurën M. A., të çështjes penale nr. ***, viti 2016; (4) hetimin pranë Gjykatës së Apelit Shkodër dhe Prokurorisë së Përgjithshme për shkaqet e heqjes dorë nga ankimi për çështjen penale në ngarkim të H. H. etj., të prokurorit të Apelit Shkodër; identifikimin e faktit se nga dy prokurorë të apelit janë mbajtur qëndrime të ndryshme brenda të njëjtës çështje, si dhe nga gjykatat; (5) verifikimin dhe administrimin në hetim nga Komisioni të procedimit penal që hetohet nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë lidhur me Aviacionin Civil (hetim që përfshin edhe Aeroportin e Kukësit), hetimin administrativ të faktit se A. Xh. nuk ka ankimuar vendimin e gjykatës që ka pushuar çështjen; (6) hetimin dhe verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga shtetasi L. H në Ambasadën Amerikane, me qëllim që të administrohet nga Komisioni fakti se çdo akuzë publike e tij ndaj subjektit ka qenë për një qëllim të vetëm, pajisjen me vizë nga kjo ambasadë; (7) hetimin nga Komisioni në Drejtorinë Rajonale të SHISH-it Kukës për të administruar rastet e procedimeve penale të iniciuara nga ky shërbim që janë hetuar nga subjekti (ku përfshihet edhe procedimi nr. **, viti 2016), me qëllim për të administruar nga Komisioni nivelin e bashkëpunimit me këtë institucion; (8) hetimin në DPSHCBA për pajisjen e subjektit me certifikatë sigurie në vitin 2010, koha e verifikuar, informacionet e të dhënat që janë përpunuar nga DSIK-ja në atë periudhë; (9) administrimin nga Komisioni të dëshmive të ish-drejtnesit të Strukturës për Hetimin e Krimin të Organizuar në Prokurorinë e Përgjithshme në vitin 2016, z. K. B, i cili ka drejtuar hetimin e procedimeve penale nr. **, viti 2016 dhe nr. **, viti 2015; (10) për të njëjtat procedime, administrimin e dëshmisë së z. D. P, ish-drejtnes i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës në vitet 2015 - 2016; (11) administrimin e dëshmisë së prokurorit A. Xh, ish-drejtor i Kontrollit të Hetimit në Prokurorinë e Përgjithshme për hetimin e çështjes penale për Aeroportin e Kukësit në ngarkim të A. Xh.; (12) administrimin e dëshmive të z. A.Q, ish-drejtnes i SHISH-it Kukës për fillimin e hetimit të procedimit penal nr. **, viti 2016; (13) hetimin administrativ në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese për vendimet gjyqësore që kanë dhënë për shtetasen R. Gjati pas shkarkimit nga detyra për vitet 2010 - 2012; (14) hetimin dhe administrimin nga Prokuroria e Përgjithshme të procedurave që janë ndjekur për procedimin disiplinor ndaj subjektit, çështjet përkatëse për të cilat është proceduar, personat që kanë kryer hetimin disiplinor dhe si kanë përfunduar në vijim këto çështje; si dhe (15) hetimin në Prokurorinë e Përgjithshme të vlerësimeve të punës nga ky institucion për vitet 2015, 2016 dhe 2017, që nuk janë integruar në raportin profesional.

21.1.1. Në mbledhjen e datës 10.2.2021, të zhvilluar *online*, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim kërkesat e subjektit për thirrjen e dëshmitarëve dhe marrjen e provave mbështetëse, vlerësoi se:

i. Lidhur me kërkesat nr. 1 dhe nr. 2 të subjektit për hetimin në QKB të shoqërisë “K” sh.p.k. për identifikimin e ortakëve, administratorëve dhe veprimtarisë para dhe pas vitit 2013, kur subjekti dhe familja e saj kanë filluar bisedimet për apartamentin e banimit, si dhe për hetimin dhe verifikimin në ASHK-në Tiranë të regjistrimit të apartamentit të banimit në emër të djalit, konstatohet se subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit deklaratën noteriale⁵ nr. ***, datë 23.1.2020, të znj. M.K, përfaqësuese e z. Sh.K, e cila ka përshkruar me hollësi dhe në përgjegjësinë e saj përpara noterit marrëdhënien e subjektit me z. Sh.K. Në këto kushte, printimi

⁵ Shihni pyetësoin datë 17.11.2020 dhe datë 23.12.2020

i ekstraktit të QKB-së për këtë shoqëri nuk do të sillte asnjë ndryshim në rezultatin e hetimit. Për pasojë, bazuar në germat “a” dhe “d” të nenit 49/6 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni refuzon kërkesat nr. 1 dhe nr. 2 të subjektit si të panevojshme, si kërkesa që pretendojnë të provojnë një fakt në favor të subjektit, i cili, edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit.

ii. Lidhur me kërkesën nr. 3 dhe nr. 4 të subjektit, Komisioni i vlerëson të panevojshme, në përputhje me germën “a” të nenit 49/6 të ligjit nr. 84/2016. Objekt i shqyrtimit nga Komisioni, si dhe barra e provës kaluar subjektit, nuk ka të bëjë me ecurinë e procesit penal, por me veprimet procedurale të subjektit, që nevojiten për vlerësimin profesional të saj.

iii. Lidhur me kërkesën nr. 5, Komisioni vlerëson ta refuzojë, bazuar në germën “a” të nenit 49/6 të ligjit nr. 84/2016, me të njëjtin argument si më sipër. Fakti që kërkohet të provohet, nuk është i nevojshëm për procesin e vlerësimit profesional të subjektit.

iv. Lidhur me kërkesën nr. 6, Komisioni refuzon kërkesën e subjektit bazuar në germat “a”, “c” dhe “ç” të nenit 49/6 të ligjit nr. 84/2016. Kërkesa e subjektit për t’iu drejtuar Ambasadës Amerikane duket si një kërkesë që ka për qëllim zvarritjen e procesit dhe aspak lidhje me subjektin.

v. Lidhur me kërkesat nr. 7 dhe nr. 8, Komisioni i vlerëson si të panevojshme, bazuar në germën “a” të nenit 49/6 të ligjit nr. 84/2016. Marrëdhëniet e bashkëpunimit të subjektit me institucionet shtetërore nuk janë kritere për procedurat e rivlerësimit.

vi. Lidhur me kërkesat nr. 9, 10, 11 dhe 12, Komisioni i vlerëson të panevojshme, bazuar në germën “a” të nenit 49/6 të ligjit nr. 84/2016, pasi në rezultatet e hetimit subjektit i ka kaluar barra e provës për procedurat e ndjekura prej saj dhe arsyetimin e kryer. Për Komisionin nuk është objekt vlerësimi ecuria e çështjes penale.

vii. Lidhur me kërkesat nr. 13, 14 dhe 15, Komisioni i vlerëson të panevojshme, bazuar në germat “a” dhe “d” të nenit 49/6 të ligjit nr. 84/2016, pasi subjektit nuk i ka kaluar barrë prove në lidhje me atë çfarë pretendon të provojë me këto kërkesa. Faktet që pretendohen të provohen nuk ndikojnë në marrjen e vendimit.

21.1.2. Në përfundim, trupi gjykues, me vendimin nr. 3, të datës 10.2.2021, vendosi refuzimin e kërkesave të subjektit, duke e njoftuar se në çdo rast do të administrojë çdo provë të paraqitur nga subjekti në përgjigje të barrës së provës ose gjatë seancës dëgjimore, duke respektuar të gjitha të drejtat e subjektit.

21.1.3. Dispozitivi i këtij vendimi iu njoftua menjëherë subjektit me anë të *e-mail*-it të datës 10.2.2021, ora 15:16. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, iu dërgua subjektit me anë të shërbimit postar, me shkresën përcjellëse nr. *** prot., datë 24.2.2021.

21.2. Në datën 5.3.2021 subjekti ka depozituar një kërkesë, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., nëpërmjet të cilës kërkon të pajiset me raportet e DSIK-së, që janë hartuar dhe kërkuar nga Komisioni për procesin e saj si subjekt rivlerësimi.

21.2.1. Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 8.3.2021, i ka vënë në dispozicion subjektit raportin nr. **** prot., datë 25.1.2021, të DSIK-së, të deklasifikuar pjesërisht.

21.3. Në datën 10.3.2021 subjekti ka depozituar një kërkesë, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., nëpërmjet të cilës kërkon të informohet për emrat e këshilltarëve ligjorë dhe ekonomikë që kanë asistuar trupin gjykues për hetimin administrativ, si dhe kopje të njësuar me vullë të analizës financiare të kryer nga Komisioni.

21.3.1. Nëpërmjet përgjigjes me anë të postës elektronike, nga adresa info@kpk.al, në datën 15.3.2021, ora 17:13, si dhe shkresës nr. *** prot., datë 12.3.2021, subjekti u njoftua se:

“Bazuar në nenin 4, pika 7 e ligjit nr. 84/2016 ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve’, dhe nenin 31 të rregullores për veprimtarinë e Komisionit, dhënia e këtij informacioni është një e drejtë e kufizuar për çdo subjekt që i nënshtrohet ex officio këtij procesi. Në kuadër të programit të transparencës, ju dhe mbarë publiku mund të informoheni dhe aksesoni direkt të dhënat e këshilltarëve të njësisë së shërbimit ligjor nëpërmjet faqes zyrtare të Komisionit, www.kpk.al. Sa i takon kërkesës për të disponuar kopje të analizës financiare, Komisioni sqaron se trupi gjykues i caktuar me short për të kryer rivlerësimin tuaj kalimtar, ju ka njohur nëpërmjet adresës zyrtare procesirivleresimit@kpk.al me rezultatet e hetimit administrativ, ku bën pjesë edhe analiza financiare. Përpos këtij fakti, në datën 2 shkurt 2021 ju është vënë në dispozicion edhe kopja e plotë e dosjes hetimore, e skanuar në CD, duke përmbushur në këtë mënyrë të gjitha të drejtat tuaja ligjore si subjekt rivlerësimi”.

21.4. Në datën 12.3.2021, ora 15:30, me anë të e-mail-it dhe paraqitjes në hard copy, subjekti ka depozituar pranë Komisionit një kërkesë për marrje prove, protokolluar me nr. *** prot.

21.4.1. Në mbledhjen e datës 12.3.2021, të zhvilluar në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, trupi gjykues ka arsyetuar se kërkesa e subjektit për të hetuar thellësisht të dhënat e DSIK-së lidhur me kontaktet e papërshtatshme, përmbush kriterin e një kërkesë procedurale dhe, si e tillë, u mor në shqyrtim. Trupi gjykues, pasi e vlerësoi, vendosi ta refuzojë, bazuar në germën “a”, neni 49, pika 6, me arsyetimin se gjatë fazës së hetimit administrativ kryesisht, trupi gjykues ka ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme për verifikimin e të dhënave të paraqitura në raportin e DSIK-së. Në këto kushte, duket e panevojshme të kryhet një verifikim i dytë, për aq sa subjektit i ka kaluar barra e provës për të provuar të kundërtën. Me këtë vendim të trupit gjykues, subjekti u njoftua në seancën dëgjimore të datës 17.3.2021.

22. Kërkesat gjatë seancës dëgjimore

22.1. Seanca dëgjimore filloi sipas njoftimit të bërë në datën 16.3.2021, ora 10:00, ku subjekti u paraqit së bashku me përfaqësuesin ligjor, z. S. V. Menjëherë me legjitimimin e trupit gjykues në nisje të seancës, përfaqësuesi ligjor kërkoi fjalën duke deklaruar: “[...] ju bëjmë me dije se me vendimin e datës 10.2.2021, ne jemi njohur nëpërmjet e-mail-it që kjo trupë gjykuese ka vendosur për refuzimin e të gjitha kërtimeve tona, por na rezulton që kryesuesja e këtij trupit gjykues, duke pasur gjithmonë mirëkuptimin tuaj – Alma Faskaj, na rezulton që në datën 8 ju jeni larguar nga Shqipëria, pra, nga territori i Republikës së Shqipërisë, dhe në datën 10 që ju keni marrë vendim si trup gjykues, ju nuk keni qenë e pranishme dhe kjo na mendon për një vlerësim serioz për njëanshmërinë tuaj. Jo ju personalisht, sepse kemi respekt familjarisht, por trupës gjykuese që në mungesën tuaj të arrinin në një vendimmarrje pa prezencën tuaj, dhe kjo është shumë e rëndë. Është shumë e rëndë për ne si juristë, mund të jetë e rëndë edhe për këtë Komision, ne nuk duam ta paragjykojmë në asnjë mënyrë sepse është e rëndë një vendimmarrje pa prezencë, për çfarëdolloj arsye dhe ju jeni kthyer në Shqipëri në datën 18.2.2021, pra, një javë pas vendimmarrjes. Nuk keni qenë në Shqipëri e në këtë moment si mundemi ne t’iu dëgjojmë në relatimin dhe në vazhdimin e këtij gjykimi, ku njëanshmëria është tepër e dukshme. Pikërisht për këtë unë i jam drejtuar edhe SPAK-ut me kallëzim për të verifikuar nëse jemi në gabim të mbajmë përgjegjësi në lidhje me një kallëzim të bërë.

Ne ju kemi kallëzuar të treve për shpërdorim detyre, në organin i cili është kompetencë lëndore konform nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale për ‘shpërdorim detyre’ të treve, për vendimmarrje në mosprezencën tuaj, dhe jo pa qëllim në datën 25 ju na keni dërguar, pasi keni mbërritur në Shqipëri, vendimmarrjen nëpërmjet dispozitivit të nënshkruar. Nëse ju do të keni qenë të pranishëm, në datën 10.2.2021, kur keni marrë vendimmarrjen, në e-mail-in që keni dërguar në dispozitiv do të ishte dhe nënshkrimi. Një vendim pa nënshkrim është absolutisht i pavlefshëm. Që në këtë moment, duke mos qenë dakord me këtë vendimmarrje, sepse e drejta e ankimit na lind së bashku me vendimin përfundimtar, **ne kërkojmë përjashtimin e trupës**

gjykuese, për aq kohë sa dhe SPAK-u të përgjigjet në lidhje me kallëzimin e regjistrimin. Ne ju vëmë në dispozicion procesverbalin për të cilën postën e kemi dërguar ditën e premte, momenti që SPAK-u e ka pranuar kallëzimin, ndërkohë që do të kërkonim edhe nga ana juaj se në qoftë se ju si kryesuese të shprehni në lidhje me prezencën tuaj me këtë vendimmarrje ne heqim dorë menjëherë, por do të shikojmë edhe qëndrimin tuaj, duke kërkuar edhe marrjen e transkriptimit dhe marrjen e procesverbaleve audio, për ta pasur dhe ne si provë më tutje për vazhdimin e procedurave tona. Nuk mundemi të vijojmë në qoftë se është e vërtetë.

Ne kemi TIMS-in, për të cilat ne do t'ua vëmë në dispozicion që jeni ju personi që në datën 8 keni udhëtuar drejt Milanos, pavarësisht arsyeve, ua thashë dhe një herë, jam plotësisht me juve për çdo lloj shqetësimi apo problemi shëndetësor a shoqëror që ke, por nuk mund të lejojme vendimmarrjen në mungesën tuaj”.

22.1.1. Menjëherë pas kësaj kërkesë të paraqitur nëpërmjet deklarimit në seancë të përfaqësuesit të subjektit, trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore dhe ia përcolli kërkesën Komisionit, me qëllim shortimin e një trupi gjykues, që do të merrte në shqyrtim kërkesën e subjektit për përjashtimin e tij, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 84/2016.

22.1.2. Trupi gjykues, i ngritur me shortin e miratuar me vendimin nr. 24, datë 16.3.2021, të Komisionit, i përbërë nga komisionerët Olsi Komici, Valbona Sanxhaktari dhe Suela Zhegu, me vendimin e datës 16.3.2021, të marrë në mbledhjen e zhvilluar në orën 15:00, ka vendosur mospranimin e kërkesës së subjektit për përjashtim të trupit gjykues, si kërkesë e pabazuar në ligj dhe në prova, me arsyetimin se: “Nga vlerësimi i kërkesës së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues arsyeton se problematika e ngritur ka të bëjnë me vendimmarrjen e trupit gjykues, lidhur me refuzimin e kërkesave të paraqitura prej subjektit të rivlerësimit. Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se trupi gjykues ka zhvilluar mbledhjen e tij online në datën 10.2.2021, në prezencë të plotë, po ashtu edhe në prezencën e vëzhguesit ndërkombëtar. Vendimmarrja online, në vlerësim të trupit gjykues, nuk përmban asnjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 30 të Kodit të Procedurave Administrative ose të ligjit ‘Mbi parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike’, dhe në vlerësim të trupit gjykues nuk përbën shkak për njëanshmëri.

Paraqitja/depozitimi i një kallëzimi penal në SPAK, në vlerësim të trupit gjykues, nuk përbën asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 30 të Kodit të Procedurave Administrative ose të ligjit ‘Mbi parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike’ e që e çon në kushtet e konfliktit të interesit nëpunësin publik dhe, për pasojë, nuk përbën shkak për pranimin e kërkesës”.

22.1.3. Ky vendim iu njoftua menjëherë subjektit me anë të postës elektronike në datën 17.3.2021, ora 9:24, si dhe iu dërgua nëpërmjet shërbimit postar. Një kopje e tij iu vu në dispozicion subjektit edhe në fillim të seancës së datës 17.3.2021.

22.2. Në seancën e datës 16.3.2021, trupi gjykues, pasi njoftoi ndërprerjen e saj me qëllim shqyrtimin e kërkesës për përjashtim të trupit gjykues nga një tjetër trup gjykues, lajmëroi se seanca do të rifillonte në datën 17.3.2021, në orën 10:00. Por në këtë datë, në orën 9:39, subjekti ka depozituar pranë Komisionit kërkesën për përjashtimin e trupit gjykues.

22.2.1. Me çeljen e seancës, kryesuesja ka njoftuar subjektin për: (i) vendimin e mospranimit për përjashtim të trupit gjykues; (ii) njoftimin se pak përpara fillimit të seancës subjekti ka paraqitur një kërkesë të re për përjashtimin e trupit gjykues, e cila ka parashtruar të njëjtat shkaqe që janë parashtruar gjatë seancës së një dite më parë. Trupi gjykues njoftoi se e kishte administruar këtë kërkesë përpara se të fillonte seancën, duke konstatuar se shkaqet e ngritura në të janë të njëjta që janë ngritur gjatë ditës së mëparshme dhe që janë vlerësuar në arsyetimin e vendimit të dhënë nga trupi gjykues i ngritur në datën 16.3.2021; (iii) njoftimin se në datën

16.3.2021, pas përfundimit të seancës, subjekti ka depozituar një kërkesë për marrjen e procesverbalit të seancës dëgjimore, i cili i është dërguar subjektit nëpërmjet shërbimit postar; si dhe (iv) marrjen dijeni se në lidhje me kërkesën e paraqitur në datën 12.3.2021, trupi gjykues ka vendosur ta refuzojë, në bazë të pikës 6 të nenit 49, me arsyetimin se të dhënat që përmban raporti i DSIK-së janë hetuar dhe vlerësuar gjatë hetimit administrativ kryesisht të Komisionit dhe, për pasojë, vlerësohet një hetim i përsëritur dhe i panevojshëm nga trupi gjykues, sa më sipër, lidhur me kërkesat e depozituara nga subjekti.

22.2.2. Pasi ka kërkuar fjalën, përfaqësuesi ligjor i subjektit, z. S. V, ka pretenduar se: “[...] duke qenë se ligji më jepte tri ditë afat për të depozituar ose formuluar kërkesën për ‘përfundimin me shkrim’, ne, brenda afatit ligjor, i kemi drejtuar me kërkesë, por nuk e imagjinonim që ne të na formalizohet kërkesa në mënyrë imagjinare pa e formalizuar me shkrim, të cilën ne e kemi depozituar në fillimin e orarit zyrtar të ditës së sotme dhe ju, ky trup gjykues, nuk e di pse nuk e ka marrë në konsideratë si gjë të gjykuar kërkesën tonë. Është e vërtetë që është i njëjti objekt i njëjti fakt, por vendimmarrja e menjëhershme na bën të mendojmë që ne, sado të lodhemi përpara jush, ky vendim nuk do të jetë asnjëherë objektiv.”

22.2.3. Menjëherë pas këtij pretendimi, trupi gjykues, nëpërmjet kryesuesit të tij, ka qartësuar se Komisioni, me qëllim efikasitetin në shqyrtimin e këtij procesi rivlerësimi, ka marrë në konsideratë të gjitha pretendimet e parashtruara nga avokati në seancë dëgjimore, të cilat janë parashtruar dhe janë pasqyruar në procesverbalin e mbledhjes. Një kopje e këtij procesverbali i është vënë në dispozicion edhe subjektit. Konstatohet se të gjithë elementet e parashtruara nga avokati në seancën dëgjimore të datës 16.3.2021, janë të njëjtat me ato të parashtruara në kërkesën e depozituar pranë Komisionit në datën 17.3.2021. Menjëherë pas këtij sqarimi, avokati S.V ka vijuar me një kërkesë të re.

22.3 Përfaqësuesi ligjor i subjektit ka depozituar pranë trupit gjykues një kërkesë me objekt “marrjen e provave të tjera pranë institucioneve SHISH, SHÇBA dhe KLP”. Në parashtrimin e tij në seancë, ai ka deklaruar se Komisionit, që nga viti 2017, i kanë ardhur 2 raporte nga DSIK-ja, një për të cilën e vlerëson subjektin të përshtatshëm dhe më pas, pas kërkesës së Komisionit në datën 6.1.2021, DSIK-ja, për 17 ditë përgatit një raport të dytë, në kundërshtim me nenin 36/2, që kërkon një grup pune me një afat jo më të vogël se 1-vjeçar dhe dërgon një raport tërësisht në kundërshtim mbi gjetjet për të cilat ky institucion njeh, nga ku është quajtur subjekti i përshtatshëm. Avokati ka pretenduar se: “Konstatohet se një dokument ka edhe datën e pranimit në Komision, që është data 25.1, ndërkohë që nga Komisioni për deklasifikimin dhe zhvlerësimin për informacionin mban datën 26. Ky është një moment tepër serioz për të cilën është njësoj, ju keni qenë gjyqtare të jepni një vendim sot dhe seanca të zhvillohet nesër. Kjo është serioze për ne dhe menjëherë pa dalë ky si informacion, e cila më 25 është pranuar hyrje në KPK-së, Komisioni për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit i vë vulën në datën 26. Duhet që ky Komision ta vinte vulën më 25 dhe ju ta pranoni në 26 [...], ne po ju drejtojmë me kërkesë për çeljen e hetimit, sepse kemi të drejtën dhe i drejtohem personalisht subjekteve ligjzbatuese për të cilat DSIK-ja mbështetet si: SHIK, KLP apo SHKB, të cilët me të drejtë na kanë kthyer përgjigje që duhet patjetër Komisioni t’i drejtohet për të marrë një përgjigje.”

22.3.1 Menjëherë trupi gjykues administroi kërkesën, ndërpreu seancën dhe e mori në shqyrtim në dhomë këshillimi. Me rifillimin e seancës, kryesuesja ka njohur subjektin me vendimmarrjen e trupit gjykues, se: “Pas shqyrtimit të kërkesës së subjektit, trupi gjykues çmon se në këtë fazë të procesit të mos riçelë hetimin administrativ. Të gjithë shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti edhe gjatë kësaj seance dëgjimore, do të vlerësohen gjatë procesit të vendimmarrjes. Lidhur me pretendimin se kemi një mospërputhje të datave në dokumentet e depozituara nga ana e DSIK-së, sqarohet se data 25 janar 2021 është data e hartimit të raportit nga ana e këtij organi dhe data 26.1.2021 është data e deklasifikimit të këtij raporti po nga i

njëjti organ. Të dyja këto data, edhe një herë, i përkasin të njëjtit institucion.” Menjëherë pas kësaj, përfaqësuesi ligjor i subjektit ka kërkuar fjalën, duke paraqitur një kërkesë të re.

22.4. Z. S.V ka deklaruar se: *“Ne kemi një kërkesë në lidhje me vazhdimësinë e këtij vendimi që ju morët, të cilët i bëj me dije trupit gjykues që në lidhje me raportin e DSIK-së ne i jemi drejtuar edhe Gjykatës Administrative Tiranë me një padi, duke e paditur Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit, duke e konsideruar të pavlefshëm me arsyet e kërkesëpadisë që ne kemi paraqitur. Atëherë, duke qenë se në lidhje me atë çka ju relatuat dhe rrëzuat, ne jemi drejtuar edhe me kërkesëpadi, me të cilën disponojmë dhe një vërtetim të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë për padinë e regjistruar nga ana e paditëses Rita Gjati, të cilën unë përfaqësoj në këtë dëgjese dhe me të paditur DSIK-në, me objekt ‘deklarimin absolutisht të pavlefshëm të raportit të datës 25 apo 26.1.2021’, prandaj do të kërkonim pezullimin e këtij gjykimi deri në vendimmarrjen e tij. Është një akt administrativ. Për ne është absolutisht i pavlefshëm, pretendimet tona janë të qarta, duke u ngritur me mjetin ose aksesin që kemi neve ligjor për t’iu drejtuar me padi Gjykatës Administrative. Deri në vendimmarrjen e saj, ne kërkojmë pezullimin e këtij gjykimi”.*

22.4.1. Trupi gjykues ndërpreu menjëherë seancën dhe, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur, ka çmuar si shkak të pamjaftueshëm për pezullimin e procesit në këtë fazë paraqitjen e kërkesëpadisë pranë Gjykatës Administrative, duke vendosur kështu vazhdimin e seancës dëgjimore.

22.4.2. Në këtë moment, pavarësisht përpjekjeve të kryesuesit për të vazhduar sipas rregullave procedurale të seancës, avokati i subjektit ka njoftuar se po largohet nga seanca, duke hequr dorë nga mbrojtja e subjektit të rivlerësimit. Avokati S.V, përpara largimit, u shpreh se: *“Unë kam një kërkesë para trupit gjykues, edhe përpara palës që unë përfaqësoj, duke e ndjerë veten të fyer, mbasi dhe një të dënuar për vrasje, për vjedhje, një të drejtë ose një gjetje duhet të pranohet, por shikoj që ju keni paragjykuar, heq dorë nga mbrojtja, duke vënë në dijeni palën që unë përfaqësoj dhe më vjen turp që kam ardhur përpara këtij Komisioni. Unë ruaj profesionalizmin tim, por edhe një i pandehur i keni dhënë një deklaratë mbrojtjeje me të gjitha pikat, po një të drejtë ne nuk e kemi, që na i rrëzoni të gjitha gjërat që na atribuohen, ashtu. Unë që në këtë moment heq dorë dhe i kërkoj palës të gjejë një avokat tjetër të mbrohet, pasi jam i fyer dhe unë përpara profesionit tim nuk mund të vazhdoj më, se kam humbur qetësinë për të qenë përpara jush.”*

22.5. Menjëherë me largimin e përfaqësuesit ligjor, në mënyrë të papritur nga salla ku po zhvillohej seanca dëgjimore, subjekti ka kërkuar fjalën. Znj. Rita Gjati ka deklaruar se: *“Mua më kapi në befasi lëvizja e avokatit, lëvizja e mbrojtësit. Kam mbështetur tërë paraqitjen time para Komisionit në praninë e tij, për shkak se ju kam vënë në dijeni zyrtarisht se kam kaluar COVID-in familjarisht dhe akoma nuk jam rikuperuar. Në karrierën time 25-vjeçare kam gjykuar dhe dënuar shumë kriminelë dhe minimumin e të drejtave ia u kam dhënë, ndaj kërkoj që minimumi këtë të drejtë që edhe unë të paraqitem në mënyrë dinjitoze me mbrojtës para trupës suaj të nderuar të ma njihni [...]. Unë e kam vënë në dijeni Komisionin që në momentin e infektimit, megjithatë dua t’ju them se minimumi këtë të drejtë që të asistoj në këtë seancë me një avokat duhet të ma njihni, për shkak të pamundësisë fizike.”*

22.5.1. Subjekti është pyetur nga kryesuesi i seancës nëse mund ta provonte me dokument pamundësinë fizike, e cila, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“Ju thashë që në momentin që jam infektuar kam vënë në dijeni Komisionin zyrtarisht nëpërmjet rrugës elektronike, por edhe me shërbim postar që bashkë me testin që unë jam e infektuar familjarisht. Direkt pas periudhës 14-ditore që m’u la afati për të paraqitur provat e mia dhe prapësimet e mia, ndërkohë që isha e karantinuar unë duhet të thyeja karantinën dhe të mblidhja provat, gjë që nuk e kam bërë. Pas atij momenti u diagnostikova me post COVID dhe ju kam vënë në dispozicion edhe*

skanerin, edhe raportin mjekësor, i cili për hir të së vërtetës, më ka mbaruar pardje. Dy ditë ka që jam njeri fizikisht, e aftë deri diku për të dalë dhe për të lëvizur. Sot më braktis dhe avokati. Nuk e di, është e tepërt që unë të paraqitem në seancë me një njeri më të aftë se unë fizikisht?”

22.5.2. Trupi gjykues u tërhoq për të marrë në shqyrtim kërkesën e subjektit.

Nga shqyrtimi i provave rezultoi se:

- i. Në datën 28.1.2021 subjektit i janë dërguar me postë elektronike rezultatet e hetimit dhe është ftuar për t'u njohur me dosjen.
- ii. Subjektit iu dhanë 18 ditë kohë për të paraqitur prova dhe shpjegime për të kundërshtuar barrën e provës, afat i përfunduar në datën 15.2.2021.
- iii. Subjekti ka lexuar njoftimin me rezultatet e hetimit në datën 28.1.2021, ora 14:52.
- iv. Subjekti ka konfirmuar me *e-mail* marrjen e rezultateve të hetimit dhe ka kërkuar një kopje të dosjes në datën 29.1.2021, ora 10:51.
- v. Subjekti është paraqitur në mjediset e Komisionit personalisht dhe ka marrë një kopje të dokumenteve në datën 2.2.2021.
- vi. Në datën 9.2.2021, subjekti ka bërë kërkesë për thirrjen e dëshmitarëve dhe marrjen e provave mbështetëse.
- vii. Në datën 12.2.2021, ora 16:30, subjekti ka njoftuar me postë elektronike se: *“Që nga data 8.2.2021 (pasdite) djali, F. Gj, u kthye nga shkolla me temperaturë dhe kollë. Të nesërmen, në datën 9.2.2021, pas vizitës mjekësore pediatri rekomandoi karantinimin dhe planifikoi testin për në datën 12.2.2021 për djalin. Jam karanteluar derisa në datën 11.2.2021, pas shenjave të infektimit iu nënshtrua testit përkatës.”* Subjekti ka bashkëlidhur analizën biologjike për SARS COVID-19, të datës 12.2.2021, ku rezulton pozitive.
- viii. Pasi shqyrtoi kërkesën dhe provën e paraqitur nga subjekti, trupi gjykues e pranoi atë dhe e njoftoi se afati për paraqitjen e provave dhe shpjegimeve do të shtyhej deri në datën 26.2.2021. Ky njoftim iu bë me anë të postës elektronike në datën 15.2.2021, ora 14:21.
- ix. Në datën 15.2.2021 subjekti ka paraqitur prova dhe shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, duke kërkuar kohë shtesë për të paraqitur prova të tjera.
- x. Në datën 26.2.2021 subjekti ka dërguar përsëri prova të tjera për të provuar të kundërtën e barrës së provës.
- xi. Në datën 1.3.2021 subjekti u njoftua për datën e zhvillimit të seancës dëgjimore, njoftim ky i publikuar edhe në faqen zyrtare të Komisionit.
- xii. Po në të njëjtën datë, më 1.3.2021, ora 17:15, subjekti ka njoftuar me anë të postës elektronike se: *“Siç ju kam vënë në dijeni me e-mail-in e datës 15.2.2021, isha e infektuar me COVID-19 dhe në datën 26.2.2021 i jam nënshtruar ekzaminimeve mjekësore me rekomandim të mjekut të familjes. Kam vënë në dispozicion të Komisionit ekzaminimet (skaner dhe analiza), të cilat atë ditë i kam depozituar në Komisionin Rajonal të Pneumologëve, Tiranë, për t'u paraqitur në këtë Komision në datën 2.2.2021, ora 12:30, me qëllim ekzaminimin për ecurinë e pasojave dhe trajtimin post COVID. Aktualisht vazhdoj trajtim mjekësor dhe jam në situatë jo të mirë shëndetësore për këtë shkak. Me qëllim përgatitjen dhe paraqitjen personale për mbrojtjen në seancë, kërkoj marrjen në konsideratë të këtij fakti dhe caktimin e një date tjetër.”*

- xiii. Komisioni i kërkoi subjektit të provonte me dokumentacion pamundësinë për paraqitjen në seancë. Subjekti vuri në dispozicion të Komisionit: (a) CT Thorax, datë 25.2.2021; (b) rezultatin e testit COVID-19, datë 12.2.2021; (c) raportin për paaftësi të përkohshme në punë, datë 12.2.2021, për një periudhë 14-ditore; (ç) recetën me logo të Spitalit Universitar të Traumës, lëshuar nga dr. Z. V.; (d) fletën e analizës (për shërbimin e urgjencës), lëshuar nga Spitali Universitar i Traumës; (dh) raportin për paaftësi të përkohshme në punë, datë 2.3.2021, lëshuar nga dispanseria për një periudhë 14-ditore.
- xiv. Subjekti ka caktuar si përfaqësues ligjor të saj avokat S. V, më 3.3.2021, me prokurë të posaçme nr. ****. Në këtë prokurë subjekti i ka dhënë të drejtat dhe kompetencat që ta përfaqësojë në prani dhe mungesë pranë Komisionit për të paraqitur kërkesa në emër dhe për llogari të saj, për të tërhequr dokumente shkresore, për të paraqitur prova, për të dhënë shpjegime me shkrim në emrin e saj, si dhe të drejta të plota përfaqësimi për çdo gjë që ka lidhje me të, si subjekt rivlerësimi. Përfaqësuesi ka të drejtë ta përfaqësojë edhe në mungesë.
Nuk rezulton që subjekti të ketë njoftuar Komisionin në lidhje me këtë prokurë në datën 3.3.2021.
- xv. Pasi shqyrtoi dokumentacionin, trupi gjykues pranoi kërkesën e subjektit, duke shtyrë datën e seancës dëgjimore deri në përfundim të raportit mjekësor, në datën 12.3.2021 dhe duke e njoftuar subjektin se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 16.3.2021.
- xvi. Në seancën e datës 16.3.2021, subjekti kërkoi përjashtimin e trupit gjykues.
- xvii. Në seancën e rifilluar në datën 17.3.2021, subjekti ka bërë disa kërkesa, të cilat janë refuzuar nga trupi gjykues.
- xviii. Pas refuzimit të kërkesave, avokati ka vendosur në mënyrë të papritur dhe demonstrative të braktisë detyrën në sallën ku po zhvillohej seanca dëgjimore, duke krijuar dyshime për zvarritje të qëllimshme të procesit.
- xix. Pas kësaj, subjekti kërkon përsëri shtyrje të seancës me qëllim gjetjen e një avokati tjetër, me pretendimin e pamundësisë fizike, duke arsyetuar se ka vetëm dy ditë që i ka mbaruar raporti mjekësor.

22.5.3. Trupi gjykues, pasi vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e sipërcituara, me shumicë votash, vendosi të mos e pranojë kërkesën e subjektit. Gjatë gjithë procesit subjekti ka drejtuar kërkesa të shumta procedurale, të cilat janë marrë në shqyrtim dhe për të cilat trupi gjykues është shprehur me vendim dhe ia ka njoftuar subjektit. Subjektit iu dha gjithë koha e nevojshme prej 18 ditësh për të përgatitur mbrojtjen. Ky afat përfundonte në datën 15.2.2021, ndërkohë që subjekti ka rezultuar pozitiv me COVID më 12.2.2021, afat i cili u shty edhe me dy javë të tjera, por subjekti përsëri ka kërkuar shtyrje, duke paraqitur një raport mjekësor për shkak të gjendjes post COVID. Subjekti ishte e pranishme në seancë dhe nuk ka pasur asnjë qëndrim që të reflektonte pamundësi fizike. Subjekti ka ushtruar të drejtën për t'u paraqitur me përfaqësues ligjor, i cili është pajisur me prokurë të posaçme nr. ***, që në datën 3.3.2021 dhe ka pasur të gjithë kohën e mjaftueshme për të mbledhur provat e pretenduara nga subjekti, si dhe për të përgatitur parashtrimet në emër të subjektit, duke qenë se ka qenë i pajisur me këto tagra përfaqësimi sipas prokurës së sipërcituar. Braktisja e subjektit nga përfaqësuesi nuk mund të jetë më shkak për shtyrje të njëpasnjëshme të seancës dëgjimore. Shumica e trupit gjykues e vlerëson si abuzim me të drejtat kërkesën e subjektit për shtyrje të seancës. Nga ana tjetër, subjekti nuk ka provuar me dokumentacion pamundësinë fizike, për sa ishte e pranishme në sallë. Të drejtat procedurale të subjektit nuk nënkuptojnë përdorimin e tyre abuziv gjatë procesit administrativ. Në këto kushte, me shumicë votash, u vendos vazhdimi i seancës dëgjimore.

22.5.4. Me rifillimin e seancës dhe njohjen me këtë vendim, subjekti është larguar nga salla, duke pretenduar se: *“Pas situatës që u krijua, që avokati u largua nga procesi, unë nuk do ta pengoj procesin tuaj, ju ta vazhdoni, ju uroj dhe punë të mbarë, pa praninë time tashmë.”*

22.5.5. Komisioni vlerëson se qëndrimi i subjektit është tërësisht jo bashkëpunues. Subjekti ka të drejtën e një përfaqësuesi ligjor, por mungesa e tij, për më tepër braktisja nga përfaqësuesi gjatë seancës, nuk mund të jetë shkak i mjaftueshëm për ndërprerje të seancës dhe shtyrje të procesit. Duke qenë se procesi i rivlerësimit kryhet për pasuritë e subjektit ndër vite, figurën dhe anën profesionale, nuk mund të arsyetohet se mungesa e përfaqësuesit do të sillte një dëm të pariparueshëm për të drejtat e subjektit, për më tepër kur vetë subjekti ishte prezent në sallë, si dhe ka pasur të gjithë kohën e nevojshme që së bashku me mbrojtësin e caktuar prej saj (që në datën 3.3.2021) të përgatiste mbrojtjen. Subjekti apo mbrojtësi i saj nuk paraqitën prova të reja, si dhe parashtrime me shkrim shtesë në seancë, për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se ajo i ka pasur të gjitha mundësitë procedurale për të realizuar mbrojtjen, duke paraqitur parashtrime me shkrim dhe provat që i ka konsideruar të nevojshme përpara seancës gjyqësore. Subjekti apo përfaqësuesi i saj nuk paraqitën kërkesë paraprake për marrjen e provave të reja, për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se subjekti ka ezauruar depozitimin e të gjitha provave që i ka konsideruar të nevojshme për mbrojtjen efektive të saj, përpara zhvillimit të seancës dëgjimore. E gjithë sjellja e subjektit dhe përfaqësuesit të saj, me kërkesa të njëpasnjëshme për pezullim të seancës, si dhe qëndrimi përfundimtar, duket se kanë për qëllim zvarritjen dhe bllokimin e procesit të rivlerësimit. Këtë qëndrim të subjektit trupi gjykues do ta ketë në konsideratë, në këndvështrim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

23. Kërkesat pas seancës dëgjimore

23.1. Pas njoftimit me anë të postës elektronike në datën 17.3.2021, ora 15:31, për njoftimin e datës së seancës për shpalljen e vendimit në datën 18.3.2021, subjekti ka dërguar pranë Komisionit kërkesën e protokolluar me nr. *** prot., për përjashtimin e trupit gjykues, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 84/2016, nenin 30 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile. Me anë të postës elektronike të dërguar nga adresa zyrtare e Komisionit në datën 18.3.2021, ora 15:17, subjekti u njoftua se: *“Komisioni ju vë në dijeni se administroi kërkesën tuaj, dërguar përmes shërbimit postar të Postës Shqiptare sh.a. me datë dërgimi 18.3.2021, ora 12:10, dhe me datë mbërritjeje në institucionin tonë më 18.3.2021, ora 13:37. Kërkesa juaj me objekt ‘Kërkesë për përjashtimin e trupit gjykues’, u protokollua me tonën me nr. *** prot., datë 18.3.2021, dhe në mbledhjen e datës 18.3.2021, ora 16:00, Komisioni, duke e konsideruar këtë kërkesë si procedurale, vendosi se gjendet në pamundësi për ngritjen e një trupit gjykues për shqyrtimin e saj, sipas nenit 27 të ligjit nr. 84/2016, pasi trupi gjykues që rivlerëson çështjen tuaj, i përbërë nga Genta Tafa (Bungo), Lulzim Hamitaj dhe Alma Faskaj, pas seancës dëgjimore të mbajtur me ju, në mbledhjen e datës 17.3.2021, në orën 13:05 - 14:35 ka marrë vendim për çështjen tuaj, i cili do t’ju komunikohet në seancën për shpalljen e vendimit datë 19.3.2021, ora 9:00. Për këtë arsye, në kushtet kur ka përfunduar vendimmarrja e trupit gjykues që rivlerëson çështjen tuaj, Komisioni nuk mund të shqyrtojë kërkesën tuaj.”*

V. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

24. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

25. Referuar vendimit nr. 2/2017⁶ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

26. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklaratën e rivlerësimit kalimtar Vetting”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja; (ë) denoncimet e publikut; si dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit, apo nëpërmjet postës elektronike.

A. VLERËSIMI I PASURISË

27. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si edhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

28. Subjekti Rita Gjati ka punuar në periudhën:

- korrik 2002 - korrik 2008 si prokurore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë;
- janar 2013 e në vijim si prokurore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe më pas në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës.

Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 25.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

29. Apartament⁷ me sip. 130 m², ndodhur në Sarandë, me nr. pasurie *****, me vlerë 4.000.000 lekë. Pjesa takuese: 50 %.

⁶ “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

⁷ Subjekti ka depozituar këto dokumente: (i) vërtetim të ZVRPP-së Sarandë; (ii) vërtetim nga dokumenti hipotekor datë 22.2.2001; (iii) kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.6.2002; (iv) vërtetim nga dokumenti hipotekor datë 10.6.2002; (v) kërkesë për regjistrim datë 11.6.2002, për truallin me sip. 511 m²; (vi) vërtetim nr. ** prot., datë 14.10.2016, “F.B”, Sarandë; (vii) informacion nga OSHEE-ja për abonentin K. Gj + informacion për pagesën e energjisë elektrike për periudhën janar 2009 e vazhdim.

Burimi sipas deklaratës “Vetting”: kredi bankare + të ardhura nga paga e bashkëshortit ndër vite, 1986 – 2002 dhe e subjektit për vitet 1997 – 2002 + shitje trualli në Sarandë, përfituar nga bashkia.

Konstatimi i ILDKPKI-së:

- *mungesë dokumentacioni justifikues preventiv/situacion punimesh për vlerën e apartamentit me sip. 130 m², në Sarandë.*
- *është e paqartë vlera e investimit të kryer në secilin vit për periudhën 1996 – 2003, për apartamentin me sip. 130 m² në Sarandë. Rezulton se shitja e truallit dhe kredia i përkasin vitit 2002;*
- *mosdeklarim në deklaratën e interesave private ndër vite dhe në deklaratën e pasurisë “Vetting”, të garazhit me sip. 98 m², Sarandë, i cili është në bashkëpronësi të bashkëshortit dhe banorëve të pallatit ku ndodhet apartamenti me sip. 130 m²;*
- *rezulton se trualli me sip. 511 m², Sarandë, është blerë nga Bashkia Sarandë në datën 7.6.2002, në vlerën 245.280 lekë dhe është shitur pas 4 ditëve në vlerën 1.000.000 lekë.*

🚩 Hetimi⁸/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni

29.1. Subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë në bashkëpronësi apartamentin me sip. 130 m², me nr. pasurie *****, z. k. ***, ndodhur në Sarandë. Nga hetimi në lidhje me këtë apartament rezulton se me vendimin nr. **, datë 9.12.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë është vendosur njohja e së drejtës së pronësisë së bashkëshortit të subjektit dhe 16 punonjësve të tjerë të Ndërmarrjes së Ujërave D të një pallati pesëkatësh, i përbërë secili apartament me 3 dhoma, sallon + kuzhinë, 2 banja, korridor dhe verandë, si dhe garazhit të ndodhur në këtë pallat. Bashkëshortit të subjektit i është njohur e drejta e pronësisë mbi apartamentin nr. **, kati i dytë.

29.2. Komisioni administroi dosjen gjyqësore⁹, që i përket vendimit të mësipërm, nga analizimi i së cilës rezulton se:

- trualli mbi të cilin është ndërtuar pallati me sip. 750 m² është blerë nga punonjësit e Ndërmarrjes së Ujërave D, me kontratë nr. *****, datë 28.10.1997, për shumën 360.000 lekë.
- leja e ndërtimi është lëshuar në datën 7.5.1996.
- në datën 17.6.1996 është lidhur kontrata e sipërmarrjes midis përfaqësuesve të punonjësve të Ndërmarrjes së Ujërave Delvinë, sipërmarrësit Ll.P dhe z. S. P për ndërtimin e një pallati pesëkatësh.
- në datën 31.7.1996 znj. V.T, punonjëse e Ndërmarrjes së Ujërave D, ka lidhur aktmarrëveshjen me administratorin e pallatit, z. I.N, për hyrjen * në katin e dytë të pallatit për një vlerë prej 1.499.500 lekësh. Në bazë të kësaj aktmarrëveshjeje ka paguar shumën 500.000 lekë dhe do të vijojë të paguajë shumën e mbetur, e cila sipas marrëveshjes duhej të paguhej deri më 17.2.1997.
- në datën 7.8.1996 bashkëshorti i subjektit ka nënshkruar aktmarrëveshjen nr. *****, nëpërmjet së cilës znj. V.T i kalon të drejtën e pronësisë bashkëshortit të subjektit për të ndërtuar banesën me shpenzimet e tij, në këmbim të shumës 200.000 lekë.

⁸ Hetimi i Komisionit: shkresë nr. *** prot., datë 18.11.2020, drejtuar ASHK-së Sarandë; kthim përgjigje nr. **** prot., datë 9.12.2020, e ASHK-së Sarandë; shkresë nr. **** prot., datë 27.11.2020, drejtuar Arkivës Qendrore të Sistemit Gjyqësor; kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 1.12.2020, i Arkivës Shtetërore të Sistemit Gjyqësor.

⁹ Kthim përgjigjeje nr. **** prot., datë 1.12.2020, i Arkivës Shtetërore të Sistemit Gjyqësor.

- vi. bazuar në procesverbalin e datës 20.2.1997, rezulton se pallati ka përfunduar dhe janë në ndërtim e sipër dy katet e fundit.
- vii. në datën 21.5.1998 është lëshuar autorizimi nga administratori I. N, nëpërmjet së cilit autorizohet shtetasi K.Gj që të marrë hyrjen *, kati i dytë, me sip. 150 m² dhe garazh me sip. 16 m².
- viii. në datën 23.7.1999 bashkëshorti i subjektit ka kërkuar të jetë palë në çështjen civile që i përket vendimit të mësipërm.
- ix. në këtë kërkesë bashkëshorti i subjektit deklaroi se investimi i tij për ndërtimin e hyrjes ka filluar paralel me punimet dhe ka vazhduar sipas kontratës së lidhur midis administratorit dhe znj. V.T në vitin 1996... administratori nuk e ka plotësuar detyrimin e tij për t'i dorëzuar apartamentin dhe garazhin... ka investuar për garazhin njëjloj si të gjithë.

29.3. Në lidhje me këtë apartament, subjekti ka sqaruar pranë ILDKPKI-së, në datën 22.2.2016¹⁰ se bashkëshorti i saj e ka fituar të drejtën e posedimit për ndërtimin nëpërmjet aktmarrëveshjes datë 7.8.1996, midis shtetases V. T dhe tij. Pas aktmarrëveshjes i kanë paguar zonjës shumën 200.000 lekë... Në vitin 2001 ka filluar punimet për përfundimin e banesës për të qenë e banueshme. Si burim krijimi prej vitit 2001 - 2002 të vlerës 3.300.000 lekë, që ka shpenzuar për investimin e apartamentit, ka shërbyer tërheqja e depozitës bankare tek ish-Banka e Kursimeve në shumën 800.000 lekë, dy kreditë në vlerën 1.000.000 lekë tek Fondacioni B në vitin 2002, si dhe të ardhurat nga shitja e sheshit të ndërtimit në vlerën 1.000.000 lekë... pjesa tjetër nga kursimet në vite nga pagat.

Bazuar në aktkolaudimin¹¹ e pallatit rezulton se ai ka qenë i përfunduar në datën 15.7.1999, datë në të cilën është hartuar ky akt.

29.4. Nga analiza financiare rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për ndërtimin e këtij apartamenti në shumën -4.438.395,82 lekë, pasi:

- i. nuk rezulton që të ketë paguar detyrimet tatimore për të ardhurat e përfituara nga shitja e truallit me sip. 511 m² me kontratë shitblerjeje nr. *****, datë 11.6.2002, me çmimin 1.000.000 lekë – ky truall është blerë nga bashkëshorti i saj në datën 7.6.2002, me kontratën nr. *****, nga Bashkia Sarandë, për shumën 245.280 lekë;
- ii. nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të jetesës;
- iii. dy kreditë e marra prej saj nga “Fondi B” nuk mund të shërbejnë si burim, pasi janë marrë pas vitit 2002;
- iv. në analizë janë marrë në konsideratë vetëm të ardhurat e dokumentuara.

Tabela nr. 1 – analiza financiare

	1992 - 1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	
PASURI	700,000.00	999,500.00	-	-	-	2,000,000.00	1,545,280.00	5,244,780.00
Apartament, sip. 130 m ² *** vol. nr. *, f. *** Sarandë	500,000.00	999,500.00						4,999,500.00
	200,000.00							

¹⁰ Shihni procesverbalin datë 22.2.2016, administruar me shkresën nr. *** prot., datë 9.12.2020, të ILDKPKI-së.

¹¹ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. ***** prot., datë 9.12.2020, të ASHK-së Sarandë.

						2,000,000.00	1,300,000.00	
Truall shesh ndërtimi, sip. 511 m ²							245,280.00	245,280.00
TË ARDHURA, dokumentuar	-	161,411.00	343,285.00	293,731.00	424,900.00	473,999.00	964,858.00	2,662,184.00
Të ardhura nga paga e subjektit	-	161,411.00	228,926.00	242,899.00	264,925.00	303,184.00	265,122.00	1,466,467.00
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	-	-	114,359.00	50,832.00	159,975.00	170,815.00	199,736.00	695,717.00
Kredi "Fondi B" datë 1.7.2002	-	-	-	-	-	-	500,000.00	500,000.00
SHPENZIME	-	106,531.26	226,568.10	193,862.46	324,000.00	324,000.00	680,838.00	1,855,799.82
Shpenzime jetese	-	106,531.26	226,568.10	193,862.46	324,000.00	324,000.00	281,682.00	1,456,643.82
Pagese për leje ndërtimi							97,626.00	97,626.00
Paguar këstet e kredisë "Fondi B", datë 1.7.2002							301,530.00	301,530.00
NË TOTAL								- 4,438,395.82

29.5. ZVRPP-ja Sarandë informon se subjekti ka në bashkëpronësi garazh me sip. 98 m², me nr. pasurie ****- G*, z. k. ***. Në lidhje me këtë garazh subjekti, në përgjigje të pyetësorit datë 17.11.2020, ka sqaruar se *nuk ka asnjë shpenzim të veçantë për hapësirën në bashkëpronësi e destinuar për garazh, pasi është kati përdhes i pallatit (nuk ka lartësinë e katit normal të pallatit). Dhe sot e kësaj dite është hapësirë e pa ndarë, e pa mbyllur dhe e pa regjistruar. Nuk ka as informacion dhe as dokumentacion sa mund të jetë pjesa takuese në atë hapësirë.*

29.6. Deklarimet e subjektit në lidhje me garazhin nuk përputhen me dokumentacionin e administruar, nga ku rezulton se:

- i. banorët e pallati kanë kryer ndarjen e garazheve¹² ku bashkëshorti i subjektit ka përfutur garazh në seksionin e tretë. Sipas kësaj marrëveshjeje të firmosur edhe nga bashkëshorti, atij i takojnë 14 m² garazh.
- ii. bashkëshorti i saj ka qenë palë në gjykim, ku me vendimin nr. ***, datë 9.12.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë është vendosur njohja e së drejtës së pronësisë së tij dhe të punonjësve të tjerë të Ndërmarrjes së Ujërave D të një pallati pesëkatësh, i përbërë secili apartament me 3 dhoma sallon + kuzhinë, 2 banja, korridor dhe

¹² Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. **** prot., datë 9.12.2020, të ASHK-së Sarandë.

verandë, si dhe njohja e së drejtës së bashkëpronësisë (jo të detyrueshme) të garazhit të ndodhur në këtë pallat.

- iii. në datën 21.5.1998 është lëshuar autorizimi nga administratori I. N, nëpërmjet së cilit autorizohet shtetasi K. Gj që të marrë hyrjen **, kati ***, me sip. 150 m² dhe garazh me sip.16 m².
- iv. bashkëshorti i subjektit, në kërkesën drejtuar gjykatës për të qenë pjesë e gjykimit, ka deklaruar se ka investuar për garazhin.

29.7. Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016: (i) subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për ndërtimin e apartamentit në shumën 4.438.395,82 lekë; (ii) subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” pasurinë garazh me sip. 98 m², në bashkëpronësi; (iii) deklaratimet e subjektit se nuk ka dijeni për këtë pasuri nuk përputhen me dokumentacionin e administruar, nga ku rezulton se bashkëshorti i saj ka pasur dijeni të plotë për garazhin dhe pjesën e tij takuese.

29.8. Në parashtrimet e depozituara pranë Komisionit, subjekti ka pretenduar se:

i. Apartamenti në Sarandë nuk ka përfunduar gati për banim në vitin 1999. Në këtë vit ishin përfunduar punimet e përbashkëta, kontribut i secilit përfitues (struktura beton-arme, mure rrethuese të çdo apartamenti, instalime elektrike e hidraulike deri në hyrje të çdo apartamenti). Pas kësaj faze, secili banor ka filluar dhe përfunduar punimet e brendshme individualisht dhe pavarësisht nga njëri-tjetri, sipas nevojës dhe mundësive financiare. Kostoja financiare e paguar nga ana e tyre për këtë fazë punimesh është 1.300.000 lekë plus 200.000 lekë blerja e të drejtës për t’u bërë një nga bashkëfinancuesit e ndërtimit. Pasi kanë bërë punimet e brendshme dhe pjesërisht mobilimin, kanë filluar të banojnë në apartamentin në Sarandë vetëm në muajin korrik të vitit 2002, kur ka filluar detyrën si prokurore. Deri atë ditë ka banuar me familjen e vjehrrit, siç ka deklaruar paraprakisht, dhe të gjitha të ardhurat nga pagat e saj dhe të bashkëshortit dhe çdo ndihmë nga vjehrrit, vëllezërit e motrat e bashkëshortit, i ka kursyer për shtëpinë e tyre. Që në mars të vitit 1998 të gjitha kursimet e saj, por edhe të bashkëshortit, i ka depozituar në ish-Bankën e Kursimeve. Ligji nr. 84/2016, në pikën 2 të nenit 32, parashikon mundësinë e çdo subjekti që: *“[...] nëse është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë – t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit shkaqet e pamundësisë [...]”*. Shkresa nr. * prot., datë 6.1.2020, e “Raiffeisen Bank” vërteton pamundësinë objektive për të vërtetuar vlerën me të cilën ka çelur depozitën në mënyrë direkte. Shkaqet e pamundësisë janë objektive dhe të pavarura nga subjekti, në kushtet kur të dhënat nuk disponohen nga institucioni bankar.

ii. Gjithashtu është përdorur edhe shuma 1.000.000 lekë, të ardhura nga shitja e sheshit të ndërtimit në vitin 2002, për të cilën, sipas shkresës nr. *** prot., datë 9.2.2021, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Sektori i Taksave Direkte, rezulton se si subjekt rivlerësimi ka paguar të gjitha detyrimet ligjore ndaj shtetit (taksa, tatime etj.) në burim, ditën e regjistrimit të tij në ZVRPP-në Sarandë. Prandaj të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie janë të ligjshme dhe për këtë shkak kërkon të bëhen pjesë e të përllogariten në bilancet e atyre viteve.

Po ashtu, edhe vërtetimet e pagave të bashkëshortit për vitet 1994 - 1997 konfirmojnë pagesën e ligjshme për këtë periudhë nga shkolla e mesme “A. D” (sot Bashkia Finiq).

Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. ***, datë 10.2.2021, të shtetasit S. Ll, i cili deklaroi se: *“[...] Deklaroj me përgjegjësi të plotë ligjore se kam kryer detyrën e drejtorit të shkollës 8-vjeçare në fshatin Ç, Sarandë, prej vitit 1992 - 1998 dhe nga vitit 1998 - 1999 kam punuar pranë Ministrisë së Arsimit të Greqisë. Në muajin dhjetor 1999 – 15.1.2003, unë, deklaruesi, kam kryer detyrën e inspektorit të Drejtorisë Arsimore për Minoritetet në rrethin e Sarandës dhe prej vitit 2001 - 2004 kam qenë kryetar i Shoqatës së Mësuesve për Minoritetin*

GreK në rrethin Sarandë. Gjatë këtyre viteve nga I. K. N. E për bashkëkombësit grekë me banim jashtë Greqisë është ofruar ndihmë ekonomike mësuesve të minoriteti në rrethin e Sarandës në shumën 250.000 dhrahmi në vit, e cila u jepej mësuesve të minoritetit prej vitit shkollor 1993 - 1994 dhe me hyrjen e euros çdo mësues i minoriteti grek në rrethin e Sarandës merrte nga ku institucion për çdo vit vlerën prej 800 euro, e cila vazhdoi të jepej deri në vitin 2003. Prej mësuesve të minoritetit në rrethin e Sarandës përfitonte këtë ndihmë dhe shtetasi K. Gj [...]”.

iii. Në deklaratën e vitit 2003 “para fillimit të detyrës”, ka deklaruar banesën në Sarandë me vlerë 3.500.000 lekë, kjo sipas deklaratës së depozituar në ILDKPKI. Në vitin 2004 ka deklaruar vlerën prej 4.000.000 lekësh, për shkak se ka kryer punime shtesë në apartament, duke vënë në dispozicion të ILDKPKI-së edhe dokumentacion shpjegues në vitin 2006.

iv. Kreditë e marra nga subjekti në institucionin financiar “Fondi B” kanë shërbyer për punime të kryera, por të shlyera më vonë se dita kur ka filluar të banojë dhe ky fakt është deklaruar në ILDKPKI në vitet 2006 dhe 2016. Në pyetësorët nëntor-dhjetor të vitit 2020 ka sqaruar se fillimisht ka rregulluar vetëm 1 dhomë gjumi dhe kuzhinën, për shkak se djali fillonte shkollën në shtator dhe në fshat ku jetonin me vjehrrin nuk kishte shkollë. Punimet e tjera (mobilim dhe pajisje) kanë vazhduar edhe pas këtij momenti sipas mundësive.

v. Në lidhje me garazhin, subjekti sqaron se:

- a. me deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe pyetësorin standard, krahas dokumenteve të tjera të apartamentit, ka paraqitur vërtetim të lëshuar nga ZVRPP-ja Sarandë, me të cilin provohet se shtetasi K. Gj dhe R. Gjati disponojnë të regjistruar një apartament banimi me sip. 130 m² në Sarandë ... Në janar të vitit 2020 ASHK-ja Sarandë e vë në dijeni se nuk ka pasuri të regjistruar sipas të dhënave në sistem. Subjektit i rezulton se të njëjtin fakt ASHK-ja Sarandë i ka vënë në dijeni edhe Komisionit në atë periudhë;
- b. garazhi (vendparkimi), siç i ka rezultuar në atë kohë, nuk ka qenë i regjistruar në bashkëpronësi;
- c. në vitin 2003 ka depozituar dokumentacionin përkatës për blerjen e apartamentit, në të cilin është i përfshirë edhe vendparkimi i hapur, i cili pavarësisht se në vendimin e gjykatës është cituar “garazh”, nga fotografitë rezulton qartë se është një vend i destinuar për parkim, vetëm për banorët e pallatit. Për korrektësi, citon subjekti, vendimi nr. ***, datë 9.12.1999, i gjykatës saktëson se garazhi shtrihet në tre seksionet e pallatit. Por realisht, sot vetëm pjesa poshtë dy seksioneve është e lirë për garazh a vendparkim, pasi në një seksion kjo pjesë është e ndërtuar me apartamente. Ky fakt nuk është pasqyruar në vendimin e sipërcituar të gjykatës, sepse ndryshimi i projektit ka ndodhur më vonë. Gjithashtu, në vendimin e gjykatës bëhet fjalë për 16 apartamente, ndërkohë në pallat ka 20 apartamente. Pra, gjendja e pronës ka ndryshuar pavarësisht vendimit të gjykatës së vitit 1999;
- d. fakti që ende nuk disponojnë certifikatë pronësie për këtë hapësirë, fakti që edhe pse ka kërkuar vërtetim nga ZVRPP-ja Sarandë zyrtarisht për pronën e regjistruar dhe nuk i është konfirmuar asnjëherë deri në nëntor të vitit 2020 asnjë e dhënë për garazhin (vendparkimin poshtë pallatit), tregon se ajo nuk ka ndërmarrë asnjë veprim ligjor për ta regjistruar atë, në situatën kur vetë, si regjistrim bashkëpronësie ka problematika ligjore, siç e ka informuar zyrtarisht ASHK-në Sarandë.

vi. Në datën 26.2.2021 subjekti ka dërguar prapësime shtesë në lidhje me garazhin, si vijon:

- a. ASHK-ja Sarandë ka informuar si Komisionin, edhe atë vetë, se *regjistrimi i garazheve ka ardhur si rrjedhojë e zbatimit të dispozitivit të të njëjtit vendim gjyqësor, i cili është shprehur për bashkëpronësinë e detyrueshme të këtij ambienti dhe rezulton të jetë i*

ndarë në 3 seksione, dokumentacion i depozituar nga administratori I. N. Ish-administratori I.N nuk është banor në këtë pallat, apartamentin e tij e ka shitur pa banuar asnjë ditë. Veprimet deri në regjistrimin e pallatit në ZVRPP janë kryer nga ai me cilësinë e ish-drejtorit të Ndërmarrjes së Ujërave D, punonjësit e së cilës ishin investitorë, bashkë me drejtorin e tyre. Pas regjistrimit të ndërtimit në vitin 2000 ai nuk ka figuruar, as nuk figuron të këtë në pronësi apartament në pallat. ASHK-ja Sarandë e konsideron “bashkëpronësi e detyruar” këtë vendparkim të hapur, njëlloj si ambientet e tjera të përbashkëta si: shkallë, tarracë, shesh ndërtimi, të cilat janë destinuar për përdorim nga të gjithë banorët e pallatit. Regjimi juridik i bashkëpronësisë së detyruar sipas nenit 209 të Kodit Civil ka këtë përcaktim: “[...] Në katet ose njësitë e ndara të kateve të një ndërtese që ndodhen në pronësi të veçantë të pronarëve të ndryshëm, janë në bashkëpronësi të detyrueshme të tyre, gjersa në aktin e pronësisë nuk është caktuar ndryshe, këto objekte: [...]”, trualli mbi të cilin është ngritur ndërtesa, themelet, muret kryesore, muret ndarëse të brendshme, shkallët, hollet, çatia ose tarraca, oxhaqet, vendparkimet, si dhe të gjitha ato objekte të ndërtesës, që kanë karakter të tillë dhe shërbejnë për përdorim të përbashkët [...]”. Subjekti ka cituar edhe nenet 5, 8 dhe 28 të ligjit nr. 10112, datë 9.4.2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”, si dhe nenet 1-3 të VKM-së nr. 1011, datë 10.12.2010 “Për miratimin e formatit tip të aktit të bashkëpronësisë.”;

- b. subjekti ka pretenduar se referuar përcaktimeve ligjore sipas Kodit Civil dhe ligjit organik e akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe dokumentacionit zyrtar të ASHK-së Sarandë, administruar si nga Komisioni, edhe nga subjekti, rezulton qartë se nuk jemi para ekzistencës së pasurisë së paluajtshme të paregjistruar dhe të padeklaruar;
- c. gjithashtu, subjekti vlerëson të rritshme se si pasuri në bashkëpronësi të detyrueshme garazhi as nuk mund të rrethohet, as të ndahet, sepse bëhet jo funksionale dhe mbyll kalimin për bashkëpronarët e tjerë. Bashkëpronësia e detyrueshme (si parkim i hapur, vendparkim) shtrihet poshtë dy seksioneve nga tre, që ka pallati. Në njërin nga seksionet është ndërtuar apartament pas vendimit të gjykatës, që ka njohur pronësinë e pallatit.

29.9. Pasi shqyrtoi parashtrimet e subjektit, për mungesën e burimeve të ligjshme për ndërtimin e apartamentit, trupë gjykues vlerëson se:

i. në lidhje me shumën 1.000.000 lekë, për të cilën subjekti pretendon se për sa kohë kjo pasuri rezulton e regjistruar në emër të blerësit, janë paguar edhe detyrimet tatimore prej saj, ka rezultuar se nuk ka depozituar asnjë dokument për të provuar që nga ana e saj janë paguar detyrimet tatimore. Shkresa nr. *** prot., e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, e depozituar prej subjektit, nuk provon detyrimet tatimore për këtë shumë. Kjo pasuri rezulton të jetë regjistruar në vitin 2016 dhe në dokumentacionin e depozituar nga ASHK-ja Sarandë, si në dosjen e ILDKPKI-së, ashtu edhe gjatë hetimit administrativ, nuk rezulton të jetë pjesë dokumenti i pagimit të detyrimeve tatimore për shitjen e truallit në vitin 2002. Në përfundim, Komisioni nuk do të përfshijë në analizë financiare shumën 1.000.000 lekë, pasi nuk provohet që janë paguar detyrimet tatimore nga subjekti i rivlerësimit;

ii. në lidhje me pretendimin se deri në vitin 2002 ka jetuar me vjehrrin e saj dhe se ai ka kontribuar duke i mbuluar shpenzimet e jetesës, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. ****, datë 10.2.2021, të z. S.Gj.

Komisioni konstaton se subjekti nuk e ka deklaruar në deklaratën “Vetting” faktin se nga familjarët e bashkëshortit t’i jenë dhënë të ardhura/ndihma, apo se vjehri e ka ndihmuar me të ardhura. Ky fakt nuk rezulton të jetë deklaruar as në deklaratat periodike, por deklarohet vetëm pas kalimit të barrës së provës, pas njohjes me rezultatin negativ të analizës financiare për

ndërtimin e apartamentit. Për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit nuk rezulton të jetë i provuar dhe nuk do të merret në konsideratë;

iii. në lidhje me pretendimin se bashkëshorti i subjektit ka përfutur të ardhura duke qenë pjesë e minoritetit grek, Komision vlerëson se ky pretendim është paraqitur për herë të parë pas kalimit të barrës së provës. Subjekti nuk ka depozituar asnjë dokument zyrtar për të vërtetuar pretendimin e saj, përveç një deklaratë noteriale të një shtetasi, e cila është në nivel deklarativ. Gjithashtu, këto të ardhura nuk janë deklaruar nga subjekti as në DPV/2003 dhe as në deklaratën “Vetting”. Komisioni vlerëson të mos i marrë në konsideratë këto të ardhura në analizën financiare, pasi ato nuk provohen se janë marrë nga bashkëshorti i subjektit, si dhe vetë ajo nuk rezulton t’i ketë deklaruar ndonjëherë;

iv. në lidhje me kohën e kryerjes së punimeve dhe vlerës së tyre, Komisioni i është referuar deklaratimeve të subjektit ndër vite, duke marrë si kohë të përfundimit vitin 2002. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit se punimet kanë vijuar edhe më vonë apo se pagesat janë bërë më vonë, nuk mbështeten në prova. Komisioni vlerëson të theksojë faktin se subjekti nuk ka deklaruar apo sqaruar në deklaratën “Vetting” asnjë prej rrethanave të mësipërme, me qëllim që Komisioni të merrte në konsideratë shpjegimet e saj. Këto shpjegime janë bërë vetëm pas rezultatit negativ të analizës financiare. Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar se si burim kanë shërbyer të ardhurat e saj dhe të bashkëshortit nga viti 1986 - 2002, pra, duke nënkuptuar faktin se ky apartament është likuiduar brenda vitit 2002.

29.10. Komisioni ka ribërë dhe një herë analizën financiare për këtë apartament mbështetur në dokumentacionin e depozituar nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

Tabela nr. 2

	1992 - 1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	
PASURI	700,000.00	999,500.00	0.00	0.00	0.00	2,000,000.00	1,545,280.00	5,244,780.00
Apartament sip. 130 m ² , *** vol. nr. *, f. ***, Sarandë	500,000.00	999,500.00						4,999,500.00
	200,000.00					2,000,000.00	1,300,000.00	
Truall shesh ndërtimi sip. 511 m ²							245,280.00	245,280.00
TË ARDHURA, dokumentuar	216,567.00	194,625.00	343,285.00	383,266.00	424,900.00	473,999.00	964,858.00	2,784,933.00
Të ardhura nga paga e subjektit	0.00	161,411.00	228,926.00	242,899.00	264,925.00	303,184.00	265,122.00	1,466,467.00
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	216,567.00	33,214.00	114,359.00	140,367.00	159,975.00	170,815.00	199,736.00	1,035,033.00
Kredi “Fondi B”, datë 1.7.2002							500,000.00	500,000.00
SHPENZIME	142,934.22	128,452.50	226,568.10	252,955.56	324,000.00	324,000.00	680,838.00	1,936,814.16
Shpenzime jetese	142,934.22	128,452.50	226,568.10	252,955.56	324,000.00	324,000.00	281,682.00	1,680,592.38
Pagesë për leje ndërtimi							97,626.00	97,626.00
Paguar këstet e kredisë “Fondi B” datë 1.7.2002							301,530.00	301,530.00
NË TOTAL								- 4,396,661.16

Në analizë janë konsideruar të ardhurat e bashkëshortit, si vijon:

- për periudhën 20 gusht – dhjetor 1992 nuk u provua me asnjë dokumentacion ligjor paga e bashkëshortit të subjektit;
- vërtetimi nr. ** prot., datë 3.2.2021, nga Bashkia F, sipas të cilit vërtetohen të ardhurat e shtetasit K. Gj për periudhën 1993 – 1997;
- vërtetimi i Bashkisë Sarandë, Drejtoria e Arsimit dhe Administrimit Financiar, sipas të cilit vërtetohen të ardhurat e shtetasit K. Gj për periudhën shkurt 1998 – dhjetor 2000;
- vërtetimi i Bashkisë Sarandë, Drejtoria e Arsimit dhe Administrimit Financiar, sipas të cilit vërtetohen të ardhurat e shtetasit K. Gj për periudhën janar 2001 – dhjetor 2003.

29.11. Në lidhje me mosdeklarimin e garazhit, Komisioni ka konstatuar gjatë hetimit se ai është i regjistruar në ZVRPP-në Sarandë, me nr. pasurie ***- G*, z. k. ****, me sipërfaqe totale 98 m² dhe me bashkëpronar bashkëshortin e subjektit.

Banorët e pallatit, përfshirë edhe bashkëshortin e subjektit, kanë kryer ndarjen e garazheve¹³ ku bashkëshorti i saj e ka përfituar në seksionin e tretë. Sipas kësaj marrëveshjeje të firmosur dhe nga bashkëshorti i subjektit, atij i takojnë 14 m² garazh.

Bashkëshorti i saj ka qenë palë në gjykim, ku me vendimin nr. ***, datë 9.12.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë është vendosur njohja e së drejtës së pronësisë së tij dhe secilit prej punonjësve të tjerë të Ndërmarrjes së Ujërave D të apartamenteve të një pallati pesëkatësh, i përbërë secili apartament me 3 dhoma, sallon + kuzhinë, 2 banja, korridor dhe verandë, si dhe njohja e së drejtës së bashkëpronësisë (jo të detyrueshme) të garazhit të ndodhur në këtë pallat. Në këtë vendim gjykata shprehet edhe për bashkëpronësinë e detyrueshme, ku janë përfshirë ambientet e përdorimit të përbashkët të pallatit, ku nuk listohet garazhi. Bashkëshorti i subjektit, në kërkesën drejtuar gjykatës për të qenë pjesë e gjykimit, ka deklaruar se ka investuar për garazhin.

Për sa më sipër, provohet se bashkëshorti i subjektit ka pasur dijeni të plotë për pronësinë e tij mbi garazhin me sip. 98 m², për rrjedhojë, kjo pasuri duhej të deklarohet prej subjektit dhe personit të lidhur/bashkëshortit në deklaratën “Vetting”.

Për sa i përket argumentimit të subjektit se garazhi është në bashkëpronësi të detyrueshme, duke cituar¹⁴ nenin 209 të Kodit Civil, Komisioni konstaton se në kodin e publikuar në faqen zyrtare të QBZ-së, në nenin 209, fjala “vendparkim” nuk rezulton të jetë e shkruar, sikundër ka cituar subjekti në parashtrimet e saj. Bazuar në përgjigjen e ASHK-së Sarandë, rezulton se garazhi është në bashkëpronësi të vetëm 6 banorëve të pallatit, ndërkohë që pallati ka pasur më shumë se 6 banorë, pra, nuk është në bashkëpronësi të detyruar. Gjithashtu, kjo pasuri rezulton e regjistruar me numër pasurie të veçantë, në bashkëpronësi të bashkëshortit të subjektit dhe pesë personave të tjerë.

Komisioni vlerëson se subjekti duhet të kishte deklaruar në deklaratën “Vetting” rrethanat faktike të pasurisë garazh, për të cilat ka qenë në dijeni të plotë, duke shfaqur kështu vullnetin e tij për deklarim të saktë. Subjekti nuk duhej të kishte lënë zbulimin ose jo të fakteve në kuadër të hetimit administrativ, me qëllim shmangien e përgjegjësisë disiplinore për deklarim të pasaktë në kundërshtim me ligjin.

29.12. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën 4.396.661,16 lekë për ndërtimin e këtij apartamenti dhe nuk ka pasqyruar në mënyrë të plotë dhe të saktë në deklaratën “Vetting” burimet që kanë shërbyer për këtë apartament, si dhe kohën e saktë të kryerjes së pagesave. Pas analizës së fakteve dhe provave,

¹³ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 9.12.2020, të ASHK-së Sarandë.

¹⁴ Shihni faqen 2, paragrafi i parë, të parashtrimeve shtesë të subjektit, datë 26.2.2021

Komisioni vlerëson se subjekti: (i) nuk ka justifikuar me burime të ligjshme krijimin e pasurisë apartament të ndodhur në Sarandë; (ii) nuk ka deklaruar pasurinë garazh në bashkëpronësi; (iii) nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” në mënyrë të plotë dhe të saktë pasurinë. Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33/5, gerrat “a” dhe “b”, si dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

DETYRIMET FINANCIARE

30. Kredi bankare nr. *, datë 29.6.2015, në “Credins Bank”¹⁵. Gjendja e detyrimit: 373.577 lekë.**

🚩 Hetimi¹⁶/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni

30.1. Subjekti, në datën 25.6.2015, ka bërë aplikimin për kredi konsumatore për shumën 700.000 lekë. Në dokumentacionin e kredisë gjendet edhe raporti i analizës së datës 29.6.2015, në të cilin përcaktohet se subjekti jeton në Tiranë dhe se kredia do të merret për mobilimin e apartamentit ku banon subjektit. Në analizë është bërë dhe një preventiv i pajisjeve elektro-shtëpiake dhe mobilimit në shumën 745.000 lekë.

Në datën 29.6.2015 është lidhur kontrata e kredisë nr. ***, me afat 3-vjeçar për marrjen e shumës 700.000 lekë hua nga “Credins Bank”.

Në datën 29.1.2018 subjekti ka plotësuar formularin për shlyerje të parakohshme të kredisë, duke aplikuar për kredi të re.

Subjekti ka aplikuar në datën 23.2.2018 për kredi të re në “Credins Bank” me qëllim mobilimi. Në datën 14.2.2018, me kontratën nr. ***, subjekti ka marrë hua shumën 1.000.000 lekë, me afat 4-vjeçar nga “Credins Bank”.

30.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se subjekti ka qenë i saktë në deklaramin e kredisë në lidhje me vlerën dhe kohën e marrjes së saj, ndërkohë përdorimi i saj si burim është trajtuar në burimet e apartamentit në pronësi të djalit të saj.

DEKLARIMI I BASHKËSHORTIT TË SUBJEKTIT, Z. K.GJ – DEKLARIMI I PASURIVE

31. Kredi bankare nr. **, datë 13.12.2016, në “Tirana Bank”¹⁷. Gjendja e detyrimit: 435.757 lekë.**

🚩 Hetimi¹⁸/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

31.1. Subjekti, së bashku me bashkëshortin e saj, me kontratën e kredisë konsumatore nr. ****, datë 15.12.2016, kanë marrë hua me afat 3-vjeçar nga “Tirana Bank” shumën 450.000 lekë. Në nenin 2.1 të kredisë specifikohet se kredia do të përdoret për mobilim shtëpie.

¹⁵ Subjekti ka depozituar këto dokumente: (i) kontratë kredie nr. ***, datë 29.6.2015 lekë; (ii) vërtetim datë 19.1.2017, i “Credins Bank”.

¹⁶ Hetimi i Komisionit: shkresë nr. *** prot., datë 16.1.2020, drejtuar bankave; shkresë nr. **** prot., datë 27.2.2020; kthim përgjigje “Credins Bank”; shkresë nr. **** prot., datë 18.11.2020, drejtuar “Credins Bank”; kthim përgjigje nr. ****, datë 2.12.2020, i “Credins Bank”.

¹⁷ Subjekti ka depozituar këto dokumente: (i) kontratë kredie nr. ****, datë 15.12.2016; (ii) mandat datë 15.12.2016, nga “Tirana Bank”; (iii) nxjerrje llogarie “Tirana Bank” për shtetasin K. Gj.

¹⁸ Hetimi i Komisionit: shkresë nr. *** prot., datë 16.1.2020, drejtuar bankave; shkresë nr. **** prot., datë 21.1.2020, e “Tirana Bank”; shkresë nr. **** prot., datë 7.12.2020, drejtuar “Tirana Bank”; shkresa kthim përgjigje nr. **** prot., datë 24.12.2020, e “Tirana Bank”.

Nga nxjerrja e llogarisë së bashkëshortit¹⁹ rezulton se në datën 15.12.2016 disbursohet kredia prej 450.000 lekësh dhe në po të njëjtën datë bashkëshorti e ka tërhequr këtë shumë.

31.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se subjekti ka qenë i saktë në deklaram.

DEKLARIMI I DJALIT TË SUBJEKTIT, M. GJ – DEKLARIMI I PASURIVE

32. Marrëveshje paraprake²⁰ për blerje apartament banimi në rrugën “F. T”, Tiranë, vlera: 6.000.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

Burimi sipas deklaratës “Vetting”: nuk është deklaruar burim.

Konstatimi i ILDKPKI-së:

- *mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për blerjen e apartamentit me sip. 100 m², në rrugën “F. T” nga djali i subjektit, në vitin 2015, në vlerën 6.000.000 lekë.*
- *është i paqartë fakti që për blerjen e apartamentit me sip. 100 m², në rrugën “F. T”, Tiranë është paguar në vitin 2015 shuma prej 2.000.000 lekësh dhe kështet e tjera do të paguhen në vazhdim, por pa përcaktuar ndonjë afat apo kusht.*
- *mosdeklarimin e detyrimit të mbetur në vlerën 4.000.000 lekë për blerje apartamenti, në deklaratën e interesave private periodike/vjetore 2015.*

🚩 Hetimi/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni

32.1. Bazuar në deklaratën noteriale nr. ****, datë 23.3.2016, z. Sh.K deklaroi se në datën 25.6.2015 ka marrë *cash* shumën prej 2.000.000 lekësh nga shtetasi M. Gj, si kështet të parë për blerje apartamenti 2+1, me sip. 100 m². Kështet e tjera do të likuidohen në vazhdimësi me marrëveshje midis palëve.

32.1.1. Nga të dhënat e sistemit *TIMS* rezulton se M. Gj në këtë datë nuk ka qenë në Shqipëri, pasi ai ka dalë në datën 17.5.2015 dhe ka hyrë në Shqipëri më 8.7.2015.

32.1.2. Në lidhje me këtë konstatim, subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 17.11.2020, ka sqaruar se *djali i saj M nuk ka qenë në Shqipëri atë ditë, as nuk ka deklaruar një fakt të tillë në ndonjë deklaratë para Komisionit dhe as në deklaratën “Vetting”.* Në të gjithë procedurën e nisur dhe deri në momentin aktual procedural, djali i saj nuk ka nënshkruar, nuk ka negociuar dhe nuk ka takuar asnjë person nga kjo shoqëri për këtë proces. Emri i djalit lidhet me procesin e blerjes së apartamentit, për shkak se filloi si negociim nga ana e tyre për një kontratë shkëmbimi trualli në Sarandë (në emër të M) me një apartament te zona e Freskut, Tiranë, që ndërtohej nga shoqëria “K” sh.p.k. *Procesi vazhdoi me emrin e djalit të tyre për shkak se për të blerë apartamentin në Tiranë ishte dakordësuar këmbimi i sheshit të ndërtimit me këtë subjekt. Për këtë proces djali ka firmosur prokurë të posaçme me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.5.2015 dhe nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.12.2019. Në deklaratën e datës 23.3.2016 para noterit, shtetasi Sh.K i është përgjigjur kërkesës së tyre për të konfirmuar pagesën e bërë për kështetin e parë. Ky dokument ishte detyrimi i saj ligjor për në ILDKPKI në deklarimin periodik vjetor. Pagesat janë bërë siç rezulton në fakt nga lëvizjet në bankë.*

32.1.3. Shpjegimet e subjektit në lidhje me deklaratën noteriale nuk janë bindëse, pasi së bashku me deklaratën “Vetting” ka depozituar deklaratën noteriale si dokument provues për të provuar pagesën e shumës 2.000.000 nga djali i saj. Subjekti nuk ka sqaruar as në deklaratën “Vetting” dhe as në DPV/2015 që pagesat për këtë apartament janë bërë prej saj dhe bashkëshortit.

¹⁹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 21.1.2020, të “Tirana Bank”.

²⁰ Subjekti ka paraqitur këto dokumente: (i) deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. **** kol., datë 23.3.2016; (ii) informacion nga OSHEE-ja për abonentin M. Gj.

Gjithashtu, ajo kishte detyrimin ligjor për të verifikuar deklaratën noteriale në të cilën, siç rezulton, përfshihen të dhëna që nuk përputhen me të dhënat e administruara.

32.1.4. Në përfundim të hetimit, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, sipas së cilit duket se subjekti ka depozituar së bashku me deklaratën “Vetting” një deklaratë noteriale në të cilën paraqiten të dhëna që nuk përputhen me të dhënat e administruara, pasi djali i saj nuk ka qenë në Shqipëri në datën 25.6.2015, për t'i dhënë shumën prej 2.000.000 lekësh *cash* shtetasit Sh. K.

32.1.5. Subjekti, në datën 26.2.2021, me prapësimet shtesë, sqaroi se: *“Lidhur me deklaratën para noterit të datës 23.3.2016, të shtetasit Sh. K. është deklarim i njëanshëm nga ana e tij, i kontestuar në momentin që është njohur me përmbajtjen, si për datën e dorëzimit të shumës, për mosdeklarimin e detyrimit të mbetur dhe për personin që i ka dorëzuar shumën [...]. Pasi është njohur me përmbajtjen e deklaratës ka kontestuar, por në pamundësi të korigjimit të saj brenda asaj dite dhe me shpjegimin e noteres se do të saktësohej çdo element në kontratën përfundimtare, e mori për ta depozituar në datën 28.3.2016 (vetëm 3 ditë para skadimit të afatit) në institucionin e Prokurorisë së Përgjithshme bashkë me deklaratat e kolegëve nga Prokuroria Kukës. Të gjitha deklaratat e pasurisë dërgoheshin dhe vazhdojnë të dërgohen nëpërmjet Prokurorisë së Përgjithshme. Sipas kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.2.2021, të apartamentit të banimit në Tiranë, rezulton se pagesat janë bërë në korrik dhe dhjetor të vitit 2015. [...] marrëdhënien juridiko-civile rezultoi se e kemi pasur me shtetasen M. K, si pronare e apartamentit që kemi blerë.”*

32.1.6. Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. ****, datë 23.2.2021 të znj. M. Sh (noterja që ka hartuar deklaratën noteriale), në të cilën deklarohet se: *“Në fillim të vitit 2016, në zyrën time ka ardhur Sh.K, i cili kërkoi të bëjë një deklaratë noteriale me të cilën deklarohet se nga djali K. Gj kishte marrë cash këstin e parë për një apartament [...]. Sh.K është paraqitur i vetëm dhe ka deklaruar (deklarim i njëanshëm) ato që kam shkruar në deklaratë, duke më shpjeguar se do të vinte ta merrte dhe ta paguante deklaratën shtetasi K.Gj, të cilin unë nuk e njihja.*

Një ditë më vonë ka ardhur shtetasi K. Gj me bashkëshorten e tij, e kanë lexuar dokumentin e firmosur dhe konstatuan pasaktësi në deklarimin e mësipërm, që lidheshin me datën e pagesës edhe për një pjesë të detyrimit total, që nuk ishte pasqyruar në dokument.

Pasi kam komunikuar me shtetasin Sh. K, i cili më njoftoi se nuk mund të vinte ato ditë për shkak të një problemi familjar, u kam thënë se çdo pasaktësi rregullohej me dokumentin përfundimtar të shitjes, pasi deklarata është veprim juridik i njëanshëm dhe rëndësi ka që shuma që keni paguar është e saktë dhe e njohur nga Sh.K [...].”

32.1.7. Bazuar në deklaratimet e mësipërme të subjektit, rezulton se ajo ka pasur dijeni për këtë deklaratë që në muajin mars të vitit 2016 dhe pavarësisht faktit se në të ka pasur të dhëna jo të sakta, pasi djali i saj nuk ka qenë në Shqipëri në datën 25.6.2015, e ka depozituar këtë deklaratë së bashku me deklaratën “Vetting”. Subjekti ka pasur të gjithë kohën e duhur për të rregulluar këtë gabim të pretenduar prej saj, por nuk ka kryer asnjë veprim.

32.1.8. Në lidhje me deklaratën noteriale të depozituar të noteres M.Sh, ajo nuk ka asnjë vlerë provuese, pasi nuk provon kohën e pagesës së këstit të parë të apartamentit, është në nivel deklarativ, është bërë gati 4 vjet më vonë nga plotësimi i deklaratës “Vetting”, si dhe është e paqartë për Komisionin se si një notere që harton një numër të konsiderueshëm deklaratash noteriale të mbajë mend me kaq saktësi, pasi ka dalë në pension, një ngjarje të ndodhur 5 vjet më përpara.

32.1.9. Subjekti deklaroi se DPV/2015 e ka dorëzuar në datën 28.3.2015, ndërkohë, nga verifikimi i DPV/2015 rezultoi se subjekti e ka depozituar më 31.3.2016. Subjekti deklaroi

se deklaratën nuk e ndryshoi, pasi nxitonte për ta dorëzuar në ILDKPKI së bashku me DPV/2015. Komisioni ka verifikuar dokumentacionin e depozituar pranë ILDKPKI-së²¹ nga subjekti në vitin 2015, nga ku rezulton se ajo ka depozituar vetëm dokumentet e identifikimit të saj dhe të familjarëve. Ndërkohë, deklarata e shtetasit Sh. K rezulton të jetë dorëzuar si pjesë e kontratës së premtim shitjes nr. ****, datë 6.12.2019 dhe kontratës së premtim shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. ****, datë 23.12.2019.

32.1.10. Komisioni vlerëson se subjekti duhet të kishte deklaruar në deklaratën “Vetting” rrethanat faktike të pasurisë apartament, për të cilat ka qenë në dijeni të plotë, duke shfaqur vullnetin e tij për deklarim të saktë. Subjekti nuk duhej të kishte lënë zbulimin ose jo të tyre në kuadër të hetimit administrativ, me qëllim shmangien e përgjegjësisë disiplinore për deklarim të pasaktë në kundërshtim me ligjin. Gjithashtu, Komisioni konstaton se subjekti, edhe pas kalimit të barrës së provës, ka vijuar duke mos deklaruar saktë rrethanat në lidhje me deklaratën noteriale, pasi nuk rezulton që të jetë depozituar pranë ILDKPKI-së në vitin 2015, si dhe nuk rezulton që të ketë depozituar DPV/2015 në datën 28.3.2016, por më 31.3.2016. Komisioni vlerëson se depozitimi i një deklarate noteriale, në të cilën paraqiten të dhëna që nuk përputhen me të dhënat e administruara gjatë hetimit administrativ, pasi djali i saj nuk ka qenë në Shqipëri në datën 25.6.2015, për t'i dhënë *cash* shumën 2.000.000 lekë shtetasit Sh. K, **e vë subjektin në kushtet e deklarimit të pasaktë, të paplotë, të pamjaftueshëm dhe të rremë, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33/5, gerrat “a” dhe “ç”, si dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.**

32.2. Si burim për pagesën e kështit të parë, në datën 25.6.2015, në shumën 2.000.000 lekë, në deklaratën “Vetting” është deklaruar:

i. Kredi bankare në shumën 700.000 lekë, në “Credins Bank”

Kjo kredi, bazuar në nxjerrjen e llogarisë së subjektit, rezulton të jetë disbursuar në datën 29.6.2015 dhe është tërhequr nga subjekti në të njëjtën datë, pra 4 ditë më vonë se pagesa e shumës 2.000.000 lekë dhe, për rrjedhojë, nuk mund të shërbejë si burim për blerjen e këtij apartamenti. Gjithashtu, aplikimin për këtë kredi subjekti e ka bërë në datën 25.6.2015²², pra në ditën që është dhënë shuma 2.000.000 lekë.

ii. Depozitë në shumën 1.000.000 lekë, në “Raiffeisen Bank” në emër të subjektit, përfituar nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë

Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në “Raiffeisen Bank”²³ rezulton se në datën 10.12.2013 i është paguar nga prokuroria detyrimi në shumën 1.219.862 lekë. Kjo shumë është përdorur për krijimin e një depozite, e cila më pas ka shërbyer për blerjen e kuotave në “R. P”²⁴ në datën 14.4.2015, në shumën 1.050.000 lekë. Në datën 30.7.2015 “Raiffeisen Invest” i ka transferuar subjektit shumën 999.512,93 lekë, në datën 3.8.2015 subjekti ka tërhequr shumën 500.000 lekë dhe në datën 4.8.2015 ka tërhequr shumën 250.000 lekë.

Bazuar në lëvizjet e mësipërme të llogarisë rezulton se shuma 1.000.000 lekë, e deklaruar si burim nga subjekti, nuk mund të ketë shërbyer për pagesën e apartamentit, pasi është tërhequr dy muaj pasi është kryer pagesa.

iii. *Overdraft* në shumën 300.000 lekë në “Credins Bank”, në emër të subjektit, i cili ka filluar në datën 6.11.2015

²¹ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 9.12.2020, të ILDKPKI-së, në pjesën që ka shënimin PV 2015.

²² Shihni shkresën nr. *** prot., datë 2.12.2020, të Credins Bank”.

²³ Shihni shkresën nr. **** prot., datë 24.1.2020, të “Raiffeisen Bank” dhe pyetësorin standard të subjektit.

²⁴ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 23.1.2020, të “Raiffeisen Invest”.

Nga nxjerrja e llogarisë në “Credins Bank”²⁵ nuk rezulton që subjekti të ketë tërhequr shumën 300.000 lekë gjatë vitit 2015 si *overdraft*, pasi gjendja e saj në fund të vitit 2015 ka qenë në shumën -133.093,93 lekë.

32.2.1. Në analizë të sa më sipër, rezulton se burimet e mësipërme të deklaruara nga djali i subjektit në deklaratën “Vetting”, por edhe në DPV/2015, nuk mund të shërbejnë si burime për pagesën e këstit të parë të apartamentit, për sa kohë këto mjete financiare nuk kanë qenë në dispozicion të subjektit/djalit të saj në datën 25.6.2015.

32.3. Komisioni ka kryer analizën financiare për mundësitë e pagesës për këtë pasuri.

Tabela nr. 3

PASURI	2,000,000.00
Apartament me sip. 83 m ² , Tiranë	2,000,000.00
TË ARDHURA, dokumentuar	663,283.00
Të ardhura nga paga e subjektit	333,372.00
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	329,911.00
SHPENZIME	726,338.75
Shpenzime jetese	448,552.00
Qira banese	72,000.00
Shpenzime udhëtimi	109,431.75
Shpenzime mobilimi	-
Shpenzime shkollimi	96,355.00
NË TOTAL	-2,063,055

32.3.1. Nga kjo analizë rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për pagesën e këstit të parë të këtij apartamenti, në shumën 2.063.055 lekë.

32.3.2. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka prapësuar se në kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.2.2021, janë përshkruar të gjithë veprimet e marrëdhënies juridiko-civile mes familjes së saj dhe ortakëve të shoqërisë, mënyra e pagesës, koha e pagesave, si dhe vlera e apartamentit. Këtë kontratë e ka vënë në dispozicion të Komisionit menjëherë sapo është hartuar. Lidhur me balancat financiare të vitit 2015 sqaron se ka deklaruar me përpikëri çdo detyrim ligjor.

32.3.3. Komisioni konstaton se subjekti nuk ka paraqitur asnjë provë për të vërtetuar se pagesa në shumën 2.000.000 lekë është bërë gjatë periudhës korrik - dhjetor 2015. Së bashku me deklaratën “Vetting” subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. ***, datë 23.3.2016 të z. Sh. K i cili deklaron se në datën 25.6.2015 ka marrë *cash* shumën prej 2.000.000 lekësh nga M. Gj, për rrjedhje, Komisioni e ka bërë analizën financiare për pagesën e këtij apartamenti deri në datën 25.6.2015. Nga kjo analizë rezulton se subjekti/personi i lidhur M.Gj nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për pagesën e këstit të parë të këtij apartamenti. Në lidhje me kontratën e datës 9.2.2021, Komisioni vlerëson të mos e marrë në konsideratë, pasi është një dokument i hartuar pas kalimit të barrës së provës subjektit dhe shumë kohë pas plotësimit të deklaratës “Vetting”.

32.3.4. Në përfundim të analizës së fakteve dhe provave, Komisioni vlerëson se personi i lidhur me subjektin/M. Gj: (i) nuk ka justifikuar me burime të ligjshme pagesën e këstit të parë për krijimin e pasurisë apartament, të ndodhur në Tiranë; si dhe (ii) nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” në mënyrë të plotë dhe të saktë burimin e kësaj pasurie. Si rrjedhje, subjekti ka kryer

²⁵ Shihni shkresën nr. **** prot., datë 7.2.2020

deklarim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D, pikat 1,3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33/5, germat “a” dhe “b”, si dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

32.4. Djali i subjektit deklaron në deklaratën “Vetting” se ka mbetur pa shlyer shuma prej 4.000.000 lekësh.

32.4.1. Nga hetimi ka rezultuar se:

i. Bashkëshorti i subjektit, në cilësinë e përfaqësuesit të djalit të saj, ka nënshkruar në datën 23.12.2019 kontratën premtim shitblerjeje të pasurisë së paluajtshme nr. **** me z. Sh. K (përfaqësuar me prokurë nga znj. M.K) për blerjen e apartamentit të mësipërm, ndodhur në rrugën “F. T”, Tiranë.

Në këtë kontratë përcaktohet se shuma 3.000.000 lekë do të bëhet me anë të bankës nga shitja që M.Gj i ka bërë një prone në Sarandë, sipas kontratës nr. *****, datë 6.12.2019. Shuma e mbetur prej 1.000.000 lekësh do të paguhet kur të bëhet kontrata e shitjes.

Në përgjigje të pyetësorit standard subjekti ka depozituar dokumentin “transferim shume”, datë 24.12.2019, në bazë të së cilit djali i saj ka transferuar shumën 24.000 euro në llogarinë e përfaqësueses së z. Sh.K, znj. M. K.

ii. Djali i subjektit, në datën 6.12.2019, ka lidhur kontratë²⁶ premtim shitjeje nr. ****, në të cilën parashikohet se:

- a) ka përfituar në bazë të vendimit nr. *, datë 11.8.2000, të Këshillit Bashkiak një shesh ndërtimi në bllokun K. *, parcela nr. ***, me sip. 550 m²;
- b) e posedon këtë truall;
- c) premtim t’i shesë z. A. P truallin e mësipërm për shumën 5.000.000 lekë, e cila do të paguhet me këste, si më poshtë:
 - kësti i parë në shumën 3.000.000 lekë brenda 10 ditëve nga nënshkrimi i kontratës;
 - kësti i dytë në shumën 1.000.000 lekë deri më 27.2.2020; si dhe
 - kësti i fundit në shumën 1.000.000 lekë në momentin e pajisjes me certifikatë pronësie për truallin objekt kontrate.

Bashkëlidhur kontratës datë 23.12.2019, gjendet prokura e posaçme nr. ****, datë 17.5.2015, në të cilën z. M. Gj deklaron se zotëron dhe disponon një truall me sip. 550 m², që ndodhet në Sarandë.

iii. Në datën 13.12.2019²⁷ prindërit e bashkëshortit të subjektit kanë nënshkruar deklaratën noteriale nr. ****, nëpërmjet së cilës janë dakord që të bllokohet në ASHK-në Sarandë pasuria me nr. ***, tokë arë, me sip. 3228 m², për të garantuar likuidimin e detyrimit që nipi i tyre M. Gj ka ndaj z. A.P. Në rast se nipi i tyre nuk likuidon detyrimin sipas kushteve dhe afateve të vendosura në kontratën nr. ****, datë 6.12.2019, ata janë dakord që kjo pasuri të kalojë në pronësi të z. A. P.

32.4.2. Komisioni konstaton se djali i subjektit ka përfituar nga Bashkia Sarandë një truall për ndërtim, pavarësisht se ishte vetëm 5 vjeç. Nga dokumentacioni, përfshirë edhe deklaratimet e vetë subjektit, rezulton se këtë truall djali i subjektit e ka pasur në zotërim që në vitin 2000, por ndërkohë subjekti nuk e ka deklaruar asnjëherë këtë pasuri në deklaratat periodike, përfshirë edhe deklaratën “Vetting”. Subjekti ka deklaruar²⁸ se këtë truall ka dashur ta shkëmbejë që në vitin 2013 me një apartament në zonën e Freskut, duke u provuar në këtë mënyrë fakti që djali i saj e ka zotëruar dhe disponuar këtë pasuri, për sa kohë subjekti ka dashur ta shkëmbejë me

²⁶ Shihni pyetësorin standard.

²⁷ Shkresë kthim përgjigjeje datë 25.11.2020, e notere L. T.

²⁸ Shihni pyetësorin datë 17.11.2020, dhe datë 23.12.2020

një pasuri tjetër. Subjektit, në lidhje me këtë truall, iu kalua barra e provës: (i) përfitimi i truallit nga djali minoreni i subjektit, vetëm 5 vjeç, është bërë në rrethana të dyshimta, duke qenë se ai nuk mund të përfitonte truall nga Bashkia Sarandë; (ii) djali i subjektit nuk rezultoi të ketë deklaruar në deklaratën “Vetting” dhe në asnjë deklaratë periodike zotërimin e një trualli me sip. 550 m²; (iii) ky truall nuk rezultoi të jetë i regjistruar në ASHK-në Sarandë, megjithëse është përfituar nëpërmjet Bashkisë Sarandë që në vitin 2000; (iv) duke qenë se zotërimi i këtij trualli nuk mund të verifikohet nëpërmjet të dhënave të ASHK-së Sarandë, duket sikur djali i subjektit ka kryer fshehje të pasurisë truall në deklaratën “Vetting”.

32.4.3. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, pretendoi se në kohën kur është regjistruar emri i djalit si përfitues potencial i sheshit të ndërtimit, ka qenë një procedurë thjesht deklarative: bashkëshorti i ka dorëzuar certifikatën familjare punonjësit të bashkisë, bashkë me kërkesën në emrin e tij. Në këtë kohë ajo ka qenë tërësisht jashtë kësaj marrëdhënieje, nuk ka qenë subjekt i ligjit dhe as ka qenë palë në këtë procedurë. Gjithmonë ka menduar se krahas emrit të djalit duhej të ishte shënuar edhe emri i bashkëshortit, si kryefamiljar. Subjekti pretendon se ka besuar se kjo situatë, mungesa e emrit të bashkëshortit, përbënte një lapsus apo gabim material në vendimin e Këshillit Bashkiak, gjendje juridike e cila mund të korrigjohet në çdo kohë, për sa kohë nuk i ka prodhuar pasojat ligjore dhe, siç edhe ka rezultuar, prona në fjalë ende nuk është regjistruar në emër të djalit. Më tej, subjekti parashtron se ndonëse për veprimet juridike të të miturit përgjigjet prindi apo kujdestari ligjor, një i mitur ka të drejtë të ketë përfitime pasurore, si për shembull, në rastin e trashëgimisë, në rastin e krijimit të depozitave bankare në emër të tij, madje edhe të blejë apo shesë të drejtat e tij pasurore të fituara si më lart, por veprimet juridike përkatëse kryhen nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor. Në këto kushte, nëse do të shtrohej çështja e nënshkrimit të ndonjë kontrate mes Bashkisë Sarandë dhe djali do të ishte i mitur, kuptohet që kontrata do të ishte nënshkruar nga bashkëshorti dhe jo nga djali, shpjegon subjekti. Më tej ajo pretendon se nuk është deklaruar prej saj ky truall deri në vitin 2020, sepse situata ligjore është jo e plotë dhe nuk varet as nga vullneti dhe as nga veprimet e djalit të saj, por nga pronari, Bashkia Sarandë. Në këto kushte, ka vlerësuar se mungon objekti i deklarimit (as pronë, as e drejtë reale, as gjë e përcaktuar). Me miratimin e VKM-së datë 22.5.2019, M.Gj ka paraqitur kërkesë në Bashkinë Sarandë me qëllim përfundimin në çdo rrethanë të kësaj gjendjeje.

32.4.4. Në datën 26.2.2021 subjekti paraqiti parashtrime shtesë se, në nenin 305 të Kodit Civil përcaktohet: *“Posedimi i personit jo pronar mund të jetë i ligjshëm kur poseduesi e ka posedimin nga pronari në bazë të një veprimi juridik, në bazë të ligjit ose të një akti administrativ”*. Kodi Civil në fuqi parashikon dy lloje posedimi: 1. posedimi natyral; 2. posedimi juridik [...]. Djali i saj nuk ka qenë dhe nuk është sjellë asnjëherë si posedues i mirëfilltë, në kuptimin ligjor, të truallit që Bashkia Sarandë e ka trajtuar si përfitues potencial. Nuk e ka zotëruar, nuk e ka përdorur dhe nuk ka shpenzuar për zhvillimin e tij, as nuk ka kryer ndonjë veprim juridik për të fituar pronësinë me parashkrim fitues. Vetëm pas miratimit të VKM-së në maj të vitit 2019, në respektim të saj, i është drejtuar organit kompetent për të përfunduar procedurat e kalimit në pronësi [...]. Është një e drejtë e pritshme për t’u realizuar, siç janë në pritje qindra qytetarë të Sarandës, që nga viti 2000 e këtej [...]. Qëllimi i subjektit është përcaktues për të vërtetuar fshehjen ose paraqitjen e pasaktë të pasurisë. Prandaj edhe Kushtetuta, jo pa qëllim, ka përdorur fjalët përpiqet të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Në këtë kontekst, djali nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të fshehur ose ta paraqesë në mënyrë të pasaktë, sepse nuk ka zotëruar asnjë të drejtë pronësie, përdorimi ose posedimi mbi këtë truall [...], ka vijuar parashtrimin subjekti.

32.4.5. Komisioni, pasi analizoi përgjigjet e subjektit, konstaton se ato nuk përputhen me dokumentacionin e administruar, si dhe vetë deklaratimet e saj gjatë hetimit administrativ.

Subjekti, këtë truall, ka pasur për qëllim ta përdorë si burim për blerjen e apartamentit në Tiranë që në vitin 2013, duke u vërtetuar fakti se trualli ka qenë në zotërim të djalit të saj, i cili në prokurën e posaçme nr. ****, datë 17.5.2015, deklaroi se zotëron dhe disponon një truall me sip. 550 m², që ndodhet në Sarandë. Ky fakt konstatohet edhe në kontratën e premtim shitjes nr. ****, datë 6.12.2019, në të cilën djali i subjektit ka deklaruar se ka përfituar në bazë të vendimit nr. *, datë 11.8.2000, të Këshillit Bashkiak një shesh ndërtimi në bllokun K. **, parcela nr. ***, me sip. 550 m². Për më tepër, për këtë truall ka një akt administrativ, i cili është ky vendim i Këshillit Bashkiak. Në këto kushte, Komisioni konkludon se djali i subjektit, me cilësinë e personit të lidhur: (i) e ka pasur truallin në posedim që në vitin 2000; (ii) trualli nuk figuron ende i regjistruar në ASHK-në Sarandë; (iii) ai/subjekti nuk e ka deklaruar në asnjë deklaram periodik këtë pasuri; (iv) ai/subjekti nuk e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën “Vetting”, (v) marrëdhënia me këtë truall është deklaruar nga subjekti vetëm pas dërgimit nga Komisioni të pyetësorit standard, për të justifikuar burimin e të ardhurave për blerjen e apartamentit të djalit në Tiranë.

32.4.6. Në përfundim, Komisioni çmon se subjekti/personi i lidhur me të ka kryer:

- i. deklarim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për pasurinë truall në zotërim të shtetasit M. Gj, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33/5, germa “a”, si dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.
- ii. fshehje të pasurisë truall në zotërim të shtetasit M. Gj në Sarandë (truall, i cili ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë apartament), në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33/5, germa “c”, si dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

32.5. Në DPV/2015 djali i subjektit ka deklaruar blerjen e kësaj pasurie, apartament i ndodhur në Tiranë, në shumën 6.000.000 lekë, por prej tij nuk rezultoi të jetë deklaruar se i detyrohet shitësit të apartamentit shumën 4.000.000 lekë. Detyrimi që ai i kishte shitësit deklarohet për herë të parë në deklaratën “Vetting”. Gjithashtu, edhe fakti se është paguar shuma 2.000.000 lekë, deklarohet për herë të parë në deklaratën “Vetting”.

32.5.1. Subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, pasi duket se ka mospërputhje midis deklarimeve të djalit të saj në DPV/2015 dhe në deklaratën “Vetting”. Pas kalimit të barrës së provës, subjektit sqaroi se: *“Në deklaramin periodik vjetor të vitit 2015 (dorëzuar në mars 2016) djali M ka deklaruar: blerjen e apartamentit, çmimin e blerjes, shumën e paguar. Është një kuptim jo i drejtë i ligjit dhe mënyrës për plotësimin e formularit nga djali edhe për faktin se tërë periudhën e deklaramit ai ka qenë me studime jashtë dhe azhurnimin me legjislacionin në vend e ka të kufizuar për këtë shkak. Por në kuptim të ligjit, sipas pikës 1 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, djali nuk ka fshehje ose deklarim të pasaktë, sepse: me aritmetikë të thjeshtë ai ka deklaruar: çmimin total 6.000.000, pagesën e këstit të parë 2.000.000 lekë (burimet specifike të saj) dhe detyrimi është thjesht një veprim aritmetik, të cilin, siç sqarova, për moskuptim të qartë të mënyrës së plotësimin të formularit, nuk e ka shënuar në rubrikën përkatëse.”*

32.5.2 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet, duke i krahasuar edhe me shpjegimet e tjera të dhëna prej saj në lidhje me këtë apartament, vlerëson se nuk janë bindëse, pasi subjekti ka deklaruar se marrëdhënia me këtë apartament ka qenë e saj dhe jo e djalit, i cili kishte thjesht emrin. Për më tepër, ajo pretendon se deklaratën noteriale të shtetasit Sh. K e mori me qëllim për ta dorëzuar në ILDKPKI. Gjithashtu, ajo kishte detyrimin për të lexuar pjesën e djalit të saj në DPV/2015, për atë kohë sa deklarimi është detyrim i subjektit dhe djali është person i lidhur me të. Në përfundim, Komisioni vlerëson se deklarimi i pasaktë në DPV/2015 nuk përbën

shkak për shkarkimin e subjektit, por ndërkohë deklarimet e saj në lidhje me këtë mospërputhje do të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave.

32.6. Në lidhje me vlerën e mobilimit të këtij apartamenti, subjekti ka deklaruar vlerën 1.500.000 lekë.

32.6.1. Në përgjigje të pyetësorit datë 17.11.2020, subjekti ka depozituar dy deklarata noteriale, si vijon:

- i. deklaratë nr. ****, datë 3.2.2020, të shtetasit G.D, i cili deklaroi se për periudhën tetor 2015 – maj 2016 ka bërë mobilimin e apartamentit në rrugën “F. T”, në shumën 700.000 lekë dhe është paguar me këste deri në mars të vitit 2018;
- ii. deklaratë noteriale nr. ****, datë 1.2.2020, të shtetasit E. G, i cili deklaroi se në fund të vitit 2015 i ka shitur pajisje elektroshtëpiake subjektit në shumën 750.000 lekë dhe pagesa është bërë me këste deri në fillim të vitit 2018.

32.6.2. Konstatohet se në deklaratën “Vetting”, në seksionin “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti nuk ka deklaruar faktin që i detyrohet shtetasve G.D dhe E.G ndonjë pagesë. Gjithashtu, në asnjë prej deklaratave periodike nuk rezultoi që subjekti të ketë deklaruar se ka detyrime ndaj shtetasve të mësipërm apo se i ka shlyer këto detyrime gradualisht.

32.6.3. Për sa më sipër, ka rezultuar se subjekti: (i) nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” detyrimet që ka pasur ndaj shtetasve G.D dhe E. G; (ii) në asnjë prej deklaratave periodike nuk ka deklaruar shlyerje me këste të vlerës së mobilimit dhe të pajisjeve elektroshtëpiake. Për rrjedhojë, shuma 750.000 lekë do të përfshihet në analizën financiare të vitit 2015, ndërsa shuma 700.000 në analizën financiare të viteve 2015 dhe 2016.

32.6.4. Pas kalimit të barrës së provës për këto konstatime, subjekti ka prapësuar se, në deklaratat periodike ka deklaruar kreditë bankare që ajo dhe bashkëshorti kanë marrë për këtë qëllim. Fakti që janë paguar pajisjet dhe mobiliet me këste është deklaruar nga vetë këta shtetas [...]. Duke deklaruar detyrimin ndaj bankave, ka vlerësuar se është fakt i mjaftueshëm për evidentimin e detyrimeve familjare [...]. Rrjedhimisht, këto dy shuma duhet të përfshihen në analizën financiare për vitin 2016 deri në 2018 [...]. Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. ***, datë 12.2.2021, të z. E.G, në të cilën rideklarohej se pagesa për pajisjet elektroshtëpiake është bërë nga viti 2016 dhe gradualisht.

32.6.5. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitura, konstaton se subjekti, përveç deklaratave noteriale, nuk ka depozituar asnjë dokument tjetër për të vërtetuar faktin se pagesa e pajisjeve elektroshtëpiake apo e mobilieve është bërë me këste. Nga verifikimi i deklaratave periodike, të cilat përbëjnë provë në bazë të nenit 32/5 të ligjit nr. 84/2016, si dhe deklaratës “Vetting”, nuk rezultoi që subjekti të ketë deklaruar faktin që ka ndonjë detyrim apo ka shlyer ndonjë detyrim ndaj shtetasve të lartpërmendur. Për rrjedhojë, Komisioni do të mbështetet vetëm në deklarimet periodike të subjektit dhe deklaratën “Vetting”, duke e konsideruar mobilimin dhe blerjen e pajisjeve elektroshtëpiake të përfunduar në vitet 2015 dhe 2016, vite në të cilat subjekti ka marrë dhe kreditë përkatëse për këtë qëllim.

32.7. Analiza financiare për mobilimin

Tabela nr. 4

	Viti 2015
PASURI	743,724.91
Apartament, sip. 83 m ² Tiranë	2,000,000.00

Shtesa/Pakësime, likuiditete	(1,180,085.59)
Detyrime	76,189.50
TË ARDHURA, dokumentuar	2,816,659.00
Të ardhura nga paga e subjektit	1,156,837.00
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	659,822.00
Kredi "Credins Bank", datë 29.6.2015	700,000.00
Overdraft "Credins Bank", datë 6.11.2015	300,000.00
SHPENZIME	2,607,383.86
Shpenzime jetese	897,104.00
Kredi "Credins Bank" datë 29.6.2015, kësti	133,558.86
Qira banese	132,000.00
Shpenzime udhëtimi	239,511.00
Shpenzime mobilimi	1,012,500.00
Shpenzime shkollimi	192,710.00
NË TOTAL	-534,449.77

32.7.1. Nga analiza financiare e kryer rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të mbuluar shpenzimet e mobilimit në shumën 534.449 lekë.

32.7.2. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka prapësuar, sipas pretendimeve të përshkruara në pikën 32.6.4 më sipër.

32.7.3. Komisioni ka kryer një analizë të re në lidhje me vitin 2015, duke marrë në konsideratë:

- i. shpenzimet e udhëtimit për vitin 2015, duke reflektuar koston e udhëtimit sipas sqarimit që subjekti paraqet në lidhje me faktin se i biri M. Gj ka qenë i pajisur me kartën e studentit, që mundëson pagesë me gjysmë çmimi të biletës në kthim nga Greqia në Shqipëri me autobus;
- ii. shpenzimet jetike të viteve 2014 e në vazhdim, të cilat janë paraqitur në analizë si shpenzime për 3 persona (subjekti, bashkëshorti i saj dhe djali F.Gj). Këtyre shpenzimeve ju është bashkëlidhur shpenzimi i ditëve të qëndrimit në Shqipëri të djalit M. Gj, student në Greqi.

Tabela nr. 5

	Viti 2015
PASURI	743,724.91
Apartament, sip. 83 m ² , Tiranë	2,000,000.00
Shtesa/Pakësime, likuiditete	-1,180,085.59
Detyrime	76,189.50
TË ARDHURA, dokumentuar	2,816,659.00
Të ardhura nga paga e subjektit	1,156,837.00
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	659,822.00
Kredi "Credins Bank", datë 29.6.2015	700,000.00
Overdraft "Credins Bank", datë 6.11.2015	300,000.00
SHPENZIME	2,468,932.72
Shpenzime jetese	783,429.86
Kredi "Credins Bank", datë 29.6.2015, kësti	133,558.86
Qira Banese	132,000.00
Shpenzime udhëtimi	214,734.00

Shpenzime mobilimi	1,012,500.00
Shpenzime shkollimi	192,710.00
NË TOTAL	-395,998.63

Pas rishikimit të analizës financiare, konkludohet se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e mobilimit në shumën 395.998 lekë në vitin 2015, shumë e cila, në vlerësim të Komisionit, duke u bazuar edhe në parimin e proporcionalitetit, nuk përbën shkak autonom për shkarkimin e subjektit, por do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave.

33. Në lidhje me huan marrë shtetasit L. Gj

33.1. Subjekti ka depozituar, së bashku me deklaratën “Vetting”, deklaratën datë 23.3.2016, ku shtetasi L. Gj deklaron se në vitin 2006 i ka huazuar të vëllait, K. Gj, shumën 600.000 lekë, të cilën e ka huazuar nga kursimet nga puna si mekanik në shoqërinë “*** a.e”, me vendndodhje në Athinë. Kjo shumë i është kthyer nga i vëllai në vitin 2007. Për këtë veprim nuk është hartuar asnjë dokumentacion.

33.2. Subjekti, në DPV/2006, ka deklaruar se i ka marrë hua në shumën 500.000 lekë z. L. Gj për probleme shëndetësore.

33.3. Në pyetësorin standard, në pyetjen nr. 4, subjekti deklaron se huaja në shumën 500.000 lekë është marrë për pagesat e prapambetura të punimeve në banesë, por me kalimin e viteve një pjesë e tyre u përfundua në dhuratë.

33.4. Në pyetjen nr. 19 të pyetësorit subjekti deklaron se shuma 500.000 lekë është marrë për të pajisur shtëpinë me sistem ngrohje-ftohje dhe shlyerjen e disa detyrimeve të prapambetura nga punimet në apartament. Në vitin 2007 kunati ia dhuroi këtë shumë djalit dytë të sapolindur.

33.5. Në lidhje me mospërputhjet e mësipërme, subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës 17.11.2020, ka depozituar dokumentin deklaratë përgjegjësie të z. L. Gj, i cili deklaron se *i ka dhënë të vëllait K hua shumën 3.500 euro për nevojat e tij familjare [...]. Në vitin 2007 K.Gj kërkoi t'i kthente këtë hua, por huadhënësi deklaron se ia dhuroi djalit të tij të vogël [...].*

33.6. Në lidhje me këtë hua, subjekti ka sqaruar në ILDKPKI, në datë 22.2.2016²⁹, se *huaja është marrë për nevojat e saj shëndetësore [...] huaja i është dhënë në tri këste sipas nevojave të saj në Spitalin e Janinës. Këtë shumë ia ka shlyer me kredinë e çelur në vitin 2007.*

33.7. Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, sepse duket se: (i) subjekti nuk ka deklaruar saktë huan në shumën 500.000 lekë gjatë hetimit administrativ, ajo ka dhënë shpjegime kontradiktore, të cilat nuk përputhen me deklaratimet e saj ndër vite; (ii) subjekti nuk ka qenë bashkëpunuese me Komisionin, pasi nuk ka dhënë shpjegime të sakta në lidhje me huan e marrë nga z. L. Gj; (iii) duket sikur subjekti ka bërë deklaram të rremë përpara Komisionit në lidhje me këtë hua.

33.8. Në parashtrimet e paraqitura, subjekti ka ngritur pretendimin se vetëm kur subjekti i rivlerësimi është në cilësinë e huadhënësit duhet të ketë detyrimin për të justifikuar atë pjesë të pasurisë që ka dhënë hua apo ka dhuruar, pra, vetëm në këtë rast ka barrë prove. Ajo ka sqaruar se kunati i saj ka të ardhura të ligjshme prej rreth 30 vitesh dhe provat për të vërtetuar këtë fakt i ka vënë në dispozicion të Komisionit dhe të ILDKPKI-së që në vitin 2016. Destinacioni i përdorimit prej saj ka qenë ai që ka deklaruar në mënyrë permanente. Më tej, subjekti sqaron se deklarimi në ILDKPKI në vitin 2016 është bërë mbështetur vetëm mbi

²⁹ Shihni procesverbalin datë 22.2.2016, administruar me shkresën nr. *** prot., datë 9.12.2020, të ILDKPKI-së.

rrethana për të cilat është kujtuar në ato momente, pa pasur asnjë dokumentacion referues (as deklaratat periodike vjetore).

33.9. Komisioni, pasi analizoi përgjigjet e subjektit, konstaton se ato nuk i referohen barrës së provës. Subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim në lidhje me deklaratimet e saj kontradiktore gjatë procesit të rivlerësimit, në deklaratat periodike, si dhe deklaratimet e bëra përpara ILDKPKI-së. Komisioni nuk i ka kaluar barrën e provës subjektit në lidhje me të ardhurat e huadhënësit, por i është kërkuar të shpjegojë bindshëm mospërputhjet në deklaratimet e saj në lidhje me këtë hua: (i) Subjekti ka depozituar, së bashku me deklaratën “Vetting”, deklaratën datë 23.3.2016, ku z. L. Gj deklaron se në vitin 2006 i ka huazuar vëllait K. Gj shumën prej 600.000 lekësh, e cila është kthyer nga prej tij në vitin 2007. (ii) Subjekti, në DPV/2006, ka deklaruar se i ka marrë hua në shumën 500.000 lekë z. L. Gj për probleme shëndetësore. (iii) Në pyetësin standard, në pyetjen nr. 4, subjekti deklaron se huaja në shumën 500.000 lekë është marrë për pagesat e prapambetura të punimeve në banesë, por me kalimin e viteve u përfundua në dhuratë një pjesë e tyre. (iv) Në pyetjen nr. 19 të pyetësorit subjekti deklaron se shuma 500.000 lekë është marrë për të pajisur shtëpinë me sistem ngrohje-ftohje dhe shlyerjen e disa detyrimeve të prapambetura nga punimet në apartament. Në vitin 2007, me lindjen e djalit të dytë, kunati ia dhuroi djalit të sapolindur. (v) Në lidhje me këtë hua subjekti ka sqaruar pranë ILDKPKI-së, në datën 22.2.2016³⁰, se huaja është marrë për nevojat e saj shëndetësore, huaja i është dhënë në tri këste sipas nevojave të saj në Spitalin e Janinës. Këtë shumë ia ka shlyer me kredinë e çelur në vitin 2007.

Siç rezulton, subjekti ka bërë të njëjtin deklaram si në DPV/2006, ashtu dhe në ILDKPKI, duke deklaruar se huaja është marrë për arsye shëndetësore dhe është shlyer në vitin 2007. Për të mbështetur këtë deklaram subjekti ka depozituar deklaratën datë 23.3.2016, ku z. L. Gj deklaron se në vitin 2006 i ka huazuar vëllait K. Gj shumën prej 600.000 lekësh, e cila është kthyer në vitin 2007.

Bazuar në provat e mësipërme, rezulton se deklaratimet e subjektit, pas kalimit të barrës së provës, nuk janë të mbështetura në provat e kohës, por në deklaratimet e saj gjatë hetimit administrativ, duke deklaruar se huaja nuk është kthyer në vitin 2007, por i është dhuruar nga z. K. Gj dhe se nuk është përdorur për qëllime shëndetësore.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti ka kryer deklaram të rremë gjatë hetimit administrativ në lidhje me huan e marrë nga z. L. Gj. Ky deklaram i subjektit do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave.

33.10. Subjekti, në përgjigje të pyetësorit standard, deklaron se ka marrë shuma në të holla dhe produkte ushqimore bujqësore dhe blegtorale nga ekonomia familjare e vjehrrit, z. S. Gj, të holla nga kunata V.J, kunetërit Th dhe L. Gj. Ky deklaram i subjektit nuk përputhet me deklaratën “Vetting”, ku nuk e ka deklaruar një fakt të tillë, për rrjedhojë, këto të ardhura nuk do të përfshihen në analizën financiare. Subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e këtij konstatimi.

33.11. Subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim lidhur me këtë rezultat.

Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

34. Komisioni shqyrtoi të gjithë dokumentacionin e administruar, përgjigjet dhe provat e paraqitura nga subjekti për pyetësorët e dërguar, si dhe provat dhe parashtrimet në përgjigje të barrës së provës.

³⁰ Shihni procesverbal datë 22.2.2016, administruar me shkresën nr. *** prot., datë 9.12.2020, të ILDKPKI-së.

34.1. Në përfundim konstatohet se subjekti/personi i lidhur me të: (i) nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” se bashkëshorti i saj ka pasur në bashkëpronësi garazh me sip. 98 m² në Sarandë; (ii) nuk ka justifikuar me burime të ligjshme krijimin e pasurisë apartament, të ndodhur në Sarandë; (iii) nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” në mënyrë të plotë dhe të saktë burimet që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë apartament në Sarandë; (iv) ka kryer deklarimit të pasaktë, të paplotë, të pamjaftueshëm dhe të rremë pasi ka depozituar një deklaratë noteriale në të cilën paraqiten të dhëna që nuk përputhen me të dhënat e administruara gjatë hetimit administrativ; (v) ka kryer deklarim të rremë gjatë hetimit administrativ në lidhje me huan e marrë nga z. L. Gj; (vi) nuk ka justifikuar me burime të ligjshme pagesën e kështit të parë për krijimin e pasurisë apartament të deklaruar nga personi i lidhur z. M. Gj, të ndodhur në Tiranë; (vii) nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” në mënyrë të plotë dhe të saktë burimin e pasurisë apartament, të ndodhur në Tiranë; (viii) nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e mobilimit në shumën 395.998 lekë në vitin 2015 për apartamentin e ndodhur në Tiranë; (ix) ka kryer fshehje të pasurisë truall me sip. 550 m², duke mos e deklaruar në deklaratën “Vetting”.

34.2. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se:

- i. subjekti ka kryer fshehje të pasurisë, në kuptim të kuptim të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të germës “c” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
- ii. subjekti ka kryer deklarim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së saj dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të germës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
- iii. subjekti nuk ka justifikuar me burime të ligjshme blerjen e pasurive të luajtshme apo të paluajtshme të saj apo të personave të lidhur me të, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
- iv. subjekti nuk paraqiti prova, si dhe nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave dhe pasurive të saj, sipas pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
- v. subjekti ka kryer deklarim të rremë, në kuptim të germës “ç” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
- vi. komisioni mban parasysh në vlerësimin e tij qëndrimin jo bashkëpunues të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit i është përgjigjur në kohë pyetësorëve të dërguar, por përgjigjet e saj nuk kanë qenë shteruese. Ajo ka tentuar zvarritje të procesit, duke depozituar kërkesa të njëpasnjëshme, të cilat synonin pezullimin dhe/ose vonesën e procesit të rivlerësimit.

B. KONTROLI I FIGURËS

35. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

35.1. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 25.1.2021, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 26.1.2021, të KDZH -së, si vijon:

- a. Me shkresën nr. **** prot., datë 2.11.2017, në Komision është përcjellë raporti për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, znj. Rita Gjati, me konstatimin për përshtatshmërinë në vazhdimin e figurës.

- b. Në vijim të informacioneve të ardhura nga institucionet e verifikimit, në kohështrirjen para dhe gjatë periudhës së rivlerësimit, rezulton se:
- i. gjatë periudhës në të cilën znj. Rita Gjati ushtronte detyrën si prokurore, dyshohet se është përfshirë në veprime korruptive në vitet 2005, 2014, 2016 dhe 2017;
 - ii. institucionet verifikuese i kanë përcjellë Prokurorit të Përgjithshëm materialin ku përmendet si prokurore, e cila, kundrejt mitës, ka pushuar një çështje penale në ngarkim të të pandehurit dhe ka favorizuar dy shtetas në dy çështje të tjera;
 - iii. gjithashtu, për prokuroren në fjalë është informuar edhe Presidenti i Republikës në lidhje me implikimin e saj në korrupsion.

Për subjektin Rita Gjati çmohet e pavlefshme të merren parasysh elementet që evidentojnë përfshirjen e saj në veprimtari korruptive, pasi në frymën kundër korrupsion të ligjit nr. 84/2016 vlerësohet se integriteti profesional është përcaktues për pastërtinë e figurës së subjekteve të rivlerësimit.

Si konkluzion, DSIK-ja ka konstatuar papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Rita Gjati.

35.2. Nisur nga informacioni i ardhur nga autoritet verifikuese, trupi gjykues, bazuar në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, analizoi provat e administruara nga këto autoritete. Në përfundim të hetimeve, një pjesë e rezultateve të cilat pasqyrohen në raportin profesional, rezultoi se përmbajtja e këtyre materialeve përputhet dhe mbështetet me informacionin e ardhur nga organet ligjzbatuese.

Komisioni, në përfundim të verifikimeve lidhur me vlerësimin e figurës, i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të paraqitur prova dhe për të dhënë shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën në lidhje me konstatimet e mësipërme.

35.3. Subjekti, në prapësimet e saj, ka pretenduar se: *“Raporti i dytë i Grupit të Punës mbi papërshtatshmërinë e vazhdimin të detyrës nuk plotëson kriteret ligjore të përcaktuara në nenin DH, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës. Nuk përmban asnjë nga elementët e parashikuar nga neni 38, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, nuk është mbështetur në asnjë verifikim, nuk bazohet në asnjë provë, prandaj ai duhet të konsiderohet i paplotë dhe i pavlerë për kontrollin e figurës sime. Grupi i Punës, në rastin e raportit të dytë, nuk ka përmbushur detyrat, sipas nenit 37 të ligjit, duke mos iu përmbajtur kërkesave të përgjithshme dhe pa bërë asnjë verifikim dhe duke futur në raport apriori informacione të paverifikuara të një institucioni. Minimalisht duhet të ishte verifikuar nëse është dikush që ka përfutuar nga vendimmarrja, pa dijeninë e saj, dikush që kishte edhe mundësinë dhe kompetencën të urdhëronte si duhet të përfundojë një çështje dhe pse duhet të përfundojë në atë mënyrë, hetim të gjithanshëm për të arritur tek e vërteta, jo hamendësime [...]. Për këtë shkak, kam kundërshtuar gjyqësisht këtë akt, duke i kërkuar gjykatës administrative pavlefshmërinë absolute të tij.”*

Subjekti ka pretenduar që Komisioni duhet të marrë parasysh vetëm raportin nr. *** prot., datë 2.11.2017, të DSIK-së.

35.4. Hetimi i Komisionit në lidhje me kriterin e figurës

Gjatë hetimit ka rezultuar se djali i subjektit, në deklaratën “Vetting” të plotësuar në datën 25.1.2017, deklaroi se i ka detyrim të papaguar shumë prej 4.000.000 lekësh shtetasit Sh. K, për blerjen e apartamentit në rrugën “F. T” në Tiranë.

35.4.1. Subjekti, kur është pyetur në lidhje me marrëdhënien që i biri ka pasur me shtetasin Sh. K, ka sqaruar se djali i saj nuk është takuar dhe nuk ka komunikuar asnjëherë me këtë shtetas, por ka qenë ajo dhe bashkëshorti i saj që kanë komunikuar me të gjatë gjithë kohës. Apartamenti është blerë në emër të djalit të saj, pasi si burim do të shërbente trualli që ai kishte përfituar nga Bashkia Sarandë.

Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale³¹ nr. ***, datë 23.1.2020, të znj. M.K, përfaqësuese e z. Sh. K, e cila deklaroi se *mesa është vënë në dijeni nga z. K, në vitin 2013 ai është prezantuar me subjektin dhe bashkëshortin e saj të cilët ishin të interesuar të blinin një banesë në kompleksin që ishte në ndërtim e sipër tek zona e Teleferikut, Komuna Dajç. Janë takuar në zonën ku po ndërtohej kompleksi dhe kanë shprehur interes për një apartament me sip. 120 m² [...]. Pasi kanë diskutuar për çmimin u ka ofruar shumën 60.000 lekë/m² [...] është kontaktuar përsëri në telefon nga subjekti dhe bashkëshorti i saj dhe kanë lënë takim për të diskutuar modalitetet [...]. Janë ritakuar dhe kanë rënë dakord që do të merrnin apartament 120 m² në këmbim të një sheshi ndërtimi që posedonin në Sarandë [...]. Në mars të vitit 2015 nuk përfunduan punimet dhe z. K i ka ofruar një apartament të përfunduar në një ndërtim në rrugën "F. T" me të njëjtin çmim [...]. Ata i kanë kthyer përgjigje pas disa ditësh dhe i ka kërkuar të shohin apartamentin [...]. Pasi kanë pranuar ta marrin kanë paguar dhe shumën 2.000.000 lekë [...]. Rreth muajit nëntor kanë filluar të banojnë në apartament [...], hera e fundit që kanë kontaktuar bashkë ka qenë fundi i vitit 2015 për të diskutuar hartimin e dokumentacionit [...].*

Siç rezulton nga vetë deklaratimet e z. Sh. K, por dhe të subjektit³², ajo dhe bashkëshorti i saj gjatë viteve 2013 - 2015 janë takuar disa herë me këtë shtetas.

35.4.2. Nga hetimi i kryer nga Komisioni ka rezultuar se z. Sh.K është proceduar për veprat penale "grup i strukturuar kriminal" dhe "trafik i narkotikëve në kuadër të grupit të strukturuar kriminal". Ky shtetas, me vendim nr. ***, datë 31.10.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, është dënuar për veprën penale "trafikim i narkotikëve, kryer në formën e grupit të strukturuar kriminal", parashikuar nga nenet 283/a/1 dhe 334/1 të Kodit Penal, ndërsa për veprën penale "grup i strukturuar kriminal" është vendosur pushimi i akuzës, pasi kjo veprë përbën të njëjtin fakt penal me veprën penale të parashikuar nga neni 334/1 i Kodit Penal.

Nga të dhënat rezulton se **z. Sh. K është arrestuar në korrik të vitit 2016 për trafikim të lëndëve narkotike.**

35.4.3. Bazuar në pikën 4 të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, një ndër rrethanat që merret parasysh në konstatimin që ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, është nëse subjekti i rivlerësimit, ose një person i lidhur me të, ka pasur një komunikim jorastësor me një person të përfshirë në krimin e organizuar.

Në rastin e subjektit rezulton se z. M.Gj (ose vetë subjekti dhe bashkëshorti i saj, sipas deklaratimeve të subjektit) i ka dhënë *cash* z. Sh. K në vitin 2015 shumën 2.000.000 lekë, si dhe ka marrë prej tij deklaratën noteriale nr. *****, datë 23.3.2016. Gjithashtu, djali i subjektit i detyrohej ende shumën 4.000.000 lekë z. Sh.K për një periudhë 4-vjeçare.

35.4.4. Ligji nr. 84/2016 ngarkon me përgjegjësi subjektet në lidhje me plotësimin e deklaratës së kontrollit të figurës. Në këtë rast subjekti do të duhej që të deklaronte faktin që djali i saj apo ajo dhe bashkëshorti kishin pasur kontakte me z. Sh. K, anëtarësia e dyshuar e të cilit në krimin e organizuar është e njohur dhe e publikuar, pasi në media³³, në datën 7.7.2016 rezulton të jetë publikuar lajmi që ky shtetas është arrestuar për trafik lëndësh narkotike.

³¹ Shihni pyetësorin datë 17.11.2020 dhe datë 23.12.2020

³² Shihni pyetësorin datë 17.11.2020 dhe datë 23.12.2020

³³ <https://gazetamapo.al/video-ja-biznesmenet-e-ndertimit-te-arrestuar-per-trafik-droge/>

<https://www.gazeta-shqip.com/2016/07/07/operacioni-antidroge-ballkan-arrestohen-30-persona-23-ne-kerkim/>

Dijenja e subjektit se ky shtetas ka qenë i proceduar konfirmohet edhe me deklaratimet e saj në pyetësorët e datave 17.11 dhe 23.12.2020, ku ka depozituar edhe publikime të vitit 2016, që ky shtetas rezulton të ketë qenë i arrestuar dhe proceduar për vepra që përfshihen në krimin e organizuar.

Subjekti, në përgjigje të pyetësorit datë 17.11.2020, pranon faktin që ka pasur dijeni për procedimin e z. Sh.K, duke deklaruar: *“Marrëveshja për të blerë apartament tek ky subjekt ku na rezulton ortak dhe personi në fjalë ka lindur para se unë e familja ime të dëgjonim në media për veprimtarinë e kundërligjshme të tij”*.

Gjithashtu, marrëdhënia e detyrimit me z. K ka vijuar deri në vitin 2021, pra gati 6 vjet.

Ky shtetas, edhe pas hyrjes në apartament të subjektit, nuk i ka kërkuar të kryejë pagesën prej 4.000.000 lekësh të mbetur pa likuiduar, duke lindur dyshimin që kontakti i subjektit nuk është plotësisht rastësor.

Të gjitha këto rrethana ngarkojnë me përgjegjësi subjektin që duhej të deklaronte në deklaratën e kontrollit të figurës faktin që ajo dhe bashkëshorti ose djali i saj kanë pasur kontakte me z. Sh. K.

35.4.5. Në përfundim, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për sa: (i) duket se subjekti nuk ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës, pasi nuk ka deklaruar faktin se ajo/familjarë të saj kanë pasur kontakte me z. Sh.K, të cilit i detyroheshin shumën 4.000.000 lekë dhe në momentin e plotësimit të deklaratës “Vetting” procedohej për një vepër penale të përfshirë në krimin e organizuar; (ii) duket se subjekti/familjarët mund të kenë/kanë kontakt të papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, për sa kohë ka ende detyrime të pashlyera ndaj tij.

35.4.6. Pasi iu kalua barra e provës, subjekti ka prapësuar se *sipas të gjitha fakteve që ka vënë në dispozicion të Komisionit, rezulton pa asnjë mëdyshje se kontakti i saj e i familjes së saj me shtetasin Sh. K. ka qenë rastësor. Qëllimi i këtij kontakti ka qenë një dhe i vetëm: strehimi i familjes saj [...]. Është vënë në dijeni të implikimit në veprimtari jo të ligjshme të shtetasit Kotorri në momentin e arrestimit të tij në korrik të vitit 2016. Por, këmbëngul se në atë periudhë asnjë komunikim, asnjë takim, asnjë korrespondencë në asnjë formë, asnjë kontakt nuk ka pasur askush nga familja me atë person. Arsyeja ishte e thjeshtë, prisnin që investitorët e pallatit të pjesëtonin pasurinë dhe të regjistronin në ASHK apartamentin që të hartonin dokumentacionin përfundimtar. Pas këtij momenti janë njoftuar nga shtetasja M. K (kunata e Sh.K), se në momentin që do të sistemonin pasuritë midis tyre, do t'i kontaktonte ajo për të përfunduar procedurat e kalimit të pronësisë [...]. Detyrimi prej 4.000.000 lekësh i çmimit të blerjes së apartamentit nga ana e djalit është deklaruar që në 2015-ën në çdo DPV. Por tashmë rezulton se ky detyrim i mbartur nuk ka qenë ndaj shtetasit Sh. K., por ndaj shtetases M. K. Pikërisht situata problematike në pjesët takuese të ortakëve të “K” sh.p.k., është një nga shkaqet që nuk është mundësuar kalimi përfundimtar i pronësisë për kaq vite. Më 9.2.2021 është zgjidhur në mënyrë përfundimtare kjo situatë, duke u bërë edhe kalimi i pronësisë [...]. Bazuar në nenin 38, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, një ndër rrethanat që merret parasysh në konstatimin që ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar është nëse subjekti i rivlerësimit ose një person i lidhur me të ka pasur një komunikim jo rastësor me një person të përfshirë në krimin e organizuar. Në vitet 2013 - 2015 nuk ka qenë e njohur, e publikuar dhe as e mundur nga ana e subjektit të dihej për këtë veprimtari.*

Subjekti ka pretenduar se marrëdhëniet e familjes së saj me shtetasin Sh.K kanë përfunduar në vitin 2015, ndërsa deklaratën e përpiluar nga ky shtetas në mars të vitit 2016 ia kanë kërkuar

noteres dhe e kanë marrë prej saj një ditë më vonë. Subjekti, gjithashtu, ka pretenduar se detyrimi i tyre ka qenë ndaj shtetasës M. K., si pronare e apartamentit. Subjekti ka depozituar si provë një deklaratë noteriale të datës 23.3.2016, të shtetasit Sh.K, në të cilën deklaroi se i është përgjigjur kërkesës së tyre (subjektit) bërë ortakëve, si atij, ashtu edhe shtetasës M. K., për të konfirmuar pagesën e bërë për këstin e parë. Ky dokument ishte detyrim ligjor për t'u dorëzuar në ILDKPKI, ka pretenduar subjekti në DPV/2015, dhe është depozituar si pjesë integrale e DPV-së nga djali i saj, M. Gj, si person i lidhur. Gjithashtu është depozituar edhe në deklaratën "Vetting" të vitit 2017 nga i biri, nëpërmjet saj, si personi që i nënshtrohet procesit të rivlerësimit dhe është deklaruar edhe detyrimi që kanë pasur në total, por përfundimisht rezultoi, sipas dokumentacionit ligjor të sipërcituar, se detyrimi ishte ndaj shtetasës M. K., si pronare e apartamentit që kanë blerë. Subjekti ka cituar edhe nenin 38/5, pika "d", sipas të cilit kontaktet e saj kanë qenë pesë vjet më parë dhe nuk ka ndonjë tregues që ato vazhdojnë ende. Kjo rrethanë mund të vlerësohet në raport me shkallën e seriozitetit të kontakteve dhe/ose me rrethanat e parashikuara në pikën 4 të nenit 38 të ligjit në fjalë. Pra, sipas subjektit, kontaktet e tyre nga 2015 e në vijim nuk kanë pasur asnjë arsye t'i kenë prezente, sepse ishin në pritje të kontratës së pjesëtimit të pasurisë midis investitorëve për të hartuar dokumentacionin përfundimtar.

Në datën 26.2.2021 subjekti parashtroi më tej se *detyrimi i familjes së saj, sipas dokumenteve zyrtare, rezulton se ka qenë ndaj shtetasës M. K. Nuk ka ekzistuar asnjë detyrim ndaj Sh.K, as para, as pas implikimit të tij në veprimtari të jashtëligjshme. Dokumentacionin e ka vënë në dispozicion të Komisionit, por në çdo rrethanë, çdo lloj marrëdhënieje me këtë shtetas, për ta, ka përfunduar në fund vitit 2015, siç ka deklaruar. Deklarata e njëanshme lidhur me pagesën e këstit të parë të apartamentit është një dokument i hartuar në rrethanat e sqaruara nga noterja, pa praninë e tyre. Noterja ka shpjeguar hollësisht në dokumentin e datës 23.2.2021 rrethanat në të cilat ajo ka hartuar deklaratën, kohën e hartimit dhe përmbajtjen e saj. Apartamenti ku banon sot me adresë: rr. "F. T" p. **, h. **, ap. **. Tiranë, është blerë nga shtetasja M. K, si një nga investitorët e këtij pallati.*

35.4.7. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Në lidhje me pronësinë e apartamentit ku banon, nga dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti rezulton që ka qenë i regjistruar në ASHK që në vitin 2017 edhe kontrata e pjesëtimit së cilës i referohet subjekti, që është e vitit 2017. Gjithashtu, subjekti përsërit faktin se deklarata noteriale e z. Sh. K është depozituar në ILDKPKI në vitin 2015, fakt i cili u provua që nuk ishte i vërtetë, pasi në vitin 2015 nuk rezultoi që subjekti ta ketë dorëzuar pranë këtij institucioni.

Komisioni, pasi ka hetuar, i ka rezultuar se z. Sh.K është person i përfshirë në krimin e organizuar. Subjekti, së bashku me deklaratën "Vetting", ka depozituar deklaratën noteriale të këtij shtetasi dhe jo të znj. M. K apo të ndonjë shoqërie tjetër. Në këtë dokument noterial, z. Sh. K deklaroi se z. M. Gj i ka dhënë *cash* shumën 2.000.000 lekë. Në deklaratën "Vetting" djali i subjektit i referohet kësaj deklarate noteriale për detyrimin e mbetur në shumën 4.000.000 lekë. Jo vetëm në deklaratën "Vetting", por dhe gjatë hetimit administrativ nuk rezultoi që subjekti apo personi i lidhur me të, të kenë deklaruar faktin se i detyrohen shumën 4.000.000 lekë ndonjë shoqërie tregtare apo znj. M. K. Kjo shtetase, pas vitit 2016, në marrëdhënien që ka pasur me subjektin, ka vepruar në cilësinë e përfaqësues së z. Sh.K, bazuar në dokumentacionin e depozituar nga subjekti gjatë hetimit administrativ. Është vetë subjekti që pranon se ka dijeni që në vitin 2016 se z. Sh. K është person i përfshirë në krimin e organizuar. Për rrjedhojë, subjekti duhej të deklaronte në deklaratën për kontrollin e figurës faktin se djali i saj/ajo kanë pasur kontakte me një person të përfshirë në krimin e organizuar, pra z. Sh.K. Ky detyrim për të deklaruar këtë kontakt rrjedh nga faktet e mëposhtme:

- i. subjekti, bazuar në deklaratimet e saj, të cilat vlen të theksohet që nuk përputhen me deklaratimet në deklaratën “Vetting”, ka pasur kontakte jo rastësore me z. Sh. K, pasi ka negociuar blerjen e një apartamenti në vitet 2013 – 2015;
- ii. bazuar në dokumentacionin e depozituar prej subjektit së bashku me deklaratën “Vetting”, rezulton se z. M.Gj i detyrohej z. Sh.K shumën 4.000.000 lekë. Ky detyrimi që z. M.Gj kishte ndaj z. K është pothuajse sa 2/3 e çmimit të blerjes së apartamentit, për pasojë nuk mund të konsiderohet si fakt në favor të një kontakti rastësor të subjektit/personit të lidhur me z. K. Këtu duhet të mbahet në vëmendje që subjekti dhe familja e saj jetojnë në këtë apartament që prej vitit 2015, pavarësisht shumës së detyrimit të papaguar;
- iii. marrëdhënia e huas ka zgjatur për një periudhë më shumë se 4-vjeçare, pra, në momentin e plotësimit të deklaratës “Vetting” dhe në vijim subjekti/personi i lidhur me të, vazhdonin t’i detyroheshin në shumën 4.000.000 lekë një personi të përfshirë në krimin e organizuar;
- iv. subjekti nuk ka depozituar asnjë dokument tjetër (kontratë sipërmarrjeje /shitblerjeje/porosie) deri në vitin 2019, përveç deklaratës noteriale të z. Sh. K, për të provuar marrëdhënien e saj rastësore me këtë shtetas në lidhje me apartamentin.
- v. subjekti, edhe gjatë procesit administrativ, ka depozituar deklaratën noteriale³⁴ nr. ****, datë 23.1.2020, të znj. M. K, përfaqësuese e z. Sh. K, e cila ka shpjeguar në bazë të deklaratimeve të këtij të fundit marrëdhënien midis subjektit dhe këtij shtetasi.

35.4.8. Për sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës duke mos deklaruar faktin që z. Sh. K, të cilit z. M. Gj/ajo i detyrohej ende në shumën 4,000,000 lekë, ishte person i përfshirë në krimin e organizuar, duke e vënë në kushtet e deklaratimit të pamjaftueshëm, në bazë të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI PROFESIONAL

36. Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga Prokuroria e Përgjithshme;
- kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- denoncimet e paraqitura në Komision.

Raporti i hartuar nga Prokuroria e Përgjithshme dhe analiza e Komisionit

37. Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Nga verifikimi i tri dokumenteve ligjore të dorëzuara nga subjekti, konstatohen këto gjetje:

37.1. Kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. **, të vitit 2015, në ngarkim të të pandehurve H. H, M.H, G.U, L.D, M.H, M.A dhe Z. J (*dokumenti 1*).

37.1.1. Në përfundim të hetimeve paraprake, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës ka dërguar për gjykim procedimin penal nr. ***, të vitit 2015, në ngarkim të të pandehurve H. H, M.H, G.U, L.D, M.H, M.A dhe Z.J, të akuzuar për kryerjen e veprës penale “shpërdorim detyrë”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

³⁴ Shihni pyetësin datë 17.11.2020 dhe datë 23.12.2020

Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Kukës, me vendimin nr. ****(**)**, datë 20.3.2018, ka vendosur: *Deklarimin e pafajshëm të të gjithë të pandehurve.*

Ndaj këtij vendimi ka paraqitur ankim Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës dhe sipas vërtetimit datë 30.4.2018, të kancelarit të gjykatës, çështja është dërguar për kompetencë në Gjykatën e Apelit Shkodër.

Subjekti ka drejtuar hetimet dhe ka kryer hetime në këtë procedim penal, ka vendosur ngritjen e akuzave ndaj të pandehurve të lartpërmendur, ka vendosur dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. ******, të vitit 2015, si dhe ka përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës në procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës ndaj të pandehurve.

Kërkesa për gjykimin e çështjes penale është strukturuar në tri pjesë: pjesa hyrëse, arsyetuese dhe konkluduese.

37.1.2. Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për këtë dokument, si vijon:

- i. Prokuroria e Përgjithshme ka konstatuar se në nenin 331, pika 2, germa “c” e Kodit të Procedurës Penale parashikohet se kërkesa për gjykim përmban burimet e provës dhe faktet që ato ju referohen, ndërkohë që subjekti, në kërkesën për gjykimin e çështjes penale, liston si burim prove edhe veprimet procedurale të ndërmarra prej saj në fazën e hetimeve paraprake (vendim sekuestrimi prove materiale, vendim kryerje ekspertimi kontabël, urdhër ndalimi ndaj personave nën hetim), duke ngatërruar termin “burime prove”, të cilat merren në formën e kërkuar nga ligji dhe që shërbejnë për të vërtetuar një fakt të caktuar të çështjes penale, me veprimet procedurale të ndërmarra nga prokurori në fazën e hetimeve paraprake.
- ii. Përveç se sa ka konstatuar Prokuroria e Përgjithshme, Komisioni ka konstatuar se subjekti:
 - nuk rezulton të ketë analizuar figurën e veprës penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal;
 - nuk rezulton të ketë analizuar dhe nuk citon veprimet ose mosveprimet e kryera nga shtetasit M. H, G.U, L.D, M.H, M.A dhe Z.J, si dhe detyrat e tyre funksionale në lidhje me kryerjen e veprës penale “shpërdorim detyre” nga ana e tyre, pasi në dokumentin “kërkesë për gjykim” përmendet vetëm z. H. H dhe vetëm në fund vendoset emri i shtetasve të mësipërm.

37.1.3. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, prapësoi se: *“Për çdo fazë të hetimit të çështjes është marrë miratimi nga drejtuesi i prokurorisë dhe drejtori i strukturës përgjegjëse në Prokurorinë e Përgjithshme sipas ligjit procedural të kohës dhe ky miratim është zyrtar në formën elektronike, të cilën ia vë në dispozicion Komisionit [...]. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës ka deklaruar fajtor një nga të pandehurat (M. A.) e çështjes me vendimin nr. **** (**-2016-***)**, datë 22.11.2016, dhe çështja në ngarkim të saj ndodhet për gjykim në Gjykatën e Lartë. Kjo situatë nuk është konsideruar nga Komisioni. Lidhur me gjetjet e Komisionit: subjekti nuk rezulton të ketë analizuar figurën e veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, sqaron se në paragrafin e fundit të faqes 4, të kërkesës për gjykim, janë renditur ligjet përkatëse të shkelura nga të pandehurit. Prokurori, në diskutimin përfundimtar të çështjes, ka arsyetuar me hollësi elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Është ky momenti procedural në të cilin prokurori analizon çdo provë të formuar në procesin gjyqësor në raport me ligjin material të shkelur. Ky moment konfirmon akuzën e gjykuar dhe provat që vërtetojnë shkeljen e ligjit. Ka ushtruar ankim kundër vendimit për të pandehurin H. H. etj., nr. ****(**)**, datë 20.3.2018. prokurori i apelit ka hequr dorë nga apeli sipas vendimit nr. ******, datë 20.2.2019 [...]. Në kundërshtim me gjetjet e Komisionit, në faqen 8*

të 'kërkesës për gjykim' analizohen veprimet konkrete të secilit të pandehur dhe ligji material përkatës i shkelur prej tyre”.

37.1.4. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson të theksojë se objekti i vlerësimit ka qenë dokumenti “kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2015”, që ka depozituar vetë subjektit së bashku me formularin e vlerësimit profesional në zbatim të nenit 41 të ligjit nr. 84/2016 dhe jo gjithë hetimi apo dokumentet e tjera të këtij procedimi. Komisioni, në përputhje me nenin 44 të ligjit nr. 84/2016, ka analizuar dokumentin e depozituar nga subjekti dhe ka konstatuar gjetjet e mësipërme, të cilat, pas kalimit të barrës së provës, janë kundërshtuar nga subjekti me dokumente të tjerë. Në përfundim, Komisioni vlerëson se në lidhje me dokumentin “kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2015” të depozituar nga subjekti, rezulton se:

- i. subjekti, në kërkesën për gjykimin e çështjes penale, liston si burim prove edhe veprimet procedurale të ndërmarra prej saj në fazën e hetimeve paraprake (vendim sekuestrimi prove materiale, vendim kryerje ekspertimi kontabël, urdhër ndalimi ndaj personave nën hetim), duke ngatërruar termin “burime prove”, të cilat merren në formën e kërkuar nga ligji dhe që shërbejnë për të vërtetuar një fakt të caktuar të çështjes penale, me veprimet procedurale të ndërmarra nga prokurori në fazën e hetimeve paraprake, duke vepruar në kundërshtim me germën “c” të pikës 2 të nenit 331 të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohet se kërkesa për gjykim përmban burimet e provës dhe faktet që iu referohen;
- ii. subjekti nuk rezulton të ketë analizuar figurën e veprës penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal;
- iii. subjekti nuk rezulton të ketë analizuar dhe nuk citon veprimet ose mosveprimet e kryera nga shtetasit M. H, G.U, L.D, M.H, M.A dhe Z.J, si dhe detyrat e tyre funksionale në lidhje me kryerjen e veprës penale të shpërdorimit të detyrës prej tyre, pasi në dokumentin “kërkesë për gjykim” përmendet vetëm z. H.H dhe vetëm në fund vendoset emri i shtetasve të mësipërm.

Ndërkohë, Komisioni, pasi analizoi ankimin e bërë nga subjekti në datën 29.3.2018 (depozituar nga subjekti pas kalimit të barrës së provës), në lidhje me procedimin e mësipërm, konstaton se në ankim subjekti ka analizuar figurën e veprës penale “shpërdorim detyre”, si dhe ka cituar veprimet ose mosveprimet e kryera nga shtetasit M.H, G.U, L.D, M.H, M.A dhe Z. J, si dhe detyrat e tyre funksionale.

37.1.5. Në përfundim, Komisioni vlerëson se në dokumentin ligjor të analizuar “kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2015”, subjekti: (i) ka shfaqur njohuri të cekëta në lidhje me germën “c” të nenit 331/2 të Kodit të Procedurës Penale; (ii) ka reflektuar gjykim dhe aftësi të dobëta, pasi nuk është thelluar në arsyetim, duke mos analizuar dhe cituar veprimet ose mosveprimet e shtetasve të sipërcituar, si dhe detyrat e tyre funksionale në lidhje me kryerjen e veprës penale “shpërdorim detyre” nga ana e tyre, të cilat konsiderohen mangësi profesionale.

37.2. Kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. ** të vitit 2016, në ngarkim të të pandehurve B.H, E.B, N.A, R.F, S.K, S.B, N. F, G.Sh, F.J, A.Sh dhe K. D (*dokumenti 2*).

37.2.1. Nga aktet e administruara për efekt të procesit të rivlerësimit, rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës ka regjistruar procedimin penal nr. **, datë 19.1.2016, për veprën penale “tregtim dhe transportim i mallrave kontrabandë”, parashikuar nga neni 178 i Kodit Penal. Gjithashtu, kjo prokurori ka regjistruar edhe procedimin penal nr. ** të vitit 2016, për veprat penale “shpërdorim detyre” dhe “kontrabandë me mallra të tjera”, parashikuar nga nenet 248 dhe 174 të Kodit Penal. Më pas, me vendimin e prokurorisë datë 17.2.2016, procedimet penale të lartpërmendura janë bashkuar në një procedim të vetëm, dhe

konkretisht atë me nr. ** të vitit 2016. Në përfundim të hetimeve paraprake, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës ka dërguar për gjykim procedimin penal nr. ** të vitit 2016, në ngarkim të të pandehurve B. H, E.B dhe N.A, të akuzuar për kryerjen e veprës penale “kontrabandë nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 175 dhe 25 të Kodit Penal, të pandehurve R. F dhe S.K, të akuzuar për kryerjen e veprës penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, të pandehurve S. B, N.F, G.Sh dhe F.J, të akuzuar për kryerjen e veprave penale “kontrabandë me mallra që paguhet akcizë” dhe “kontrabandë me mallra të tjera”, parashikuar nga nenet 172 dhe 174 të Kodit Penal, të pandehurit A.Sh, i akuzuar për kryerjen e veprave penale “kontrabandë me mallra të tjera” dhe “fshehje të të ardhurave”, parashikuar nga nenet 174 dhe 180 të Kodit Penal, si dhe të pandehurit K. D, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës”, parashikuar nga neni 301 i Kodit Penal.

Gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës rezultoi se një pjesë e të pandehurve, dhe konkretisht shtetasit A. Sh, N.F, G.Sh dhe S.B, kanë kërkuar që gjykimi i tyre të zhvillohet me procedurën e gjykimit të shkurtuar, konform nenit 403 të Kodit të Procedurës Penale dhe në këto kushte, kjo gjykatë ka vendosur në datën 20.6.2016 të pranojë kërkesën e të pandehurve për zhvillimin e gjykimit ndaj tyre me rregullat e gjykimit të shkurtuar dhe të veçojë çështjen në ngarkim të tyre.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me vendimin nr. **, datë 23.9.2016, ka vendosur:

- *deklarimin fajtor të të pandehurve A. Sh dhe N.F;*
- *deklarimin e pafajshëm të të pandehurve S. B dhe G. Sh.*

Ndaj këtij vendimi ka paraqitur ankim Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës dhe sipas vërtetimit datë 7.5.2018, të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështja është dërguar për kompetencë në Gjykatën e Apelit Shkodër.

Gjithashtu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me vendimi nr. *** datë 28.7.2017, ka vendosur:

- *deklarimin e pafajshëm të të pandehurve B. H, E.B, N.A, R. F, S.K dhe K. D;*
- *deklarimin fajtor të të pandehurit F.J.*

Subjekti ka kryer dhe drejtuar hetime në këtë procedim penal, ka vendosur ngritjen e akuzave ndaj të pandehurve të lartpërmendur, ka vendosur dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. ** të vitit 2016, si dhe ka përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës në procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës ndaj të pandehurve të lartpërmendur.

Kërkesa për gjykimin e çështjes penale është strukturuar në tri pjesë: pjesa hyrëse, arsyetuese dhe konkluduese.

37.2.2. Subjektit i kaloi barra e provës në lidhje me këtë dokument, si vijon:

i. në germen “c” të pikës 2 të nenit 331 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se kërkesa për gjykim përmban burimet e provës dhe faktet që ato ju referohen, ndërkohë që prokurorja në kërkesën për gjykimin e çështjes penale nuk ka listuar asnjë burim prove që mbështet kërkesën e saj për gjykim, veprim ky në kundërshtim me nenin 331 të Kodit të Procedurës Penale;

ii. në pjesën hyrëse të aktit është përshkruar fakti se të pandehurit B.H, E.B, N.A, R.F dhe S. K akuzohen për kryerjen e veprës penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, ndërsa në pjesën konkluduese vetëm të pandehurit R.F dhe S.K akuzohen për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, ndërsa të pandehurit e tjerë, shtetasit B.H, E.B dhe N. A, janë akuzuar për kryerjen e veprës penale “kontrabandë nga punonjës që lidhen

me veprimtarinë doganore”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 175 dhe 25 të Kodit Penal;

iii. në pjesën hyrëse të kërkesës për gjykim rezultoi se i pandehuri A.Sh akuzohet për kryerjen e veprës penale “tregtim dhe transportim i mallrave që janë kontrabandë”, parashikuar nga neni 178 i Kodit Penal, ndërkohë që në pjesën konkluduese të aktit, i pandehuri A.Sh është akuzuar për veprat penale “kontrabandë me mallra të tjera” dhe “fshehje të të ardhurave”, parashikuar nga nenet 174 dhe 180 të Kodit Penal;

iv. për të pandehurit e tjerë, shtetasit S. B, N.F, G. Sh dhe F.J, vepra penale për të cilën janë akuzuar nuk është përshkruar qartë dhe saktë nga prokurorja e çështjes, pasi në pjesën hyrëse të aktit, përshkruhet se këta shtetas akuzohen për kryerjen e veprës penale “kontrabandë me mallra që paguhet akcizë”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 172 dhe 25 të Kodit Penal, ndërkohë që në pjesën konkluduese të aktit është përshkruar se këta të pandehur akuzohen për kryerjen e veprave penale “kontrabandë me mallra që paguhet akcizë” dhe “kontrabandë me mallra të tjera”, parashikuar nga nenet 172 dhe 174 të Kodit Penal.

37.2.3. Në përgjigje të barrës së provës, subjekti prapësoi se *në mbështetje të nenit 331/2 të Kodit të Procedurës Penale janë cituar të gjitha provat në “faktet objekt akuze”*. Hetimi i këtij procedimi penal është kryer nën monitorimin e strukturës përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme dhe drejtuesit të prokurorisë, të cilët kanë dhënë udhëzimet verbale telefonike ose në rrugë elektronike. Para dërgimit të çështjes për gjykim është analizuar në Prokurorinë e Përgjithshme nga drejtori përkatës, drejtuesi i prokurorisë dhe prokurori i çështjes, duke konkluduar për akuzat përkatëse për secilin subjekt të hetuar [...].

37.2.4. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, vlerëson se ato nuk janë bindëse dhe nuk është dhënë prej saj asnjë argument për të provuar të kundërtën e barrës së provës.

Komisioni çmon se në këtë dokument ligjor subjekti: (i) ka shfaqur njohuri të cekëta në lidhje me germen “c” të nenit 331/2 të Kodit të Procedurës Penale; (ii) nuk është thelluar në arsyetim (pasi ka mospërputhje midis akuzave të paraqitura në pjesën hyrëse të dokumentit me akuzat e paraqitura në pjesën konkluduese të aktit); (iii) ka reflektuar gjykim dhe aftësi të dobëta (pasi për të pandehurit shtetasit S.B, N.F, G.Sh dhe F.J vepra penale për të cilën janë akuzuar nuk është përshkruar qartë dhe saktë prej saj), të cilat konsiderohen mangësi profesionale.

38. Analiza e pesë dosjeve penale të përzgjedhura me short

38.1. Vendimi datë 9.12.2015, për mosfillimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2015 (dosja 1) – nuk kanë rezultuar problematika në lidhje me këtë dosje.

38.2. Vendimi datë 11.9.2014, për pushimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2014, të regjistruar për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal (dosja 2).

38.2.1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, në datën 15.5.2014 ka regjistruar procedimin penal nr. ***, për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal. Në përfundim të hetimeve paraprake, kjo prokurori ka vendosur *pushimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2014*.

Procedimi penal i mësipërm është regjistruar pas referimit të bërë nga policia gjyqësore pranë Komisarariatit të Policisë, Sarandë, me shkresën nr. *** prot., datë 14.5.2014. Nga shërbimet e policisë gjyqësore është proceduar me këqyrjen e vendit të ngjarjes, marrjen e kallëzimit nga ana e të dëmtuarit, marrjen e deklarimeve në cilësinë e personave që tregojnë rrethana të hetimit, sekuestrimin e provës materiale, është marrë vendim për kryerjen e ekspertimit mjeko-

ligjor për të dëmtuarin dhe kryerjen e ekspertimit kimik për materialin bimor, si dhe është proceduar me peshimin e materialit bimor të dyshuar si lëndë narkotike marijuanë.

Subjekti, lidhur me procedimin penal nr. *** të vitit 2014, ka proceduar me nxjerrjen e urdhrin për regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal.

Në datën 15.5.2014 subjekti ka urdhëruar ndarjen e çështjes penale, për faktin se materiali i referuar nga policia gjyqësore ka edhe elementë të veprës penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, duke veçuar aktet nga procedimi penal nr. *** i vitit 2014 dhe regjistrimin e procedimit penal nr. 417 të vitit 2014.

Në datën 11.9.2014 është vendosur pushimi i hetimeve në lidhje me procedimin penal nr. *** të vitit 2014, mbështetur në germën “c” të pikës 1 të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale (i dëmtuari heq dorë nga ankimi), vendim i cili nuk rezulton se ju është njoftuar të interesuarve, në përputhje me pikën 2 të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale.

38.2.2. Në lidhje me këtë procedim, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës, si vijon:

- i. urdhri i regjistrimit të procedimit penal nr. ***, datë 15.5.2014, është bërë në kundërshtim me ligjin dhe nuk përputhet me faktet e referuara nga policia gjyqësore, pasi tek referimi i bërë prej saj përshkruhet fakti se në portofolin e të dëmtuarit është gjetur një sasi material bimor me ngjyrë dhe aromë me atë të lëndës narkotike marijuanë, dhe për këtë fakt, në urdhrin e regjistrimit të procedimit penal nr. ***, datë 15.5.2014, duhet të ishte regjistruar edhe për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal.
- ii. vendimi për ndarjen e çështjes penale është bërë në kundërshtim me germën “ç” të pikës 1 të nenit 93 të Kodit të Procedurës Penale.
- iii. gjithashtu, subjekt rivlerësimi, pa kryer asnjë veprim hetimor, ka konkluduar në ndarjen e çështjes, vendim i cili mund të merrej në përfundim të hetimeve paraprake.
- iv. vendimi për pushimin e hetimeve të procedimit penal, datë 11.9.2014, është marrë në kundërshtim me ligjin, pasi nuk është administruar aktekspertimi mjeko-ligjor për të dëmtuarin M. Z, i cili është kusht i domosdoshëm për t’i dhënë kualifikimin e duhur ligjor faktit objekt hetimi. Neni 89 i Kodit Penal, për të cilën është regjistruar procedimi penal i lartpërmendur, parashikon se *plagosja e kryer me dashje, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se 9 ditë ...*, dhe se paaftësia e përkohshme në punë përcaktohet vetëm mbi bazën e aktekspertimit mjeko-ligjor.

38.2.3. Pas kalimit të barrë së provës, subjekti prapësoi se sipas ligjit në procedimin penal regjistrohej (neni 287 i Kodit të Procedurës Penale) edhe oficeri i policisë gjyqësore që do të hetonte çështjen dhe caktohej nga drejtuesi i prokurorisë përpara se materiali t’i dorëzohej prokurorit. Në këtë situatë, janë kryer vendimet procedurale në përputhje me ligjin dhe me relacionin e oficerit të policisë gjyqësore. Materiali është referuar vetëm për nenin 89 të Kodit Penal. Prokurori ka konstatuar elemente të tjera dhe ka veçuar materialin në kuadër të hetimit të gjithanshëm të çështjes penale për veprën penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, pavarësisht se prokurori i rrethit kishte përcaktuar hetimin vetëm për nenin 89 të Kodit Penal.

38.2.4. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitur (të cilat janë administruar nga Komisioni edhe në dosjen e vlerësimit profesional) nga subjekti, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Subjekti nuk ka paraqitur asnjë argument për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit dhe nuk mund të justifikohet me faktin se është bazuar në relacionin e oficerit të policisë gjyqësore, pasi në bazë të nenit 24/1 të Kodit të Procedurës Penale është prokurori ai që ushtron ndjekjen penale, bën hetime, kontrollon hetimet paraprake, ngre akuzë në gjykatë, si dhe merr

masa për ekzekutimin e vendimeve. Për më tepër, në referimin e kryer nga policia gjyqësore përshkruhet fakti se në portofolin e të dëmtuarit është gjetur një sasi material bimor me ngjyrë dhe aromë me atë të lëndës narkotike marijuanë dhe për këtë fakt, në urdhrin e regjistrimit të procedimit penal nr. ***, datë 15.5.2014, duhet të ishte regjistruar edhe për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal.

38.2.5. Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti, në lidhje me këtë procedim, ka shfaqur: (i) njohuri të cekëta; (ii) aftësi dhe gjykim të dobët; si dhe (iii) një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e prokurorit (pasi nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore), të cilat konsiderohen mangësi profesionale.

38.3. Vendimi datë 25.12.2015, “Për pushimin e hetimeve të çështjes penale nr. *** të vitit 2015”, të regjistruar për veprën penale “mashttrim në sigurime”, parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal (dosja 3).

38.3.1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, në datën 11.11.2015 ka regjistruar procedimi penal nr. ***, për veprën penale “mashttrim në sigurime”, parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal. Në përfundim të hetimeve paraprake kjo prokurori ka vendosur *pushimin e hetimeve të çështjes penale nr. *** të vitit 2015.*

Në datën 18.11.2015 subjekti ka kërkuar nga Zyra e Gjendjes Civile të Njësisë Administrative nr. **, Tiranë, certifikatën personale dhe familjare të të kallëzuarës Z.Gj dhe në datën 1.12.2015 është administruar certifikata e vdekjes, lëshuar nga kjo zyrë civile, nga ku rezulton fakti se shtetasja Z. Gj ka ndërruar jetë më 19.9.2011.

Në datën 25.12.2015 është vendosur pushimi i hetimit të çështjes penale nr. *** të vitit 2015, mbështetur në nenet 66, germa “d” e Kodit Penal dhe 328, pika 1, germa “d” e Kodit të Procedurës Penale, për faktin se ndjekja penale është parashkruar, vendim i cili rezulton se u është njoftuar të interesuarve, në përputhje me nenin 328, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, me shkresën nr. **** prot., datë 17.9.2015.

38.3.2 Prokuroria e Përgjithshme ka konstatuar:

i. Baza ligjore dhe argumentet e përdorura nga prokurorja e çështjes në vendimin e pushimit nuk i përgjigjet rrethanave të faktit dhe shkakut ligjor të pushimit, pasi prej saj është administruar certifikata e vdekjes të të kallëzuarës dhe nga ana tjetër pushimi i çështjes është bërë me argumentin se ndjekja penale është parashkruar.

ii. Në nenin 328, pika 1, germa “ë” e Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: “*Në çdo fazë të procedimit prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur: [...] ë) i pandehuri vdes*”. Ndërsa në nenin 34/a/3 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: “*Të drejtat dhe garancitë e parashikuara për të pandehurin zbatohen edhe për personin nën hetim dhe personin të cilit i atribuohet vepra penale, me përjashtim të rasteve kur ky kod parashikon ndryshe*”. Në kushtet kur personi për të cilin ishte bërë kallëzim penal nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Kukës dhe për të cilin po kryheshin hetime nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, ka ndërruar jetë, kjo e konfirmuar nga certifikata e vdekjes, atëherë prokurorja e çështjes duhet të kishte marrë vendim pushimi të menjëhershëm, pasi i mungonte subjekti i veprës penale, njëri ndër katër elementët e figurës së veprës penale (objekti, ana objektive, subjekt dhe ana subjektive) dhe se shkak ligjor për pushimin e këtij procedimi penal nuk duhet të ishte germa “d” e nenit 328/1 (ndjekja penale është parashkruar), por germa “f” e nenit 328/1 (i pandehuri vdes).

iii. Nga ana tjetër, vendimi për pushimin e çështjes është marrë 24 ditë pasi është administruar certifikata e vdekjes së personit të kallëzuar.

38.3.3. Në lidhje me këtë procedim, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës, si vijon:

- a. subjekti nuk ka zbatuar dispozitat e parashikuara nga neni 328/1/ë i Kodit të Procedurës Penale, pasi nuk ka pushuar menjëherë çështjen me administrimin e certifikatës së vdekjes së të kallëzuarës;
- b. subjekti nuk ka përcaktuar saktë shkakun ligjor për pushimin e procedimit penal;
- c. subjekti ka vijuar hetimet edhe për 21 ditë, pavarësisht faktit që e kallëzuara kishte ndërruar jetë.

38.3.4. Subjekti ka prapësuar se: *Konstatimi se baza ligjore e referuar nga ana e saj për pushimin e çështjes duhet të ishte neni 328, pika 1, germa “ë” e Kodit të Procedurës Penale, nuk qëndron. Kjo dispozitë e cilësuar nga Komisioni, parashikon se: “Në çdo fazë të procedimit prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur: [...] ë) i pandehuri vdes”. Nga ana e Komisionit nuk citohet në tërësi dispozita përkatëse e Kodit të Procedurës Penale, e cila parashikonte në atë kohë se:*

Neni 328, Pushimi çështjes

1. Në çdo fazë të procedimit, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur:

- a) del qartë se fakti nuk ekziston;*
- b) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale;*
- c) i dëmtuari nuk ka bërë ankim ose heq dorë nga ankimi në rastet që procedimi fillon me kërkesën e tij;*
- ç) personi nuk mund të merret si i pandehur ose nuk mund të dënohet;*
- d) ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose për të cilin ndjekja penale nuk duhej të fillohej ose nuk duhet të vazhdojë;*
- dh) del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai;*
- e) me vendim të formës së prerë i pandehuri është gjykuar për të njëjtën vepër penale;*
- ë) i pandehuri vdes;*
- f) në rastet e tjera të parashikuara me ligj.*

Nga vetë formulimi i dispozitës ligjore, ajo rendit rastet se kur organi procedues duhet të vendosë në çdo fazë të procedimit pushimin e akuzës/çështjes. Dhe rasti i parashkrimit ndodhet qartazi nën germën “d”, “ekzistenca e një shkakut që e shuan veprën penale ose për të cilin ndjekja penale nuk duhej të fillohej ose nuk duhej të vazhdojë”. Ky rast dhe ndalesa ligjore është renditur nga ligjvënësi përpara rastit të parashikuara nga germa “ë”, “i pandehuri vdes” dhe, si i tillë, detyron organin procedues ta bazojë vendimmarrjen e tij pikërisht në dispozitën e pikës “d”, ashtu siç është vepruar në rastin konkret nga subjekti i rivlerësimit.

Për më tepër, në këtë rast duhet të ishte pikërisht neni 328/1, germa “d” (ndjekja penale është parashkuar), sepse në tërësinë e procedimeve të hetuara ka rezultuar se pavarësisht se personi përfitues ka vdekur, persona të tjerë të afërm ose jo kanë vazhduar të marrin pensionin për llogari të personit të vdekur. Në këtë kuptim është ezauruar çdo mundësi e tillë me “parashkrimin e ndjekjes penale”. Pasi është verifikuar ky fakt dhe është konfirmuar se edhe pse pas vdekjes është disbursuar pension edhe për 1 muaj në emër të së vdekurës, nuk mund të hetohej për këtë fakt për shkak të ezaurimit të afatit të parashkrimit [...].

38.3.5. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, duke i krahasuar me dokumentin “vendim për pushimin e gjykimit të çështjes penale nr. ***/2015”, konstaton se në këtë dokument nuk rezulton që ajo të jetë shprehur në lidhje me zgjerimin e hetimit edhe tek personat e tjerë të afërm, ose jo, që kanë vazhduar të marrin pensionin për llogari të personit të vdekur. Në këtë vendim, subjekti analizon vetëm faktin që kemi të bëjmë me parashkrimin e veprës penale, por pa u shprehur në lidhje me përfitimin e pensionit nga persona të tjerë pas vdekjes së personit nën hetim. Gjithashtu, në lidhje me renditjen e shkaqeve të pushimit të procedimit, Komisioni vlerëson se në rastin në fjalë subjekti duhet të zbatonte germën “ë” të nenit 328, pasi

kishim të bënim me një person të vdekur dhe procedimi nuk mund të vijonte. Pikërisht kjo gërmë e përjashton mundësinë e vijimit të hetimit dhe pushimit të tij, për arsye të tjera siç është parashkrimi, i cili mund të zbatohet në rast se personin nën hetim do të ishte gjallë.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka zbatuar dispozitat e parashikuara nga neni 328/1/ë i Kodit të Procedurës Penale, pasi nuk ka pushuar menjëherë çështjen me administrimin e certifikatës së vdekjes së të kallëzuarës, duke vijuar hetimet edhe për 21 ditë, si dhe nuk ka përcaktuar saktë shkaku ligjor për pushimin e procedimit penal.

38.3.6. Në lidhje me këtë procedim, subjekti ka shfaqur njohuri të cekëta, aftësi dhe gjykim të dobët, duke mos pushuar menjëherë çështjen, të cilat konsiderohen mangësi profesionale.

38.4. Kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. * të vitit 2015,** në ngarkim të të pandehurit A. E, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “kanosje për të mos kallëzuar”, parashikuar nga neni 311 i Kodit Penal (dosja 4) – nuk janë konstatuar probleme me këtë dosje.

38.5. Kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. ** të vitit 2014, në ngarkim të të pandehurit Y.Th, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “shkatërrim prone nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 161 i Kodit Penal (dosja 5).

38.5.1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, në datën 16.1.2014, ka regjistruar procedimin penal nr. **, për veprën penale “shkatërrim prone”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal. Në përfundim të hetimeve paraprake kjo prokurori ka vendosur *dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. ** të vitit 2014, në ngarkim të të pandehurit Y.Th, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “shkatërrim prone nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 161 i Kodit Penal.*

38.5.2. Në datën 7.3.2015 subjekti ka marrë vendim për marrjen e pandehur dhe njoftimin e akuzës të shtetasit Y.Th si i pandehur për veprën penale “shkatërrim prone nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 161 i Kodit Penal. Më pas, në datën 24.3.2014 shtetasi Y. Th është pyetur si i pandehur nga oficeri i policisë gjyqësore dhe është njohur me aktet e hetimeve paraprake të procedimit penal nr. ** të vitit 2014.

38.5.3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. **, datë 23.1.2015, ka vendosur *deklarimin fajtor të të pandehurit Y. Th për veprën penale “shkatërrim i pronës nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 161 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 (tre) muaj burgim.*

38.5.4. I pandehuri Y.Th ka bërë ankim ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe Gjykata e Apelit Gjyrokastër, me vendimin nr. ***, datë 23.9.2016, ka vendosur *prishjen e vendimit penal nr. **, datë 23.1.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, sa i takon procedimit penal dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit Y. Th.*

38.5.5. Sipas shkresës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, rezulton se ndaj vendimit nr. ***, datë 23.9.2016, të Gjykatës së Apelit Gjyrokastër është ushtruar rekurs nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Gjyrokastër dhe fashikulli ndodhet për kompetencë gjyqësore në Gjykatën e Lartë.

39. Të dhënat arkivore (ankesat dhe masat disiplinore)

39.1. Referuar të dhënave arkivore pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme për prokurorin, subjekt rivlerësimi, rezulton se:

- i. me urdhrin nr. ***, datë 13.10.2004, të Prokurorit të Përgjithshëm, ka filluar procedimi disiplinor ndaj subjektit pasi:
 - nga kontrolli i shtruar në procedimin penal nr. **/2004, subjekti, në përfundim të hetimeve, në kundërshtim me kërkesat e Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur *anulimin e Urdhrit të Kërkimit për të pandehurin Q. M;*

- subjekti ka kryer shkelje të ligjës dhe në procedimin penal në ngarkim të z. Gj.Y;
- ii. me urdhrin nr. ***, datë 11.11.2004, të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin e rivlerësimit është dhënë masa disiplinore “zbritje në detyrën e oficerit të policisë gjyqësore për një periudhë prej 6 (gjashtë) muajsh”;
- iii. me urdhrin nr. ***, datë 18.9.2006, të Prokurorit të Përgjithshëm, ndaj subjektit është dhënë masa disiplinore “vërejtje me paralajmërim për lirim nga detyra”, pasi ka kryer shkelje të rënda të ligjit në lidhje me procedimin penal nr. **/2003. Subjekti ka pushuar hetimet për të pandehurin z. S.R, i cili ka qenë i arrestuar më 27.3.2003. Ky vendim pushimi është shfuqizuar dhe i pandehuri S. R është dënuar në mungesë me 10 vjet heqje lirie për veprën penale të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, vendim i cili ka marrë formë të prerë’
- iv. me urdhrin nr. ***, datë 9.6.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm, ka filluar procedim disiplinor ndaj subjektit, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, pas kontrollit të ushtruar dhe rezultateve të kontrollit nga Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme.

Pas përfundimit të procedimit disiplinor, konstatimit të shkeljeve në hetim dhe gjykim nga subjekti, si dhe mendimit të Këshillit të Prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm, me shkresën nr. **** prot., datë 25.7.2008, i ka propozuar Presidentit të Republikës shkarkimin e saj nga detyra.

- i. Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. ***, datë 28.7.2008, vendos shkarkimin nga detyra të subjektit, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.
- ii. Ndaj dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin nga detyra, subjekti ka bërë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. **, datë 21.10.2009, ka vendosur rikthimin në detyrë të prokurores dhe për zbatimin e këtij vendimi, Prokurori i Përgjithshëm, me vendimin nr. **, datë 9.1.2013, ka vendosur rikthimin në detyrë të subjektit.

39.2. Nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e ankesave në Prokurorinë e Përgjithshme rezulton se ndaj subjektit të rivlerësimit janë paraqitur këto ankesa:

i. Në datën 20.2.2016 në Prokurorinë e Përgjithshme ka paraqitur ankesë shtetasi M. M, i cili ka sjellë në këtë institucion kallëzimin e tij të bërë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, në ngarkim të subjektit.

ii. Në datën 27.2.2008 shtetasi Dh.S ka paraqitur një ankesë në Prokurorinë e Përgjithshme, duke pretenduar faktin se subjekti ka falsifikuar disa dokumente të ankuesit dhe nga Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme është lënë detyrë t’i kërkohet ankuesit që pretendimet ndaj subjektit t’i paraqesë me shkrim, pasi nga letra nuk del se çfarë dokumenti është falsifikuar.

iii. Në datën 13.6.2016 në Prokurorinë e Përgjithshme është paraqitur një ankesë nga shtetasja E. F, duke pretenduar faktin se subjekti, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, shtetasi G.Q, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës dhe avokati I N kanë vepruar në mënyrë të kundërligjshme dhe të njëanshme, duke arrestuar shtetasin R. F(babai i ankueses) për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, në një kohë që pretendohet se nuk e ka kryer veprën penale. Ankesës i është bashkëlidhur edhe një kopje e kërkesës për gjykim e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës ndaj të pandehurit R.F, ku rezulton se ky i fundit është akuzuar për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe është hetuar me masë sigurimi “arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. Prokuroria e Përgjithshme i ka

kthyer përgjigje ankuesit se ankesa e tij nuk mund të shqyrtohet nga ky institucion, për faktin se çështja penale për të cilën është paraqitur ankesa ndodhet në fazën e shqyrtimit gjyqësor dhe në bazë të nenit 354 e vijues të Kodit të Procedurës Penale i pandehuri (R. F) ka të drejtë të parashtrijë të gjitha pretendimet e paraqitura në ankesë gjatë shqyrtimit gjyqësor penal.

iii/1 Komisioni, në lidhje me këtë ankesë, ka analizuar procedimin penal nr. *****/2016, nga ku rezulton se:

- në datën 17.2.2016 subjekti ka urdhëruar regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, të z. K. M;
- bazuar në urdhrin e ndalimit të të dyshuarit për një krim të datës 16.2.2016, subjekti ka kërkuar ndalimin e z. K. M, duke argumentuar se gjatë ushtrimit të detyrës, sipas procesverbalit të këqyrjes së pamjeve filmike në pikën doganore, ka ushtruar kontroll fiktiv në automjetin i cili është sekuestruar me mall kontrabandë nga policia gjyqësore;
- bazuar në urdhrin e ndalimit të të dyshuarit për një krim të datës 16.2.2016, subjekti kërkon ndalimin e z. D. E, pasi nuk ka marrë asnjë masë për parandalimin, evidentimin dhe kapjen e mallit kontrabandë;
- në datat 18-19 janar 2016 (ora 22:08) z. R. F nuk ka qenë në turn, bazuar në grafikun e shërbimit;
- bazuar në vendimin nr. ***, datë 9.3.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës argumentohet se për periudhën kohore: ora 23:00, datë 15.2.2016 – ora 03:00, datë 16.2.2016, z. R. F ka qenë duke pushuar sipas urdhrin të brendshëm të Doganës Morinë në dijeni të plotë nga përgjegjësi i turnit dhe kryetari i degës të doganës në kohën që ka kaluar malli kontrabandë;
- bazuar në vendimin për marrjen si të pandehur dhe komunikimin e akuzës për z. R. F, rezulton se subjekti pasqyron faktin se nga këqyrja e grafikut të shërbimit gjatë natës të doganierëve të kontrollit fizik, z. R.F: ora 21:20-22:00 Jo ora 22:00-24:00 është korrigjuar ora 24:00-03:00 Jo...

Në këtë dokument nuk rezulton që subjekti të ketë analizuar veprimet apo mosveprimet e të pandehurit R.F për kryerjen e veprës penale “shpërdorim detyre”. Në asnjë pjesë të dokumentit nuk flitet për veprime apo mosveprime konkrete të z. R. F apo për provat që kanë shërbyer për të provuar kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar. Subjekti nuk rezulton të ketë analizuar elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, si dhe figurën e veprës penale “shpërdorim detyre”.

iii/2 Komisioni, pasi analizoi kërkesën për gjykim të subjektit të datës 10.3.2016, ku ndër të tjera si i pandehur paraqitet edhe z. R. F, i akuzuar për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, konstaton se:

- a. subjekti nuk ka kryer analizë të figurave të veprave penale: “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, “kontrabandë nga punonjësit që lidhen me veprimtari doganore në bashkëpunim”, parashikuar nga nenet 175 dhe 25 të Kodit Penal, “kontrabandë me mallra që paguhet akcizë” dhe “kontrabandë me mallra të tjera”, parashikuar nga nenet 172 dhe 174 të Kodit Penal, “tregtim i mallrave kontrabandë”, parashikuar nga neni 178 i Kodit Penal, si dhe “veprime që pengojnë zbulimin e të vërtetës”, parashikuar nga neni 301 i Kodit Penal;
- b. është e paqartë se pse nuk janë marrë si të pandehur z. B. Xh(i cili ka qenë në automjetin ku u gjenden mallrat kontrabandë), z. S. Gj (drejtues i automjetit), z. D. E (i cili ka qenë

në turn në momentin e kryerjes së veprës penale), z. K. M (i cili ka qenë i arrestuar së bashku me personat e tjerë);

- c. në dokumentin kërkesë për gjykim nuk rezulton që subjekti të ketë analizuar veprimet apo mosveprimet e z. R.F në lidhje me veprën penale për të cilët akuzohet. Në kërkesë nuk ka asnjë moment që të trajtohen këto veprime në mënyrë të tillë që të evidentohet qartë vepra penale e kryer nga z. R. F.

iii/3 Në përfundim, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, si vijon:

- a. subjekti nuk ka analizuar figurat e veprave penale: “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal; “kontrabandë nga punonjësit që lidhen me veprimtari doganore në bashkëpunim”, parashikuar nga nenet 175 dhe 25 të Kodit Penal; “kontrabandë me mallra që paguhet akcizë” dhe “kontrabandë me mallra të tjera”, parashikuar nga nenet 172 dhe 174 të Kodit Penal; “tregtimi i mallrave kontrabandë”, parashikuar nga neni 178 i Kodit Penal, si dhe “veprimet që pengojnë zbulimin e të vërtetës”, parashikuar nga neni 301 i Kodit Penal;
- b. subjekti nuk ka analizuar veprimet apo mosveprimet e z. R. F në lidhje me veprën penale për të cilën akuzohet, si dhe nuk ka cituar provat që kanë shërbyer për të provuar kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar shtetasi;
- c. subjekti nuk ka marrë në konsideratë faktin se z. R.F nuk ka qenë në shërbim në momentin e kryerjes së veprës penale;
- d. subjekti ka pushuar çështjen penale në ngarkim të z. K.M, pavarësisht se ka deklaruar se ky shtetas, gjatë ushtrimit të detyrës sipas procesverbalit të këqyrjes së pamjeve filmike në pikën doganore, ka ushtruar kontroll fiktiv në automjetin i cili është sekuestruar me mall kontrabandë nga policia gjyqësore;
- e. është e paqartë se pse nuk janë marrë si të pandehur z. B.Xh (i cili ka qenë në automjetin ku u gjenden mallrat kontrabandë), z. S. Gj (drejtues i automjetit) dhe z. D.E (i cili ka qenë në turn në momentin e kryerjes së veprës penale).

iii/4 Pas kalimit të barrës së provës, subjekti prapësoi: *“Lidhur me ankesën e shtetases E. F., jam dakord me përgjigjen që ka kthyer Prokuroria e Përgjithshme për këtë shtetase. Gjetjet e Komisionit i kundërshtoj me argumentimin që kam dhënë në pjesën e arsytimit të gjetjeve për tri dokumentet ligjore të dorëzuara prej meje bashkë me provat e përshkruara në atë paragraf”*.

iii/5 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, si dhe provat e paraqitura prej saj, përfshirë edhe dokumentin “Diskutim përfundimtar për procedimin penal nr. **, të vitit 2016”, të depozituar nga subjekti pas kalimit të barrës së provës, vlerëson se nuk janë bindëse. Nga ana e saj nuk është dhënë asnjë argument në lidhje me:

- a. cilat kanë qenë veprimet apo mosveprimet e z. R. F në lidhje me veprën penale për të cilën akuzohet, si dhe cilat kanë qenë provat që kanë shërbyer për të provuar kryerjen e veprës penale nga ky shtetas;
- b. cilat kanë qenë arsyet për pushimin e çështjes në ngarkim të z. K. M, pavarësisht se ka deklaruar se ky shtetas, gjatë ushtrimit të detyrës sipas procesverbalit të këqyrjes së pamjeve filmike në pikën doganore, ka ushtruar kontroll fiktiv në mjetin, i cili është sekuestruar me mall kontrabande nga policia gjyqësore;
- c. cilat kanë qenë arsyet që nuk janë marrë si të pandehur z. B.Xh (i cili ka qenë në automjetin ku u gjenden mallrat kontrabandë), z. S.Gj (drejtues i automjetit) ku u gjenden mallrat kontrabandë) dhe z. D.E (i cili ka qenë në turn në momentin e kryerjes së veprës penale).

Në lidhje me tri pikat e mësipërme subjekti nuk ka paraqitur parashtrime, duke mos i trajtuar fare këto konstatime të Komisionit.

iii/6 Në përfundim, Komisioni vlerëson se:

- a. subjekti ka mangësi në hetim në lidhje me këtë procedim penal, pasi nuk ka marrë si të pandehur z. B. Xh (i cili ka qenë në automjetin ku u gjenden mallrat kontrabandë), z. S. Gj(drejtues i automjetit) dhe z. D.E (i cili ka qenë në turn në momentin e kryerjes së veprës penale), si dhe ka pushuar çështjen për z. K.M për të cilin kishte deklaruar se ky shtetas gjatë ushtrimit të detyrës, sipas procesverbalit të këqyrjes së pamjeve filmike në pikën doganore, ka ushtruar kontroll fiktiv në automjetin i cili është sekuestruar me mall kontrabandë nga policia gjyqësore;
- b. subjekti nuk ka analizuar veprimet apo mosveprimet e z. R.F në lidhje me veprën penale për të cilën akuzohet, si dhe nuk ka cituar provat që kanë shërbyer për të provuar kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar ky shtetas;
- c. subjekti nuk ka marrë në konsideratë faktin se z. R.F nuk ka qenë në shërbim në momentin e kryerjes së veprës penale.

iii/7 Në lidhje me këtë procedim, subjekti ka shfaqur: (i) njohuri të cekëta; (ii) aftësi dhe gjykim të dobët; (iii) ka një mënyrë pune që nuk pajtohet me detyrën e prokurorit (pasi ka pushuar çështjen në ngarkim të z. K.M, nuk ka marrë si të pandehur shtetasit B. Xh, S. Gj dhe D. E, si dhe ka marrë si të pandehur z. R. F, i cili nga provat rezulton se nuk kishte qenë në shërbim), të cilat konsiderohen mangësi profesionale.

iv. Në datën 10.1.2018 shtetasi L.H i është drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe për dijëni edhe Prokurorisë së Përgjithshme, duke kërkuar informacion në lidhje me një kallëzim penal të bërë më 5.10.2017 në Prokurorinë e Lezhës kundër subjektit. Kjo praktikë është arkivuar nga Prokuroria e Përgjithshme.

v. Në datën 7.2.2018 shtetasi B. Gj i është drejtuar drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, znj. A. N, dhe për dijëni, Prokurorit të Përgjithshëm në lidhje me subjektin, ku kërkohet respektimi i etikës profesionale të saj. Ankuesi ngre shqetësimin se subjekti, për 10 seanca gjyqësore, nuk ka vendosur fashikullin hetimor të procedimit penal nr. *** të vitit 2016 në dispozicion të procesit gjyqësor, me objekt “shfuqizimin e vendimit datë 3.5.2017, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, “Për pushimin e çështjes penale lidhur me procedimin penal nr. ***/2016”. Prokuroria e Përgjithshme, në datën 3.5.2018 i ka kërkuar informacion i hollësishëm Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës në lidhje me pretendimet e ankuesit, kopje të procesverbaleve të seancave gjyqësore, me objekt “shfuqizimin e vendimit të pushimit datë 3.5.2017, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës”, si dhe kërkesat e gjyqtarit të çështjes (nëse ka) drejtuar Prokurorisë së Kukësit.

v/1 Në lidhje me këtë, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës sepse duket sikur subjekti ka zvarritur me dashje procesin gjyqësor, pasi në 10 seanca gjyqësore nuk ka vendosur në dispozicion të gjykatës fashikullin hetimor të procedimit penal nr. ***/2016.

v/2 Subjekti ka prapësuar duke vënë në dispozicion të Komisionit procesverbalet e seancave gjyqësore. Nga shqyrtimi rezulton se ajo ka shtyrë 3 seanca gjyqësore, konkretisht: seanca gjyqësore e datës 5.6.2017, me shkak ligjor (takim zyrtar në Prefekturë për luftën kundër kanabis); në datën 28.7.2017, Analizë Pune në Prokurorinë e Përgjithshme me të gjithë drejtuesit e prokurorive; në datën 11.9.2017, për arsye familjare, nuk është paraqitur në punë pasi ka njoftuar paraprakisht në Prokurorinë e Përgjithshme. Nga procesverbalet e seancave gjyqësore nuk rezulton të jetë i vërtetë fakti se nuk i ka vënë në dispozicion gjykatës fashikullin

e hetimit, por rezulton se ka marrë masat edhe në rastet kur për një arsye familjare nuk është paraqitur në punë, ka autorizuar një prokuror koleg të përfaqësojë çështjen me qëllim shmangien e zvarritjes. Komisioni, pasi analizoi provat dhe shpjegimet e subjektit, konstaton se pavarësisht se çështja është zgjatur, kjo nuk ka ardhur për veprimet ose mosveprimet e subjektit të rivlerësimit.

vi. Në datën 6.3.2018, në adresë të Prokurorit të Përgjithshëm, ka ardhur një ankesë nga shtetasja L. D, ankesë e cila i është përcjellë për zgjidhje ligjore Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

vii. Në datën 29.5.2017, në adresë të Prokurorit të Përgjithshëm, ka ardhur një ankesë nga shtetasi B. D, duke pretenduar faktin se ka bërë kallëzim penal në Prokurorinë e Kukësit dhe nga kjo e fundit është marrë vendim për pezullimin e hetimeve. Më pas, kallëzuesi ka kërkuar takim me subjektin, por kjo e fundit nuk e ka takuar. Gjithashtu, ankuesi ka paraqitur edhe një kërkesë me shkrim në Prokurorinë e Kukësit, për të cilën nuk ka marrë asnjë përgjigje. Ankesa e shtetasit B.D i është përcjellë për zgjidhje ligjore Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

viii. Në datën 4.3.2015 në Prokurorinë e Përgjithshme është paraqitur një ankesë nga shtetasi A. H, kundër prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, S. P dhe Rita Gjati, lidhur me kallëzimin e datës 26.12.2014, kundër mjekut K.S për vdekjen e të atit në spitalin e Përmetit në datën 23.9.2013. Sipas ankuesit, sjellja e prokurorëve kishte qenë e padrejtë. Megjithëse kishte bërë kërkesë për zëvendësimin e oficerit të policisë gjyqësore A. N, pasi kishte lidhje familjare dhe ishte nga e njëjta zonë me të kallëzuarin, prokuroria nuk e kishte zëvendësuar. Gjithashtu, sipas ankuesit, gjatë kontakteve që ai kishte pasur me subjektin, ajo ishte shprehur: “silli ti personat se ne nuk na vijnë”, ndërsa prokurorja S. P ishte shprehur se: “rasti nuk ishte aq i rëndë, nuk kishte nevojë të bëhej kallëzim penal dhe se nuk mund të merrej prokuroria me të”. Nga verifikimet ka rezultuar se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, në datën 26.12.2014 ka regjistruar procedimin penal nr. ***, për veprën penale “mjekim i pakujdesshëm”, parashikuar nga neni 96 i Kodit Penal. Në datën 10.2.2015, shtetasi A.H, në cilësinë e kallëzuesit, ka paraqitur një kërkesë, ku, ndër të tjera, kërkonte edhe zëvendësimin e oficerit të policisë gjyqësore për faktin se është nga e njëjta zonë me personin që i atribuohet vepra penale dhe se ka lidhje gjaku me këtë të fundit dhe në datën 14.2.2015 prokurorja S.P, në cilësinë e drejtueses së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, ka marrë vendim për mosmiratimin e kërkesës për përjashtimin e oficerit të policisë gjyqësore duke argumentuar se: “Bazuar në kërkesat e neneve 16, 17 dhe 27 të Kodit të Procedurës Penale, fakti i parashtruar nga kallëzuesi se oficeri i policisë gjyqësore është nga e njëjta zonë me personin që i atribuohet vepra penale, nuk përbën shkak për njëanshmëri dhe aq më tepër për përjashtim nga hetimi i kësaj çështjeje, ndërsa nuk është i vërtetë fakti se oficeri i policisë gjyqësore ka lidhje gjaku me shtetasin K.S”. Në datën 10.12.2015, nga Prokuroria e Përgjithshme është informuar shtetasi A. H se nga verifikimet e kryera me prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet nuk rezulton se ka pasur shkelje dhe komunikimi i tyre ka qenë korrekt.

ix. Në datën 14.9.2017, në Prokurorinë e Përgjithshme ka paraqitur kallëzim penal shtetasi A. Xh, ndaj subjektit, prokurorë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës dhe oficerit të policisë gjyqësore B.Xh për veprat penale “falsifikim i dokumenteve” dhe “shpërdorim detyre”, parashikuar nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal. Ky kallëzim penal i është përcjellë për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

Komisioni analizoi kërkesën për gjykim të procedimit penal nr. ***/2017 të subjektit në lidhje me procedimin penal në ngarkim të z. A.Xh, duke konstatuar se subjekti nuk ka analizuar figurën e veprës penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Në lidhje me këtë ankesë, Komisioni ka analizuar edhe dokumentacionin e procedimit penal nr. ***/2018, nga ku ka rezultuar se në datën 16.10.2017, me vendim nr. **, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës ka vendosur kalimin e akteve që i përkasin çështjes penale nr. **, datë 31.7.2017 për procedimin penal nr. **/2017 në ngarkim të të pandehurve A.Xh, etj.

Kalimi i akteve ka ardhur si pasojë e kërkesës së prokurorit E. K, i cili përpara gjykatës ka kërkuar tërheqjen e akuzës dhe kalimin e akteve për plotësim hetimesh, pasi nga studimi i fashikullit ka konstatuar se janë disa akte që kanë të bëjnë me liritë dhe të drejtat e të pandehurve në gjykim që nuk janë të plota. Aktet për të pandehurin A.Xh nuk janë të plota dhe në drejtim të tij është bërë me një procesverbal njohja me aktet, por i pandehuri nuk ka dhënë shpjegime për akuzën e ngritur ndaj tij. Ai nuk është pyetur lidhur me aktet dhe gjithë përbërjen e tyre dhe nuk ka dhënë shpjegime të hollësishme.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, në datën 15.12.2017, me vendimin nr. ***, ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës dhe pushimin e procedimit penal nr. **/2017 në ngarkim të shtetasit A. Xh.

ix/1 Në përfundim, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, si vijon:

- a. subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore në lidhje me procedimin penal nr. **/2017;
- b. subjekti ka cenuar liritë dhe të drejtat e z. A.Xh, pasi nuk ka marrë shpjegimet e tij në lidhje me akuzën e ngritur, si dhe nuk e ka pyetur në lidhje me aktet dhe përbërjen e tyre;
- c. për të njëjtin procedim, pas kryerjes së veprimeve të tjera hetimore, është vendosur pushimi i tij;
- d. subjekti i rivlerësimit nuk ka analizuar figurën e veprës penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

ix/2 Pas kalimit të barrës së provës subjekti prapësoi se procedimi penal është regjistruar mbi bazën e informacioneve të administruara nga agjencitë ligjzbatuese se në Aeroportin e Kukësit paguheshin punonjës nga buxheti i shtetit, në një kohë që ky aeroport nuk funksionon, por as punonjësit nuk paraqiten në detyrë. Pasi janë kryer veprimet procedurale nga policia gjyqësore ka rezultuar se shtetit i është shkaktuar një dëm financiar i konsiderueshëm. I pandehuri A. Xh. është njoftuar, është paraqitur dhe ka refuzuar të njihet me aktet në ngarkim të tij, siç i është kërkuar nga oficeri i policisë gjyqësore dhe në këto rrethana është dërguar për gjykim. Ky gjykim ka filluar në muajin shtator. Ditën e seancës gjyqësore subjekti nuk është paraqitur në punë për probleme familjare (operim i bashkëshortit). Ndërkohë është vënë në dijeni nga mediat se ishte komanduar në Tropojë për shkak se shtetasi A. Xh. dhe bashkëshortja e tij I. K., pedagoge në Tiranë, kishin kallëzuar penalisht prokurorin e çështjes dhe oficerin e policisë gjyqësore.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, në vendimin nr. *** (**), datë 25.9.2018, ka konkluduar se: *“Në analizë të provave shkresore të administruara nga ana e gjykatës, të kërkuara nga organi i akuzës çmohet se nga hetimet e kryera rezulton se fakti penal i referuar nga kallëzuesi A. Xh. në kallëzimin penal, del qartë se nuk ekziston [...]”*. Subjekti ka parashtruar se ky vendim nuk është ankimuar nga shtetasi A. Xh., i cili rrjedhimisht është pajtuar me atë vendimmarrje. Subjekti kundërshton gjetjen e Komisionit se pas kryerjes së veprimeve hetimore çështja është pushuar me arsyetimin se nuk është kryer asnjë veprim hetimor që të përmbysë akuzën ose të vërtetojë se dëmi financiar shkaktuar shtetit nuk ekziston (p.sh. riekspertimi kontabël). Subjekti ka parashtruar se: *“Fakti që gjykata ka pranuar kërkesën e prokurorit për pushimin e çështjes nuk konfirmon se unë kam shkelur ligjin në administrimin e provave. Asnjë provë nuk është deklaruar e pavlefshme në kuptim të ligjit procedural penal, as nuk është analizuar në këtë këndvështrim. Kundërshtoj gjetjen e Komisionit lidhur me faktin e shkeljes së të drejtave të*

*shtetasit A. Xh., sepse me vendimin e gjykatës nr. *** (**), datë 25.9.2018, i cili ka marrë formë të prerë pa u ankimuar nga shtetasi A. Xh., pranohet se prokurori dhe OPGJ-ja kanë respektuar normat ligjore lidhur me administrimin e veprimeve procedurale në hetim, përfshirë edhe njoftimin për përfundimin e hetimit dhe njohjen me aktet. Është e drejtë e subjektit të hetimit që të refuzojë këtë moment procedural penal. Në këto rrethana çmohet se gjetjet e Komisionit për këtë shtetas janë jo në përputhje me aktet e dosjes konkrete [...]”.*

ix/3 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura, konstaton se ato nuk janë bindëse. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se në datën 16.10.2017, me vendimin nr. ***, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës ka vendosur kalimin e akteve që i përkasin çështjes penale nr. ***, datë 31.7.2017, për procedimin penal nr. ***/2017 në ngarkim të të pandehurit A. Xh. Kalimi i akteve ka ardhur si pasojë e kërkesës së prokurorit E. K, i cili ka kërkuar përpara gjykatës tërheqjen e akuzës dhe kalimin e akteve për plotësim hetimesh, pasi nga studimi i fashikullit ka konstatuar se janë disa akte që kanë të bëjnë me liritë dhe të drejtat e të pandehurve në gjykim, që nuk janë të plota. Aktet për të pandehurin A. Xh nuk janë të plota, në drejtim të tij është bërë me një procesverbal njohja me aktet, por i pandehuri nuk ka dhënë shpjegime për akuzën e ngritur ndaj tij. Ai nuk është pyetur lidhur me aktet dhe gjithë përbërjen e tyre dhe nuk ka dhënë shpjegime të hollësishme.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore në lidhje me procedimin penal, si dhe ka cenuar liritë dhe të drejtat e z. A.Xh, pasi nuk ka marrë shpjegimet e tij në lidhje me akuzën e ngritur dhe nuk e ka pyetur në lidhje me aktet dhe përbërjen e tyre.

ix/4 Në lidhje me këtë procedim konkludohet se subjekti ka shfaqur njohuri të cekëta, aftësi dhe gjykim të dobët, si dhe ka cenuar të drejtat dhe liritë e z. A. Xh, të cilat konsiderohen mangësi profesionale.

x. Gjithashtu, në datën 22.2.2018, në Prokurorinë e Përgjithshme ka paraqitur kallëzim penal shtetasi A.J, ndaj disa punonjësve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Ky kallëzim penal është dërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Kjo praktikë është arkivuar nga Prokuroria e Përgjithshme.

39.3. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me shkresën nr. *** prot., datë 8.5.2018, bën me dije se nga verifikimet e kryera rezulton se subjekti ka tri procedime penale të regjistruara në këtë prokurori, të cilat janë në hetim dhe konkretisht:

i. Procedimi penal nr. *, datë 11.10.2007 me kallëzues shtetasin L.H,** regjistruar për veprën penale “përdorim me keqdashje i thirrjeve telefonike”, parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal.

Z. L. H ka bërë kallëzim penal për subjektin e rivlerësimit, duke pretenduar se ajo e ka kërcënuar. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë, pasi ka administruar këtë kallëzim, ka regjistruar procedimin penal nr. ***/2017 për kryerjen e veprës penale “përdorim me keqdashje të thirrjeve telefonike”.

Për këtë procedim është vendosur pushimi i hetimeve në datën 28.9.2018.

Bazuar në procesverbalin për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale të datës 20.7.2018, rezulton se subjekti ka deklaruar se në datën 31.7.2017 i kanë ardhur dy thirrje të humbura nga nr. ****. Duke qenë se ishte drejtuesja e prokurorisë ka menduar se mund të ishte numri i ndonjë oficeri për ndonjë ngjarje dhe për këtë shkak e ka marrë në telefon ku i është përgjigjur z. L. H. Në vijim, ky shtetas e ka marrë sërish në telefon, por nuk është përgjigjur.

Nga verifikimi i thirrjeve telefonike të administruara në fashikullin penal, ndryshe nga sa deklarohet nga subjekti, rezulton se në datën 31.7.2017 numri celular ****, që i përket subjektit të rivlerësimit, ka kryer dy thirrje në drejtim të numrit ****, që i përket z. L.H. Pas këtyre thirrjeve rezulton se numri ***** ka kryer 4 thirrje rresht drejt numrit ***** dhe, më pas, dhe 7 thirrje të tjera rresht.

Për sa më sipër, rezulton se ka qenë fillimisht subjekti i rivlerësimit që ka kontaktuar z. L. H.

i/1 Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës si vijon:

- subjekti ka bërë deklarime të pasakta përpara organit të prokurorisë në lidhje me telefonatat e kryera prej saj drejt z. L. H;
- është e paqartë arsyeja që subjekti ka kontaktuar e para z. L.H, për sa kohë ai nuk ka qenë person nën hetim nga subjekti.

i/2 Pas kalimit të barrës së provës, subjekti prapësoi se çështja penale e iniciuar nga shtetasi L.H është hetuar dhe pushuar dhe ky i fundit nuk e ka ankimuar këtë vendim. Sipas subjektit, nuk është vërtetuar në hetim se ka qenë ajo që ka kontaktuar e para këtë shtetas ditën që ka apeluar vendimin e gjykatës në ngarkim të të atit. Ajo ka pretenduar se arsyeja e konfliktit artificial, i provokuar nga djali i të pandehurit, ka qenë pikërisht ankimi kundër vendimit që ka paraqitur në gjykatë, por Komisioni duhet të kishte analizuar atë që ka konstatuar prokurori kur ka analizuar “vendimin e pushimit të çështjes”.

i/3 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se ato i janë referuar vendimit të pushimit të procedimit penal në ngarkim të saj nga Prokuroria e Lezhës. Komisioni e ka verifikuar të gjithë fashikullin penal, nga ku i ka rezultuar se nga verifikimi i thirrjeve telefonike të administruara në fashikullin penal, ndryshe nga sa deklarohet nga subjekti, rezulton se në datën 31.7.2017 numri celular ****, që i përket subjektit të rivlerësimit, ka kryer dy thirrje në drejtim të numrit ****, që i përket z. L.H. Pas këtyre thirrjeve rezulton se numri ***** ka kryer 4 thirrje rresht drejt numrit ***** dhe më pas edhe 7 thirrje të tjera rresht. Subjekti, edhe pas kalimit të barrës së provës, nuk shpjegoi se cila ka qenë arsyeja që ka telefonuar z. L.H, i cili nuk ka qenë person nën hetim.

i/4 Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se veprimet e subjektit nuk pajtohen me pozicionin dhe etikën e prokurorit, pasi është e provuar se subjekti ka kontaktuar z. L.H, që ishte djali i të pandehurit, megjithëse ai nuk ishte person nën hetim.

ii. Procedimi penal nr. **, datë 12.4.2018 me kallëzues shtetasin L.H,** procedim i transferuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, regjistruar për veprën penale “hyrja e paautorizuar kompjuterike”, parashikuar nga neni 192/b i Kodit Penal.

iii. Procedimi penal nr. *, datë 4.12.2017, me kallëzues shtetasin A.Xh,** regjistruar për veprën penale “falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

39.4. Nga të dhënat e administruara rezulton që ndaj subjektit, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, Prokurorit të Përgjithshëm i është dërguar për vlerësim nga Shërbimi Informativ i Shtetit informacioni me nr. ***, datë 15.11.2005 “Dyshime për korrupsion pasiv në procedimin penal nr. ***, viti 2003”.

Gjithashtu, nga të dhënat e administruara nuk rezulton që ndaj subjektit të rivlerësimit të ketë të dhëna apo *indicie* të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta, si dhe të dhëna në rastet e identifikimit të subjektit të rivlerësimit në kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtar të

organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale), ku përfshihen edhe biseda, foto, vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike.

40. DENONCIMET

Komisioni ka administruar 10 denoncime nga publiku për subjektin Rita Gjati, së cilës iu kalua barra e provës për disa prej tyre:

1. Denoncim i shtetasit A. I³⁵

Denoncuesi ankohet se subjekti i rivlerësimit e ka njoftuar në të njëjtën datë që i kishte caktuar për t'u paraqitur për të dhënë deklaratimet.

Nga dokumentacioni i depozituar nga denoncuesi rezulton se në datën 20.12.2019 subjekti ka urdhëruar shtetasin A.I të paraqitet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës në datën 26.12.2019, ora 10:00, në cilësinë e personit që tregon rrethanat e hetimit në lidhje me pretendimet e tij të dërguara në datën 25.11.2019.

Njoftimi i këtij urdhri, bazuar në zarfin e depozituar nga denoncuesi, rezulton të jetë nisur më 26.12.2019 nga Prokuroria e Kukësit. Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës sepse duket se nga ana e saj nuk janë marrë masa për ta njoftuar në kohë z. A. I për t'u paraqitur në datën e caktuar prej saj në Prokurorinë e Kukësit, duke i cenuar të drejtën këtij shtetasi për të dhënë shpjegime në lidhje me pretendimet e tij.

Subjekti, në përgjigje të barrës së provës, e ka konsideruar pretendimin e denoncuesit të pa mbështetur në prova. Ajo ka pretenduar se nga provat që disponon Sekretaria e Organit të Procedimit rezulton se i është dorëzuar njoftimi i Postës Shqiptare në datën 24.12.2019, por në çdo rrethanë, prokurori i çështjes nuk kryen vetë veprimtari administrative. Kjo detyrë përfshihet në sferën e veprimit të Administratës së Prokurorisë. Në datën 26.12.2019 veprimtaria e kësaj administrate kontrollohej nga ish-drejtuesi i prokurorisë E. K. Pra, Komisioni nuk ka evidentuar me qëllim faktin se përgjegjësia e prokurorit mbaron me dorëzimin e njoftimit në Sekretarinë e Prokurorisë dhe prokurori nuk ka asnjë kompetencë mbi administratën e prokurorisë. Në mbështetje të shpjegimeve, subjekti ka depozituar kopje të librit të dorëzimit, nga ku rezulton se shkresa për z. A.I është nisur në datën 24.2.2019 nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës.

Komisioni vlerëson se nuk mund të ngarkohet subjekti i rivlerësimit me përgjegjësi për vonesat e kryera nga administrata e prokurorisë, për sa kohë ajo ka provuar që njoftimin e ka nxjerrë në kohë.

2. Denoncim i shtetasit F. J³⁶

Ky shtetas deklaron se i ka dhënë subjektit shumën 20.000 euro për të caktuar një masë sigurimi për ta liruar.

Komisioni analizoi vendimin nr. ***, datë 28.7.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, si dhe fashikullin penal të këtij procedimi, nga ku rezulton se z. F.J është akuzuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës për veprën penale “kontrabandë me mallra që paguhet akcizë kryer në bashkëpunim”, parashikuar nga nenet 172 dhe 25 të Kodit Penal. Bazuar në këtë vendim, fillimisht, z. F.J është hetuar dhe gjykuar me masën e sigurimit “arrest në burg” në kohën 24.6.2016 – 3.9.2016 dhe, më pas, është hetuar dhe gjykuar me masën e sigurimit personal “garanci pasurore”.

³⁵ Nr. ***, datë 10.1.2020; nr. ****, datë 21.5.2020; nr. ***, datë 27.7.2020

³⁶ Nr. ****, datë 15.3.2019

Është tentuar të merret në telefon në nr. ***, i lënë prej tij, por ka rezultuar se nuk ekziston.

Në lidhje me këtë denoncim subjekti ka dhënë shpjegime pavarësisht faktit se nga Komisioni nuk i janë kërkuar. Komisioni nuk e sheh të nevojshme analizimin e këtyre shpjegimeve, pasi nga ana e tij ky denoncim nuk është konsideruar i plotë dhe, për këtë arsye, nuk i ka kaluar subjektit barrën e provës.

3. Denoncim i shtetasit A.O³⁷

Në denoncimin e tij shtetasi deklaron se:

- Subjekti nuk ka regjistruar kallëzimin penal në ngarkim të shtetasit M.B.
- Subjekti nuk ka administruar në cilësinë e provave pamjet e kamerave filmike ku ka ndodhur ngjarja.
- Subjekti, ditën kur është bërë kallëzimi, nuk ka qenë në gatishmëri por ka qenë një prokuror tjetër.
- Procedimi penal është regjistruar në kundërshtim me ligjin, pasi nuk përbën fakt penal.
- Shtetasi M. B nuk ka qenë punonjës i bashkisë.

Pas analizimit të denoncimit, subjektit i kaloi barra e provës, pasi: (i) nuk ka regjistruar kallëzimin penal në ngarkim të shtetasit M.B; (ii) nuk ka administruar në cilësinë e provës kamerat e sigurisë; (iii) nuk i ka kërkuar organeve tatimore për të verifikuar se kur kishte filluar punë shtetasi M.B; si dhe (iv) nuk ka administruar strukturën e Bashkisë Kukës për të vërtetuar detyrën funksionale të shtetasit M. B.

Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, kundërshtoi gjetjet e Komisionit, duke vënë në dispozicion dokumentacion mbështetës. Subjekti ka prapësuar se kallëzimet i janë nënshtruar shortit elektronik, secili nga 3 prokurorët e ka regjistruar dhe ka vijuar me hetimin e çështjes në mënyrë të pavarur. Ajo ka sqaruar se: *“Është ngritur grup hetimor për të shmangur çdo lloj keqinterpretimi e paragjykimi. Neni 279 i Kodit të Procedurës Penale (detyrimi për të ruajtur sekretin e hetimit) nuk më lejon të ndalem më gjatë veçse t’i kërkoj Komisionit që të arrijë në konkluzion përfundimtar, pasi të shqyrtojë dokumentacionin, që vë në dispozicion të tij”.*

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e subjektit, konstaton se ajo ka sjellë një numër të konsiderueshëm dokumentesh, që kanë lidhje me procedimet penale në ngarkim të shtetasit A. O, si dhe urdhri për regjistrimin e procedimit penal të kallëzimit të kryer nga ky shtetas, ndërkohë subjekti nuk ka depozituar asnjë provë për të provuar faktin se ka administruar kamerat e sigurisë, ka verifikuar me organet tatimore se kur ka filluar punë z. M. B, si dhe që ka administruar strukturën e Bashkisë Kukës për të vërtetuar detyrën funksionale të z. M.B.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore.

4. Komisioni ka administruar disa dosje gjyqësore nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, bazuar në **denoncimet publike në median e shkruar**.

Nga këto dosje Komisioni ka analizuar dosjen e mëposhtme në lidhje me shtetasin S.V. Nga analizimi i fashikullit penal rezulton se:

i. Fillimisht, në datën 9.11.2018, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, përfaqësuar nga znj. A. N, ka paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës kërkesën

³⁷ Nr. ***, datë 7.1.2021

penale me objekt “vleftësimin si të ligjshëm të arrestimit të shtetasit S.V dhe caktimin e masës së sigurimit ‘arrest në burg’”. Ky shtetas rezulton të ketë qenë i dënuar me vendim të Gjykatës së Rijekës, Kroaci për veprat penale “kanosje jete” dhe “plagosje e rëndë” e kryer kundër një zyrtari në lidhje me detyrën e tij, “shpërdorim të autoritetit në transaksion biznesi”, “evazion i tatimeve dhe detyrimeve të tjera” dhe “falsifikim i një dokumenti zyrtar”.

ii. Gjatë gjykimit të çështjes në seancën gjyqësore datë 12.11.2018, subjekti ka kërkuar të caktohet masa e sigurimit “arrest në shtëpi” dhe jo “arrest në burg”, duke paraqitur edhe deklaratën noteriale nr. ****, datë 12.11.2018, sipas së cilës shtetasja S. P (në cilësinë e pronares së hotelit) ka deklaruar se i arrestuari mund të qëndrojë në hotelin në pronësi të saj “Gj”.

Nga ana e subjektit të rivlerësimit është e paargumentuar kërkesa e saj për caktimin e masës së sigurimit nga “arrest në burg” në “arrest shtëpie”, për sa kohë nuk rezulton të ketë ndryshuar ndonjë nga rrethanat apo të jetë depozituar ndonjë provë për të justifikuar ndryshimin e kërkesës për masën e sigurimit. Për më tepër, duke marrë në konsideratë faktin që z. S.V ka qenë i dënuar me masë të lartë dënimi me burgim është larguar nga Kroacia për të shmangur dënimin, ekzistonte rreziku (një nga kushtet e veçanta parashikuar nga neni 228/3 i Kodit të Procedurës Penale³⁸) që ai të largohet sërish sikundër kishte bërë në shtetin kroat. Ky shtetas, pas caktimit të masës së arrestit në shtëpi është larguar nga vendi i vuajtjes së dënimit në datën 1.1.2019, fakt i cili vërtetohet me fashikullin e procedimit penal nr. **/2019.

iii. Gjykata, në vendimin nr. ****, datë 12.11.2018, për caktimin e masës së sigurimit personal deklaroi se masa më e përshtatshme është ajo e kërkuar fillimisht nga prokuroria “arrest në burg”, por në konsideratë të përcaktimit të nenit 244/3³⁹ të Kodit të Procedurës Penale gjykata ka qenë e detyruar të caktojë masën e sigurimit “arrest në shtëpi”.

Në përfundim, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, si vijon:

- a. subjekti i rivlerësimit nuk ka argumentuar ndryshimin e kërkesës së masës së sigurimit nga “arrest në burg” në “arrest shtëpie” për shtetasin S. V;
- b. shtetasi S.V rezulton të jetë dënuar me vendime me masë të lartë dënimi me burgim nga gjykata kroate dhe të jetë larguar nga ky shtet pikërisht për të shmangur këto dënime;
- c. ky shtetas, pas caktimit të masës së sigurimit “arrest shtëpie”, është larguar nga Shqipëria në fillim të vitit 2019.

Për rrjedhojë, duket se subjekti ka favorizuar z. S.V në caktimin e masës së sigurimit, e cila ka sjellë si pasojë krijimin e mundësive të këtij shtetasi për t’iu shmangur dënimit, pasi është larguar nga vendi i vuajtjes së dënimit.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti prapësoi se: *“Masa e sigurisë është kërkuar ‘arrest në shtëpi’ në përputhje me kushtet e kriteret e caktimit të masave të parashikuara nga nenet 228 dhe 229 të Kodit të Procedurës Penale. Nuk është favorizuar subjekti i ekstradimit. Përkundrazi, largimi i tij nga vendi i vuajtjes së dënimit është hetuar e gjykuar dhe në përfundim është dënuar nga gjykata me 5 vite burgim. Nga aktet rezulton se në shtetin kroat shtetasi S. B. (emri kosovar) të jetë dënuar me 3,2 vite burgim. Gjithashtu, bën me dije Komisionin se është kërkesë formale e agjencive të tjera caktimi i kësaj mase sigurie. Nuk mund të jap më shumë detaje për shkak të natyrës së çështjes. Por vijon arsyetimin se për vendosjen e një mase sigurimi personal, cilado qoftë ajo, duhet të ekzistojnë disa kushte të rëndësishme, mosplotësimi i të cilave në mënyrë automatike do të passillte moslejimin e saj ose rënien e masës së sigurimit. Këto kushte parashikohen nga neni 228 i Kodit të Procedurës Penale dhe*

³⁸ Kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet.

³⁹ Gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori.

kanë të bëjnë vetëm me masat e sigurimit personal dhe jo ato pasurore. Pasi të jenë plotësuar kushtet për caktimin e masës së sigurimit personal duhet të analizohen kriteret se çfarë mase sigurimi personal duhet të vendoset për një rast të caktuar. Në nenin 229 të Kodit të Procedurës Penale përmenden disa koncepte që lidhen me kriteret e caktimit të masës së sigurimit. Këto kriteret janë diskrete dhe lënë shumë hapësira për interpretime. Këtu analizohen përshtatshmëria e masës së sigurimit me shkallën e nevojave të sigurimit, raporti midis masës së sigurimit dhe rëndësisë së faktit të ndodhur dhe masa e sanksionit që parashikohet, vazhdimësia e krimit, përsëritja e tij, rrethanat lehtësuese dhe rënduese, moshja e mitur e të pandehurit dhe nevojat që mund të lindin për të mos ndërprerë proceset edukative [...]”.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim në lidhje me arsyet që ajo, në ndryshim me kërkesën penale me objekt “vleftësimin si të ligjshëm të arrestimit të shtetasit S.V dhe caktimin e masës së sigurimit ‘arrest në burg’” të paraqitur në datën 9.11.2018, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, përfaqësuar nga znj. A.N, ka kërkuar në seancë gjyqësore caktimin e masës së sigurisë “arrest në shtëpi”. Ajo nuk dha asnjë argument në lidhje me faktin se gjykata, në vendimin nr. ***, datë 12.11.2018, për caktimin e masës së sigurimit personal shprehet se masa më e përshtatshme është ajo e kërkuar fillimisht nga prokuroria “arrest në burg”, por në konsideratë të përcaktimit të nenit 244/3⁴⁰ të Kodit të Procedurës Penale gjykata ka qenë e detyruar të caktojë masën e sigurimit “arrest në shtëpi”.

Subjekti nuk ka sjellë asnjë provë për të vërtetuar argumentimin e kërkesës së saj në seancë gjyqësore për caktimin e një mase më të butë se ajo e kërkuar nga prokurori tjetër me kërkesë me shkrim drejtuar gjykatës.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka marrë në konsideratë rrezikshmërinë e z. S. V, i cili nga dokumentacionin i administruar rezulton se është dënuar me vendime me masë të lartë dënimi me burgim nga gjykata kroate dhe të jetë larguar nga ky shtet pikërisht për të shmangur këto dënime, si dhe prej saj nuk është argumentuar kërkesa për caktimin e masës së sigurimit “arrest shtëpie” për z. S.V.

Pasoja e ardhur pas caktimit të kësaj mase sigurie është arratisja e z. S. V, duke krijuar dyshime se nga ana e subjektit është favorizuar me qëllim ky shtetas, duke iu caktuar një masë sigurie me e butë se ajo e kërkuar fillimisht.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se rasti i z. S.V është përpara gabimeve thelbësore dhe serioze që tregojnë mungesë të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, konstatuar këto gabime edhe nga gjykata, e cila në vendimin e caktimit të masës së sigurimit është shprehur se masa më e përshtatshme është ajo e kërkuar fillimisht nga prokuroria, “arrest në burg”.

41. ANALIZA E GJETJEVE

Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënave nga burimet arkivore në Sektorin e Burimeve Njerezore pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Komisioni, pasi analizoi prapësimet e subjektit në lidhje me këtë kriter, përfundimisht vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në

⁴⁰ Gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori.

disa raste ka rezultuar se ajo ka aftësi dhe njohuri të cekëta në kuptimin dhe interpretimin e drejtë të legjislacionit penal dhe procedural penal në fuqi, si dhe ka shfaqur gjykim të dobët. Në një rast, subjekti ka vijuar hetimet edhe pse e kallëzuar ka rezultuar e vdekur. Në një rast, subjekti nuk ka regjistruar veprën penale, ka ndarë çështjen penale pa u plotësuar kushtet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe pa kryer veprime hetimore, si dhe ka pushuar çështjen pa administruar të gjitha provat e nevojshme. Në një rast tjetër subjekti nuk ka përcaktuar saktë shkakun ligjor të pushimit të procedimit dhe në një tjetër është e paqartë se pse nuk janë marrë si të pandehur të gjithë personat e përfshirë në procedim penal. Në më shumë se një rast nga subjekti nuk janë kryer të gjitha veprimet hetimore.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti ka njohuri të cekëta, gjykim të dobët, si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj në lidhje me kryerjen e procedurave dhe veprimeve të nevojshme hetimore, të cilat janë evidentuar nga Komisioni dhe janë të trajtuara më lart. Për më tepër, subjekti nuk ka respektuar normalisht të drejtat e palëve, të paktën në një rast.

b) Arsyetimi ligjor

Komisioni, pasi analizoi prapësimet e subjektit në lidhje me këtë kriter, përfundimisht, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mangësi profesionale në arsyetimin ligjor. Në disa raste rezulton se nga ana e saj nuk analizohen figurat e veprave penale, në një rast kërkesa për caktimin e masës së sigurimit rezulton të jetë e paargumentuar, në disa raste ajo ka shkelur të drejtat e personave në hetim apo të pandehur. Në disa raste, subjekti nuk analizon veprimet apo mosveprimet e të pandehurve për kryerjen e veprës penale, si dhe nuk përshkruan qartë dhe saktë veprën penale për të cilën akuzohen të pandehurit. Subjekti ngatërron termin burim prove me veprimet procedurale që ndërmerren në fazën e hetimeve paraprake. Në një rast, subjekti ka kryer gabime thelbësore, duke kërkuar caktimin e një mase sigurimi që nuk përputhet me rrezikshmërinë shoqërore të personit, e cila ka sjellë si pasojë edhe largimin e tij.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Në analizë të të dhënave të mësipërme konstatohet se subjekti Rita Gjati ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës, ku i ka kryer hetimet, si dhe drejtuar e kontrolluar veprimtarinë hetimore brenda një afati të arsyeshëm në raport me kompleksitetin dhe shumëllojshmërinë e çështjeve.

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore

Subjekti i rivlerësimi ka kryer veprimet hetimore në kohë të arsyeshme. Nga ana e saj është realizuar mbledhja në kohë e provave dhe burimeve të provave të domosdoshme, të cilat janë vënë në bazë të akuzave të ngritura, të cilat janë dërguar për gjykim, si dhe sa i takon vendimmarrjes është kujdesur në njoftimin e subjekteve dhe palëve të interesuara, duke u bërë të ditur edhe të drejtën e ankimit, e faktuar kjo me shkresat përkatëse ose me nënshkrimin e tyre në aktet përkatëse. Nga ana e saj, në disa raste nuk janë kryer të gjitha veprimet hetimore të nevojshme të trajtuar më lart.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Subjekti ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve dhe rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar. Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale të përpiluara janë të sakta, të strukturuara, në respektim të normave të drejtshkrimit.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) *Etika në punë*

Nga të dhënat e administruara rezulton se ndaj subjektit janë marrë disa masa disiplinore, si dhe në datën 28.7.2008 është shkarkuar nga detyra me Dekretin Nr. *** të Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Subjekti ka bërë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. **, datë 21.10.2009, ka vendosur rikthimin në detyrë të prokurores dhe për zbatimin e këtij vendimi Prokurori i Përgjithshëm, me vendimin nr. ***, datë 9.1.2013, ka vendosur rikthimin në detyrë të subjektit.

Në lidhje me këtë, Komisioni nuk i ka kaluar barrë prove, as nuk e ka marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor të aftësive profesionale, për rrjedhojë, vlerëson se nuk është i nevojshëm analizimi i shpjegimeve të subjektit.

b) *Integriteti*

Nga të dhënat e administruara dhe të trajtuara më lart konstatohet se kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e subjektit ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm, si dhe ngrihen dyshime për favorizim të personave nën hetim.

Në lidhje me këtë konkluzion, subjekti e ka kundërshtuar me arsyetimin se ka paraqitur të gjitha provat që mbështesin faktin se përfaqëson një prokurore me integritet, të guximshme, këmbëngulëse, kurajoze, objektive dhe të paanshme, një prokurore të pandikueshme dhe e vështirë për të bërë kompromis, një prokurore e drejtë dhe e vendosur, një prokurore që ka punuar me përkushtim e sakrificë, larg familjes, duke udhëtuar plot 5 orë në ditë vajtje – ardhje, por krenare për respektin e vlerësimin e publikut dhe të institucioneve ku ka ushtruar e vazhdon të ushtrojë funksionet, krenare për mënyrën si i ka shërbyer ligjit, familjes dhe shoqërisë.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit për çdo dosje procedimi penal, si dhe shpjegimet e mësipërme, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Në të paktën tri raste nga ana e subjektit ngrihen dyshime që ka favorizuar persona nën hetim, si vijon: (i) rasti i z. S. V për të cilin ajo ka ndryshuar në seancë kërkesën për caktimin e masës së sigurimit; (ii) pushimi i procedimit penal në ngarkim të z. K.M, për të cilin subjekti kishte parashtruar gjatë hetimit se ky shtetas gjatë ushtrimit të detyrës sipas procesverbalit të këqyrjes së pamjeve filmike në pikën doganore ka ushtruar kontroll fiktiv në mjetin, i cili është sekuestruar me mall kontrabandë nga policia gjyqësore; (iii) nuk ka marrë si të pandehur z. B. Xh (i cili ka qenë në automjetin ku u gjenden mallrat kontrabandë), z. S. Gj (drejtues i automjetit) dhe z. D. E (i cili ka qenë në turn në momentin e kryerjes së veprës penale).

c) *Paanësia*

Në lidhje me vlerësimin e paanësisë për subjektin për periudhën objekt vlerësimi nuk rezulton të ketë pasur raste të konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë për pjesëmarrje në procedimet penale që i janë ngarkuar apo të jenë diskutuar cenim të të drejtave të pjesëmarrësve në proces apo të grupeve shoqërore vulnerabël.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) *Aftësitë e komunikimit*

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit për të komunikuar.

b) *Aftësia për të bashkëpunuar*

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar me kolegët, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

c) *Gatishmëria për t'u angazhuar*

Subjekti i rivlerësimit i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Ka marrë pjesë në trajnimin me temë “Teknikat e ngritjes së akuzës”, organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, në data 19-20 nëntor 2015, Tiranë.

Në përfundim të hetimit administrativ për kriterin e aftësive profesionale, Komisioni ka konstatuar gabime thelbësore dhe serioze, si dhe ekzistencën e një serie të qartë dhe të vazhdueshme të gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale. Për rrjedhojë, duket se subjekti i rivlerësimit është i papërshtatshëm, pasi ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, nuk ka respektuar në disa raste të drejtat e palëve, si dhe nuk është efektiv.

Në lidhje me këtë rezultat subjekti prapësoi se: *“Neni E, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, përcakton se: ‘Vlerësimi i aftësive profesionale ka për qëllim identifikimin e atyre subjekteve që nuk janë të kualifikuara për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre, të cilat kanë mangësi profesionale, që mund të korrigojnë përmes edukimit’; neni 59 i ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: ‘Vlerësimi i aftësive profesionale parashikon arritjen e një niveli minimal kualifikues’; vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese, ku në paragrafin 54 përcaktohet se: ‘[...] në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht ‘të pasakta’ nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shihni edhe opinionin CDL -AD (2016)036 e Komisionit të Venecias)’.*

Në këtë këndvështrim, në analizën profesionale të administruar nga Komisioni janë konkluduar padrejtësisht vendimet e saj në hetim si vendime “të gabuara dhe në seri”, ky konstatim ka ardhur si pasojë e analizës së çështjeve shkëputur nga konteksti i koherencës legjislative procedurale penale. Në këtë kontekst konstatoj se konkluzionet e Komisionit për aftësitë profesionale të miat, gjatë periudhës së rivlerësimit nuk përputhen me provat. Procedimet penale, të analizuara nga Komisioni, janë hetuar nga ana ime para hyrjes në fuqi të ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017.

Ky fakt legjislativ nuk është konsideruar nga Komisioni në analizën përkatëse, as nuk është marrë në konsideratë vendimi nr. 56, datë 29.1.2001, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, për mënyrën e interpretimit dhe zbatimit pikërisht të nenit 24 të Kodit të Procedurës Penale: ‘[...] të gjitha vendimet që merren gjatë fazës së hetimit paraprak, si ato për pushimin e çështjes, ashtu edhe ato për dërgimin e çështjes në gjykatë, janë vendime që merren nga titullari i organit të prokurorisë, pavarësisht nga mendimi dhe qëndrimi që mund ketë prokurori, që ndjek çështjen. Prokurori më i lartë është sipas rastit, prokurori i rrethit ose Prokurori i Përgjithshëm [...]’.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se ato nuk janë në përputhje me rezultatet e hetimit. Në lidhje me masat disiplinore apo largimin e saj nga puna, Komisioni nuk i ka kaluar subjektit barrën e provës, për rrjedhojë, ato nuk janë konsideruar prej tij si shkaqe të mjaftueshme për të arritur në konkluzion se subjekti ka mungesë në aftësitë profesionale. Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit, pasi në dosjet e analizuara ka konstatuar gabime thelbësore dhe serioze, si dhe ekzistencën e një serie të qartë dhe të vazhdueshme të gjykimeve të gabuara, duke i kërkuar shpjegime dhe dokumentacion provues në lidhje me secilën dosje. Për sa i përket pretendimit të subjektit se nuk është marrë në konsideratë vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, vlerësohet se ky pretendim i subjektit nuk është i mbështetur në ligj

dhe në prova, pasi çdo prokuror ka për detyrë të ushtrojë detyrën e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gabimet e konstatuara nuk kanë lidhje me vendimmarrjen e subjektit, por me veprimet e saj gjatë fazave të ndryshme të hetimit, si dhe me dokumentet e hartuara prej saj. Gjithashtu, nëse i qëndrojmë pretendimeve të subjektit, atëherë nuk ka qenë e nevojshme kryerja e vlerësimit profesional apo vlerësimeve periodike të saj për sa kohë ajo pretendon se çdo veprim bëhej nga prokurori i rrethit.

Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional

42. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga Prokuroria e Përgjithshme dhe denoncimeve të depozituara në Komision, konstaton gabime thelbësore dhe serioze, si dhe ekzistencën e një serie të qartë dhe të vazhdueshme të hetimeve/gjykimeve të gabuara, që tregojnë për një mënyrë pune, që nuk pajtohet me pozicionin e prokurorit, duke reflektuar mungesë të aftësive profesionale të subjektit.

43. Të gjitha këto të meta të konstatuara në vlerësimin profesional të subjektit vlerësohet se cenojnë besimin e publikut të një prokuror.

44. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë, në atë shkallë sa programi i trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës nuk mund ta zgjidhë këtë çështje për një vit.

45. Komisioni konkludon se në vlerësimin e aftësive profesionale subjekti Rita Gjati është i papërshtatshëm, në kuptim të gërme “c” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

46. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorëve, si dhe në përgjigje të barrës së provës, konkludon se:

i. Subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin e figurës dhe pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 39 dhe 33 të këtij ligji.

ii. Subjekti rezulton i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale.

iii. Nga vlerësimi tërësor, në kuptim të pikës 2 të nenit 4 të këtij ligji, rezulton se subjekti ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “c”, si dhe në nenin 61, pikat 3, 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Rita Gjati, prokurore/drejtuese në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Vendimi u shpall në Tiranë, në datën 19.3.2021

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Alma FASKAJ
Kryesuese

Genta TAFA (BUNGO)
Relatore

Lulzim HAMITAJ
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha